

STUDIMI “MODELIMI I PARASHIKIMIT:

NDIKIMI I MIGRACIONIT TE FORCA SHQIPTARE

E PUNËS DHE NEVOJAT PËR ZHVILLIMIN E

AFTËSIVE NGA PIKËPAMJA GJINORE NË SHQIPËRI”



Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (IOM). Përcaktimet e përdorura dhe paraqitja e materialit përgjatë gjithë dokumentit nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë mendimi të çfarëdoshëm nga ana e IOM-it lidhur me statusin juridik të asnjë vendi, territori, qyteti ose zone ose mbi autoritetet e tyre apo sa u takon kufijve apo vijave të tyre kufizuese.

IOM-i është i përkushtuar ndaj parimit se migracioni njerëzor dhe i rregullt është në të mirë të migrantëve dhe të shoqërisë.

Si organizatë ndërqeveritare, IOM-i bashkëvepron me partnerët e tij në bashkësinë ndërkombëtare me qëllim që: të ndihmojë për përballimin e sfidave operative të migracionit; të thellojë kuptimin e çështjeve të migracionit; të nxitë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik përmes migracionit dhe të mbrojë dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Përkthimi i këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e IOM-it në Shqipëri, në kuadrin e projektit “Forcimi i kuadrit të migracionit për motive punësimi në Shqipëri”, dhe financohet nga Fondi për Zhvillim i IOM-it (IDF).

Botuesi: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin  
Misioni në Shqipëri  
Rruga Brigada VIII, P. LID  
Kati III, Ap. 303  
Tiranë, Shqipëri  
Tel.: +355 42257836-7  
Fax: +355 4225 7835  
Email: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int)  
Website: <http://www.albania.iom.int>

© IOM 2022



Ky botim është nxjerrë pa redaktim zyrtar nga IOM-i.

STUDIMI “MODELIMI I PARASHIKIMIT:

NDIKIMI I MIGRACIONIT TE FORCA SHQIPTARE

E PUNËS DHE NEVOJAT PËR ZHVILLIMIN E

AFTËSIVE NGA PIKËPAMJA GJINORE NË SHQIPËRI”



Ashtu siç pranohet në Strategjinë Kombëtare të Migracionit, 2019-2022, migracioni i qytetarëve shqiptarë për motive punësimi ka gjasë të mbetet një faktor kryesor ndikues në zhvillimin e vendit. Për këtë arsye, planifikimi, hartimi dhe monitorimi i politikave të ardhshme të punësimit duhet të mbajë parasysh efektin e migracionit të qytetarët shqiptarë dhe të huaj në tregun kombëtar të punës. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në hartimin e politikave të zhvillimit ekonomik dhe tregut të punës është si ndikoi shpërthimi i pandemisë COVID-19 në ekonomi, veçanërisht, duke pasur parasysh normën e lartë të migracionit të kthimit / që e kanë përjetuar shumë vende të origjinës.

Projekti “Forcimi i kuadrit të migracionit për motive punësimi në Shqipëri”, i financuar nga Fondi për Zhvillim i IOM-it (IDF) dhe i zbatuar nga IOM-i në Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Institutin e Statistikave, Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Shkollën shqiptare të Administratës Publike, synon të përmbushë këtë nevojë përmes: ngritjes së kapaciteteve të institucioneve qeveritare përkatëse në Shqipëri për të mbledhur dhe analizuar të dhënat mbi migracionin për motive punësimi, duke shfrytëzuar ndërkohë parashikimet për migracionin për të hartuar politikat e migracionit për motive punësimi; vlerësimin të nevojave në vendet kryesore të destinacionit të migrantëve shqiptarë, përfshi ndikimin e COVID-19-ës në dinamikat e migracionit për motive punësimi, duke pasur parasysh rëndësinë dhe gjasat për të formësuar dinamikat e migracionit nga Shqipëria dhe drejt saj në të ardhmen e afërt dhe kryerjes së një studimi të ndikimit të migracionit në burimet e disponueshme të fuqisë punëtore dhe vëllimin e strukturën e fuqisë kombëtare të punës. Këtu përfshihen nevojat e tregut të punës në ata sektorë që përjetojnë fluksin më të madh të largimit të profesionistëve, si dhe nevojat e kualifikimit të fuqisë punëtore.

Edhe pse, aktualisht, nuk kryhen vlerësime të ndikimit të migracionit mbi tregun e punës, ky informacion është jetik për t’u përballur me sfidat e mundshme në tregun kombëtar të punës, si shterimi i burimeve njerëzore në disa profesione dhe sektorë dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve shoqërore. Duhet vlerësime sistematike të ndikimit aktual dhe të ardhshëm të flukseve migratore mbi vëllimin dhe strukturën e forcës kombëtare të punës, për të hartuar politika të migracionit për motive punësimi që mbështeten në të dhëna dhe për të përcaktuar nevojat e forcës migrante të punës së Shqipërisë.

Studimi “Modelimi i parashikimit: ndikimi i migracionit te forca shqiptare e punës dhe nevojat për zhvillimin e aftësive nga pikëpamja gjinore në Shqipëri” është kryer në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in.

Ky studim ka dy objektiva kryesore: të ofrojë një vlerësim të gjithanshëm të ndikimit të prirjeve aktuale të migracionit në Shqipëri dhe të parashikojë ndikimin e tyre afatgjatë në forcën e punës së vendit. Studimi është mbështetur në një vlerësim gjithëpërfshirës së tregut të punës, që synonte të shqyrtonte prirjet e popullatës në moshë pune sa i takon punësimit, papunësisë dhe fuqisë punëtore që nuk është në punë dhe në kërkim të punës. Parashikimet demografike, të mbështetura nga skenarët e migracionit, ofrojnë informacion për evoluimin e popullsisë në moshë pune dhe, për rrjedhojë, për çështje si qëndrueshmëria e ofertës shqiptare të punës dhe e sistemit të sigurimeve shoqërore. Parashikimi kombëtar i zhvillimit të popullsisë shqiptare për periudhën 2020-2050 shërben si kuadër për parashikimet e nxjerra. Ato paraqiten si pjesë përbërëse e raportit dhe efektet e tyre analizohen së bashku me vlerësimet që lidhen me tregun e punës dhe migracionin.

Procesi i studimit përfshin:

- Parashikimet e popullsisë lidhur me ndryshimet e ardhshme demografike në vend, si faktor kontribues për hartimin e politikave publike që kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm në kontekstin e ri të rritjes në moshë të popullsisë dhe lindshmërisë së ulët. Parashikimet dhe modelimi gjatë periudhës dhe identifikimi i nxitësve të ndryshimeve të popullata në moshë pune dhe popullata aktive në Shqipëri dhe, veçanërisht, roli i flukseve migratore nga pikëpamja gjinore.
- Një analizë e tregut aktual të punës (duke u përqendruar te profesionet ose sektorët e aktiviteteve ekonomike), si dhe e prirjeve aktuale në Shqipëri dhe si është ndikuar nga emigracioni (të paktën një seri 5-vjeçarësh).

- Ndikimi aktual dhe i ardhshëm i flukseve migratore në vëllimin dhe strukturën e forcës së punës nga nevojat e tregut të punës në vendet kryesore të destinacionit.
- Pasojat e COVID – 19-ës në migracionin e forcës së punës nga Shqipëria dhe drejt saj.

Studimi është ndarë në tri pjesë:

Pjesa I – Analiza e prirjeve të tregut të punës dhe e migracionit

Pjesa II – Parashikimi i popullsisë së Shqipërisë për periudhën 2021-2050

Pjesa III – Rekomandimet për politika

Trajtimi i çështjeve të mësipërme do t'i japë mundësi qeverisë të vlerësojë më mirë nevojat e tregut të punës në të ardhmen në Shqipëri dhe në vendet kryesore të destinacionit, për të siguruar informacion të mjaftueshëm për hartimin e politikave të reja të qeverisjes dhe zhvillimit të migracionit.

Ky proces do të kontribuojë për përmbushjen nga qeveria shqiptare të Marrëveshjes Globale të Migracionit dhe OZhQ-ve (sidomos për zbatimin e të dhënave sipas statusit migrator).

HYRJE.....	01
LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE.....	04
FALËNDERIM .....	08
PËRMBLEDHJE.....	09
<b>PJESA I – ANALIZA E PRIRJEVE TË TREGUT TË PUNËS DHE E MIGRACIONIT.....</b>	<b>16</b>
1.1 - Metodologjia.....	16
1.2 - Përbërja e migracionit në Shqipëri.....	17
1.3 - Prirjet e forcës së punës në Shqipëri.....	24
1.4 - Profilet sektoriale dhe profesionale të prekura nga migracioni.....	34
1.5 - Prirjet aktuale të migracionit dhe efektet në sistemin arsimor në Shqipëri.....	37
1.6 - Migracioni dhe zgjedhjet arsimore.....	42
1.7 - Faktorët shtytës dhe tërheqës të korridorit të migracionit qendër-periferi.....	44
1.8 - Ndikimi i imigracionit dhe imigracionit të kthimit në tregun shqiptar të punës gjatë COVID-19-ës.....	47
<b>PJESA II – PARASHIKIMI I POPULLSISË SË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2021-2050.....</b>	<b>49</b>
2.1 - Metodologjia.....	49
2.2 - Riprodhimi dhe përbërësit aktualë të popullsisë.....	50
2.3 - Këndvështrimet aktuale të zhvillimit të popullsisë.....	56
2.4 - Analiza e parashikimit.....	60
2.5 - Mundësia e migracionit hyrës dhe migracionit të kthimit për të ekuilibruar prirjen migratore neto në Shqipëri.....	65
2.6 - Përfundime.....	67
<b>PJESA III – REKOMANDIME PËR POLITIKAT.....</b>	<b>69</b>
3.1 - Alternativat ekzistuese të politikave publike për trajtimin e ndryshimeve të parashikuara demografike, që sigurojnë një ofertë të mjaftueshme pune për tregun shqiptar të punës, duke marrë parasysh parashikimin e politikave me ndjeshmëri gjinore dhe të drejtat dhe mbrojtjen e punonjësve (migrantë).....	69
3.2 - Ndikimi i migracionit mbi qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve shoqërore në dritën e skenarëve të propozuar.....	70
3.3 - Mësimet që mund të nxirren nga përvoja e vendeve të ngjashme me Shqipërinë për trajtimin e rrjedhjes së trurit dhe nxitjes së qarkullimit të trurit.....	71
<b>BIBLIOGRAFI.....</b>	<b>72</b>
<b>FJALORTH.....</b>	<b>75</b>

# LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafiku 1 - Emigracioni sipas moshës.....	17
Grafiku 2 - Emigracioni sipas moshës.....	18
Grafiku 3 - Gjinia e migrantëve të jashtëm.....	18
Grafiku 4 - Prejardhja e migrantëve të jashtëm.....	19
Grafiku 5 - Niveli arsimor i migrantëve të jashtëm.....	19
Grafiku 6 - Statusi i punësimit të migrantëve të jashtëm.....	20
Grafiku 7 - Arsimi dhe gjinia e migrantëve të jashtëm.....	20
Grafiku 8 - Sektori i punësimit dhe gjinia e migrantëve të jashtëm.....	20
Grafiku 9 - Prirjet e normave mesatare të punësimit sipas moshës dhe gjinisë (2012-2021).....	27
Grafiku 10 - Mesataret e prirjeve të raportit midis popullsisë së papunë dhe në moshë pune (2012-2021).....	28
Grafiku 11 - Meshkujt, viti 2021 krahasuar me vitin 2017 sipas sektorëve makroekonomike.....	29
Grafiku 12 - Femrat, viti 2021 krahasuar me vitin 2017 sipas sektorëve makroekonomike.....	29
Grafiku 13 - Meshkujt dhe femrat e punësuar në vitin 2021 krahasuar me vitin 2017 në sektorët jobujqësorë.....	30
Grafiku 14 - Ndryshimet te femrat krahasuar me meshkujt në periudhën 2017-2021 sipas sektorëve makroekonomike dhe për të gjithë tregun shqiptar të punës.....	30
Grafiku 15 - Parashikimet e evoluimit të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë pesë vitet e ardhshme (2021 deri në 2026).....	31
Grafiku 16 - Parashikimet e evoluimit të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme (2021 deri në 2036).....	32
Grafiku 17 - Mesataret e prirjeve të popullsisë në moshë pune, sipas moshës dhe gjinisë (2012-2021).....	34
Grafiku 18 - Numri i emigrantëve kundrejt imigrantëve.....	34
Grafiku 19 - Imigracioni sipas grupmoshës.....	35
Grafiku 20 - Imigracioni sipas gjinisë gjatë viteve.....	35
Grafiku 21 - Sektori i punësimit të migrantëve të jashtëm.....	36
Grafiku 22 - Forca e punës në sektorin bujqësor.....	36
Grafiku 23 - Pensioni mesatar.....	36
Grafiku 24 - Punësimi sipas sektorit.....	37
Grafiku 25 - Arsyet kryesore për të emigruar.....	43
Grafiku 26 - Numri i imigracionit dhe migrantëve të jashtëm ndërkombëtarë sipas vitit dhe normës së përbërë të rritjes vjetore – prirjet e korrigjuara, 2011-2021.....	66
Grafiku 27 - Parashikimet e normës bruto të migracionit neto (deri në vitin 2050).....	27
<hr/>	
Figura 1 - Të huajt me leje qëndrimi sipas grupmoshës (2005-2021).....	21
Figura 2 - Mbajtësit e huaj të lejes së qëndrimit sipas rajonit të origjinës, 2005-2020.....	22
Figura 3 - Mbajtësit e huaj të lejes së qëndrimit sipas vendit të origjinës dhe qëllimit të aplikimit, 2020..	22
Figura 4 - Numri i migrantëve ndërkombëtarë në Shqipëri dhe CAGR-ja, 2011-2021.....	23

# LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Figura 5 - Evoluimi i PBB-së në Shqipëri në periudhën 2011-2021 sipas sektorëve makroekonomikë (në miliardë dollarë amerikanë).....	24
Figura 6 - Parashikimet e evoluimit të PBB-së në Shqipëri deri në vitin 2027, sipas sektorëve makroekonomikë (në miliardë dollarë amerikanë).....	25
Figura 7 - Arsyet për të emigruar.....	42
Figura 8 - Arsyet kryesore për të emigruar - sipas statusit të punës.....	43
Figura 9 - Për sa kohë do të doje të qëndroje jashtë?.....	44
Figura 10 - Cila është arsyeja kryesore për të cilën do lëvizje drejt një vendi tjetër?.....	45
Figura 11 - Ku do të preferoje të shkoje? Rendit tri nga vendet që do të pëlqenin më shumë.....	46
Figura 12 - Lëvizja e lirë e akademikëve, studentëve dhe të diplomuarve (procesi i Bolonjës).....	46
Figura 13 - Popullsia e përgjithshme e Shqipërisë dhe dinamika e saj, 2010-2020 (popullsia deri më 31 dhjetor).....	51
Figura 14 - Struktura moshë-seks e popullsisë, 2010-2020 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	52
Figura 15 - Struktura moshë-seks e popullsisë, 2010-2020 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	52
Figura 16 - Mosha mesatare e popullsisë sipas seksit, 2010-2020 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	52
Figura 17 - Përqindjet e kategorive të grupmoshave kryesore, në 2010-2020, vite të caktuara (deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	52
Figura 18 - Bilanci i ndryshimit të përgjithshëm, 2011-2020, Shqipëria.....	53
Figura 19 - Bilanci i ndryshimit natyror, 2011-2020, Shqipëria.....	53
Figura 20 - Mosha mesatare e nënës në lindje, 2011-2020, Shqipëria.....	53
Figura 21 - Norma e përgjithshme e fertilitetit, 2011-2020, Shqipëria.....	53
Figura 22 - Shpërndarja e fertilitetit sipas moshës, 2011-2020, grupmosha njëvjeçare, Shqipëria.....	54
Figura 23 - Shpërndarja e fertilitetit sipas moshës, 2011-2020, grupmosha 5-vjeçare, Shqipëria.....	54
Figura 24 - Jetëgjatësia në lindje sipas seksit, 2011-2020, Shqipëria.....	55
Figura 25 - Dallimi midis jetëgjatësisë së femrave dhe meshkujve në lindje, 2011-2020, Shqipëria.....	55
Figura 26 - Bilanci migrator, 2011-2020, Shqipëria.....	56
Figura 27 - Efektiviteti i migracionit, 2011-2020, Shqipëria.....	56
Figura 28 - Norma e përgjithshme e pritshme e fertilitetit, 2021-2050, Shqipëri, të gjitha variacionet...	58
Figura 29 - Shpërndarja e pritshme e fertilitetit sipas moshës së nënës, 2021-2050, vite të përzgjedhura, Shqipëria, variacion mesatar.....	58
Figura 30 - Jetëgjatësia e pritshme në lindje sipas seksit, 2021-2050, Shqipëria, të gjitha variacionet.....	59
Figura 31 - Diferenca e pritshme në jetëgjatësinë në lindje midis meshkujve dhe femrave, 2021-2050, Shqipëria, të gjitha variacionet.....	59
Figura 32 - Kontributi i pritshëm i grupmoshave në ndryshimin e përgjithshëm të jetëgjatësisë në lindje në periudhën 2021-2050, meshkuj, Shqipëria, variacion mesatar.....	59
Figura 33 - Kontributi i pritshëm i grupmoshave në ndryshimin e përgjithshëm të jetëgjatësisë në lindje në periudhën 2021-2050, femra, Shqipëria, variacion mesatar.....	59
Figura 34 - Numri fillestar dhe i pritshëm i popullsisë gjithsej, 2020-2050 deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	61



# LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Figura 35 - Ndryshimi i pritshëm relativ i popullsisë së përgjithshme, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, të gjitha variacionet.....	61
Figura 36 - Bilanci i pritshëm i popullsisë, 2021-2050, Shqipëri, të gjitha variacionet.....	61
Figura 37 - Moshë mesatare fillestare dhe e pritshme e popullsisë sipas seksit, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria.....	62
Figura 38 - Ndryshimi i pritshëm i strukturës moshë-seks të popullsisë në periudhën 2020-2025 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	62
Figura 39 - Ndryshimi i pritshëm i strukturës moshë-seks të popullsisë në periudhën 2020-2030 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	62
Figura 40 - Ndryshimi i pritshëm i strukturës moshë-seks të popullsisë në periudhën 2020-2040 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	63
Figura 41 - Ndryshimi i pritshëm i strukturës moshë-seks të popullsisë në periudhën 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	63
Figura 42 - Madhësia fillestare dhe e pritshme e kategorive kryesore të grupmoshave, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), vite të caktuara, Shqipëria, variacion mesatar.....	63
Figura 43 - Raporti fillestar dhe i pritshëm i kategorive kryesore të grupmoshave, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), vite të caktuara, Shqipëria, variacion mesatar.....	63
Figura 44 - Shifrat fillestare dhe të pritshme të fëmijëve dhe të rinjve sipas grupmoshave të caktuara, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	64
Figura 45 - Shifrat fillestare dhe të pritshme të të moshuarve, sipas grupmoshave specifike, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëria, variacion mesatar.....	64
Figura 46 - Migracioni neto, numri i migrantëve në vit, 2011-2021.....	65
<hr/>	
Tabela 1 - Prirjet e normave të punësimit të meshkujt, sipas moshës (2012-2021).....	26
Tabela 2 - Prirjet e normave të punësimit të femrat, sipas moshës (2012-2021).....	26
Tabela 3 - Prirjet e raportit midis meshkujve të papunë dhe popullatës mashkullore në moshë pune, sipas moshës (2012-2021).....	27
Tabela 4 - Prirjet e raportit midis femrave të papuna dhe popullatës femërore në moshë pune, sipas moshës (2012-2021).....	27
Tabela 5 - Parashikimet e përbërjes së popullsisë në vitin 2021, 2026 dhe 2036, sipas moshës dhe gjinisë.....	31
Tabela 6 - Prirjet e popullsisë mashkullore në moshë pune sipas moshës (2012-2021).....	33
Tabela 7 - Prirjet e popullsisë femërore në moshë pune sipas moshës (2012-2021).....	33
Tabela 8 - Zhvillimet e pritshme të elementeve përbërëse të riprodhimit të popullsisë, 2021-2050, vite të caktuara, Shqipëria, të gjitha variacionet.....	57

# SHKURTESA

<b>AKP</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit
<b>CAGR</b>	Norma e Përbërë e Rritjes Vjetore
<b>COVID-19</b>	Sëmundja e virusit korona 2019
<b>ADSh</b>	Anketa Demografike dhe e Shëndetit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>EUROSTAT</b>	Zyra e statistikave e Bashkimit Evropian
<b>IHD</b>	Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta
<b>FES</b>	Fondacioni “Friedrich Ebert”
<b>PBB</b>	Produkti i Brendshëm Bruto
<b>GMDAC</b>	Qendra Globale e Analizës së të Dhënave të Migracionit
<b>IAL</b>	Institucion i arsimit të lartë
<b>IDF</b>	Fondi për Zhvillim i IOM-it
<b>IFAD</b>	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
<b>INSTAT</b>	Instituti Kombëtar i Statistikave
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
<b>AAFP</b>	Anketa e Aftësive të Forcës së Punës
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>AKPA</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>PKN</b>	Pajisje për kontrollin numerik
<b>NHMS</b>	Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>NPF</b>	Norma e përgjithshme e fertilitetit
<b>AFTP</b>	Arsimi dhe Formimi Teknik dhe Profesional
<b>MB</b>	Mbretëria e Bashkuar
<b>UNDESA</b>	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>OBPI</b>	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

# FALËNDERIM

Ky studim u financua nga Fondi i Zhvillimit i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). IOM-i iu shpreh mirënjohje personave që punuan për kryerjen e studimit.

Veçanërisht, IOM-i dëshiron të falënderojë të gjithë aktorët, agjencitë qeveritare dhe organizatat joqeveritare, të cilat ofruan kohën e tyre të vlefshme për të kontribuar në këtë studim, si dhe konsulentët e pavarur të përzgjedhur nga IOM-i, Tomáš Kučera dhe Andrea Salvini, konsulentë ndërkombëtarë dhe Endri Racon, konsulent vendas, të cilët kryen studimin. Studimi përfitoi nga ndihma dhe mbështetja teknike që dha Zyra Rajonale e IOM-it në Vjenë dhe Qendra Globale e Analizës së të Dhënave të Migracionit (GMDAC).

Raporti u rishikua nga disa persona dhe komentet e tyre ishin thelbësore për ta përmirësuar atë, konkretisht, znj. Majlinda Nesturi (INSTAT), z. Gentian Hoxhalli (konsulent i IOM-it), z. Genci Pjetri (IOM Tirana), znj. Edlira Muhedini (IOM Tirana) dhe z. Ermal Nazifi (IOM Tirana).

Redaktimi në gjuhën angleze dhe përkthimi në gjuhën shqipe u bënë nga Lisena Gjebrea dhe Enrieta Hasanaj.

Ky studim ka dy objektiva kryesore. Së pari, të ofrojë një vlerësim të gjithanshëm të prirjeve aktuale migratore në Shqipëri dhe, së dyti, të parashikojë ndikimin e tyre afatgjatë në forcën e punës në vend.

Studimi ndërtohet mbi një vlerësim të gjithanshëm të tregut të punës, që synon shqyrtimin e prirjeve të popullsisë në moshë pune, të punësimit dhe papunësisë dhe të forcës jashtë tregut të punës. Parashikimet demografike, të mbështetura nga skenarët e migracionit, ofrojnë tregues për evoluimin e popullsisë në moshë pune dhe, kështu, për çështje si qëndrueshmëria e ofertës së forcës shqiptare të punës dhe asaj të sistemit të sigurimeve shoqërore. Ky raport diagnostikues ofron një vlerësim gjithpërfshirës të ndikimit të prirjeve aktuale migratore në Shqipëri dhe synon të parashikojë ndikimin e tyre afatgjatë në forcën e punës. Parashikimet demografike, të mbështetura nga skenarët migratorë, ofrojnë tregues për evoluimin e popullsisë në moshë pune dhe, si rezultat, për çështje si qëndrueshmëria e ofertës së forcës shqiptare të punës dhe asaj të sistemit të sigurimeve shoqërore.

## Pjesa I - Prirjet e tregut të punës dhe analiza e migracionit

### 1. Metodologjia

Analiza e të dhënave të migracionit mbështet vlerësimin e tregut të punës për të dalluar prirjet afatgjata, ndërkohë që parashikimi demografik jep informacion për prirjet e popullsisë në moshë pune, që sinjalizojnë mungesat e mundshme në forcën e punës dhe, për rrjedhojë, migracionin e mundshëm të brendshëm në Shqipëri.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve studimore që paraqet ky raport, ekipi studimor shqyrtoi gjerësisht të dhënat parësore, që u plotësuan nga analiza dokumentare dhe shqyrtimin e të dhënave dytësore të prodhuara nga institucionet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve, ekipi studimor ka përdorur zbatimin e metodave të ndryshme të verifikimit krahasues të të dhënave, përfshi verifikimin krahasues të burimeve. Kjo nënkupton se çdo gjetje e rëndësishme paraprahe verifikohet duke përdorur të dhëna nga një larmi burimesh të pavarura. Për shembull, një sërë bazash të të dhënave janë përdorur për të nxjerrë prirjet e migracionit të jashtëm, si dhe dëshirën për të migruar jashtë vendit, përfshi bazat zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave, si INSTAT-i, EUROSTAT-i dhe UNESCO.

### 2. Përbërja e migracionit në Shqipëri

Pjesa dërrmuese e migrantëve të jashtëm janë të rinjtë midis moshës 20 deri në 39 vjeç, që ka mbetur konstante. Është me rëndësi të vërejmë se kjo grupmoshë shihet si më produktivja në kuptimin ekonomik.

Ka pasur një prirje në rritje të burrave që ka më shumë të ngjarë të emigrojnë sesa gratë. Të dhënat mund të tregojnë një prirje të burrat, të cilët shpesh kanë përgjegjësinë e personit që fiton jetesën në shoqërinë shqiptare, për të kërkuar punësim të përkohshëm jashtë, si një mënyrë për të ndihmuar familjet që kanë lënë pas. Numri i grave migrante pësoi rënie në periudhën 2016 – 2017, çka mund të jetë ndikuar apo të ketë pasur lidhje me krizën migratore të vitit 2015. Po kështu, luhatjet e grave migrante në periudhën 2019 – 2020 mund të jenë ndikuar nga pandemia COVID-19.

Po ashtu, të dhënat mund të tregojnë prirje më të lartë migratore të një force më pak të kualifikuar pune. Integrimi në forcën e punës së vendit pritisë është më i vështirë për femrat migrante me arsim të lartë. Gratë që punojnë në sektorin e shërbimeve dhe ato që angazhohen në punë elementare ka më shumë të ngjarë të emigrojnë sesa burrat. Po kështu, ka një prirje më të lartë migratore të burrat e angazhuar në bujqësi, zejtari dhe në fabrika.

#### ✓ Përbërja e migracionit të brendshëm drejt Shqipërisë

Shqipëria ka një bilanc migrator neto negativ, çka do të thotë se ka më shumë migrantë që largohen nga vendi sesa migrantë që hyjnë. Përbërja e migrantëve të brendshëm në Shqipëri është 64% burra dhe 36% gra. E njëjta gjë vlen për migrantët ndërkombëtarë dhe për të kthyerit. Mbi një e treta e mbajtësve të lejeve të qëndrimit po i afrohen moshës së pensionit ose janë tashmë mbi moshën e pensionit, çka nënkupton se kontributi afatgjatë i mbajtësve aktualë të lejeve të qëndrimit në tregun e punës mund të jetë edhe më i kufizuar sesa sugjerojnë shifrat absolute. Në vitin 2020, përqindja e evropianëve që kanë leje qëndrimi u ul në 56,8%, krahasuar me 66,4% në vitin 2019.

Kjo rënie ka gjasë të ketë lidhje me kthimet, si dhe me numrin e kufizuar të kërkesave të reja për leje qëndrimi, për shkak të kufizimeve të udhëtimit dhe lëvizjes të vendosura pas shpërthimit të pandemisë, COVID-19.

### 3. Prirjet e forcës së punës në Shqipëri

Ekonomia shqiptare ka treguar një rritje të qëndrueshme të PBB-së gjatë periudhës 2011-2021, me përjashtim të viteve 2015 dhe 2019. Kjo prirje rritëse, edhe sa i takon punësimit, do t'u ofrojë të rinjve që hyjnë në tregun e punës gjatë 15 viteve të ardhshme mundësinë të tërhiqen nga ekonomia vendase, si dhe nga tregu i punës në Evropën Perëndimore, i cili karakterizohet nga mungesa neto në të gjithë sektorët e ekonomisë. Nëse parashikimet ekonomike konfirmohen, ka të ngjarë që ekonomia do të vazhdojë të kërkojë më shumë njerëz për të mbështetur prodhimin dhe rritjen e saj.

Interes të veçantë përbën sektori bujqësor. Mundësitë e punësimit në pjesën perëndimore të Evropës ka të ngjarë ta lënë sektorin me mungesa, duke krijuar potencial për migracion të brendshëm. Nga njëra anë, kërkesa për forcë pune të pakualifikuar rrezikon shpesh të krijojë stimuj për migracionin e parregullt. Nga ana tjetër, pozicionet e lira të punës në vend për forcë të kualifikuar punëtore në bujqësi mund të paraqesin një mundësi për të ardhura më të larta për shqiptarët e papunë apo migrantët e rregullt nga Lindja.

Sistemi i rregullt i migracionit të brendshëm të Shqipërisë ka nisur të tërheqë punonjësit nga vende si Filipinet dhe vende të tjera të Azisë Jugore, sidomos në sektorin e prodhimit me punësim intensiv, që ka përjetuar një rigjallërim me zhvendosjen e aktiviteteve të prodhimit të veshjeve nga Azia Lindore gjatë pesë viteve të fundit. Potenciali i migracionit të brendshëm mund të ushqejë në mënyrë të ndërthurur jo vetëm sektorin e shërbimit, por edhe atë të bujqësisë.

#### ✓ Prirjet gjinore të punësimit dhe papunësisë

Shqipëria ende karakterizohet nga strukturat e familjes tradicionale, në të cilat burrat janë më të prirur të migrojnë; për rrjedhojë, dallimi ka të ngjarë të reflektohet në një prirje më të madhe migratore te burrat në moshë të re. Megjithatë, norma e punësimit të grave dhe burrave në grupmoshën 15-29 vjeçe është rritur nga vitet e rimëkëmbjes së krizës financiare dhe ekonomike globale (2012 e në vazhdim). Kjo sinjalizon një reagim të pakët për grupmoshat që ishin më të ekspozuara ndaj migracionit të jashtëm drejt Evropës Perëndimore dhe ShBA-ve në dekadat e kaluara. Prirja është më e theksuar te gratë sesa te burrat. Më tej, vendet e hapura të punës në sektorin e shërbimeve mund të kenë qenë më tërheqëse për gratë sesa për burrat. Dhjetë vitet e fundit, raporti midis të papunëve dhe popullsisë së përgjithshme në moshë pune është ulur për meshkujt e të gjitha grupmoshave.

Prirja e papunësisë shfaq dallime gjinore: edhe pse ulja në normat e papunësisë është e përbashkët për të gjitha grupmoshat e burrave gjatë periudhës së marrë në konsideratë, tregu i punës së grave tregon një tablo të përzier për dekadën e shkuar. Gratë në moshën kulmore (30-44 vjeçe) kanë qenë ato që kanë shfaqur prirjen më të ngjashme me burrat. Ndërkohë, situata është krejt ndryshe për gratë e reja, të cilat përjetuan luhajtje të variacionit të normës së papunësisë.

Politikat e punësimit me ndjeshmëri gjinore mund të lehtësojnë migracionin e jashtëm të grave, si dhe të krijojnë perspektiva për ato që dëshirojnë të qëndrojnë ose të kthehen në Shqipëri.

#### ✓ Punësimi – prirjet dhe perspektivat sektoriale

Me më shumë se një gjeneratë vonesë krahasuar me vendet e tjera evropiane, Shqipëria vazhdon të përballet me lëvizje ndërsektoriale, nga aktivitetet bujqësore tek ato jobujqësore. Prirja vlen si për gratë, ashtu edhe për burrat. Familjet që lënë veprimtaritë bujqësore do të vazhdojnë të rritin ushtrinë e rezervave në zonat urbane ku përqendrohen, duke qenë se, sipas literaturës, njerëzit nga zonat rurale janë më të prirur të migrojnë së brendshmi, në vend që të përfshihen në migracionin e jashtëm ndërkombëtar. Për këtë arsye, ka të ngjarë që mekanizimi i veprimtarive bujqësore të mos mundë të kapë ritmin e personave që largohen drejt zonave urbane. Kjo kërkon që politikëbërësit shqiptarë të gjejnë instrumente që lejojnë hyrjen e migrantëve për motive punësimi, të gatshëm të bëjnë punë në bujqësi. Nëse nuk ka alternativa të qëndrueshme të politikave migratore, kjo mund të çojë në rritjen e çmimeve të mallrave të shportës dhe artikujve të tjerë bujqësore, për një vend që ende varet shumë nga prodhimi vendas.

Ka disa vjet që studimet sektoriale vazhdojnë të raportojnë mungesa në fuqinë punëtore në bujqësi, si dhe në ndërtim dhe në prodhim, i cili ka intensitet punësimi. Për popullatën e meshkujve të punësuar, raportohen lëvizje midis sektorëve, nga sektori i shërbimeve tek ai industrial. Të dhënat zyrtare flasin për një prirje të kundërt te gratë. Këto lëvizje përqendrohen në sektorin e prodhimit, pasi punësimi në ndërtim jo vetëm mbizotërohet kryesisht

nga burrat, por përqindja e tij kundrejt aktiviteteve jobujqësore gjithsej u ul gjatë ciklit të kaluar ekonomik. Burrat e punësuar tregojnë po ashtu lëvizje nga sektori i minierave dhe nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe shërbimeve jo tregtare në shërbimet e tregut.

Të dhënat zyrtare raportojnë prirje pjesërisht të ndryshme për gratë, rënia e numrit të të cilave në aktivitetet industriale mund të shpjegohet ose nga një prani më e lartë e kontributit të tyre në aktivitete ku informaliteti është i lartë, ose/dhe nga lëvizjet në sektorët e karakterizuar nga forca e kualifikuar dhe e arsimuar e punës, konkretisht, shërbimet e tregut ose prodhimi me rendiment më të lartë. Në përgjithësi, prirjet sektoriale tregojnë një modernizim të ekonomisë shqiptare kombinuar me veprimtaritë ekonomike që kërkojnë forcë punë më të kualifikuar, krahasuar me të shkuarën.

Gratë janë të mbipërfaqësuar në shërbime krahasuar me meshkujt, të cilët ndërkohë përbëjnë shumicën e forcës së punës në prodhim se në sektorët tjerë të industrisë. Kjo prirje vazhdoi të polarizonte gratë dhe burrat në sektorët e ndryshëm, me një angazhim edhe më të madh të grave në shërbime. Kjo e fundit paraqet kërcënim për mbrojtjen e grave në tregun e punës, pasi punonjësit e shërbimeve janë më të ekspozuar ndaj pagave të ulëta dhe një punësim që u ofron mbrojtje të pakët në aktivitete ekonomike që, shpesh, janë më të rrezikuara nga marrëveshje kontraktore joformale.

Një forcë pune shqiptare, sidomos e grave, që është më e prirur të angazhojë punonjësit e kualifikuar, ka gjasë të jetë më tërheqëse jo vetëm për aktivitetet vendase, por edhe për sektorët me mungesa në Evropën Perëndimore, që kërkon kryesisht fuqi punëtore të kualifikuar. Përveç kësaj, ky tipar duhet të paralajmërojë politikëbërësit shqiptarë për nevojën për të krijuar alternativa migrimi të brendshëm jo vetëm për punonjësit e pakualifikuar, por edhe për ato profesione, sidomos në sektorin e shëndetësisë, ku prania e kandidatëve të kualifikuar shqiptarë ka gjasë të tkurret vitet e ardhshme.

Përgjithësisht, kërkesa e Shqipërisë për punonjës migrantë ka të ngjarë të pasqyrojë atë të vendeve që hyjnë për herë të parë në grupin e vendeve të destinacionit. Disa sektorë do të kërkojnë kryesisht forcën femërore të punës në pozicionet e gjysmë kualifikuara dhe me kualifikim të lartë. Punonjësit meshkuj do të kërkojnë në sektorët me kualifikim të ulët, si ndërtimi, minierat dhe bujqësia, kurse pozicionet e paplotësuara në prodhimin me produktivitet të ulët ka të ngjarë të tërheqë si burrat, ashtu edhe gratë. Numri i vendeve të punës të kërkuara në këto aktivitete industriale varet nga prirjet e zhvendosjes së aktiviteteve industriale nga Azia, kostot e të cilave janë rritur gjatë dekadës së shkuar.

#### 4. Prirjet aktuale të migracionit dhe ndikimet në sistemin arsimor në Shqipëri

Përtej rrjeteve familjare, gjetja e punësimit dhe arsimimi konsiderohen faktorë nxitës motivues. Motivi për t'u larguar nga Shqipëria në thuajse dy të tretat e rasteve është ekonomik, i lidhur me dëshirën për të përmirësuar standardet e jetesës dhe për të gjetur një punë. Ndryshe nga kjo, financimi i arsimimit të fëmijëve u raportua si motivi kryesor vetëm për 8% të emigrantëve shqiptarë. Megjithatë, arsimimi ka marrë më shumë rëndësi.

##### ✓ Politikat shtrënguese të imigracionit në vendet e destinacionit

Të tria vendet e destinacionit (Greqia, Italia dhe Gjermania) kanë ndërmarrë disa politika shtrënguese imigracioni mbi migrantët shqiptarë, me synimin për të kufizuar kohëzgjatjen e migrantëve të përkohshëm.

##### ✓ Faktorët specifikë tërheqës sipas vendit dhe vlerësimi i nevojave për aftësi

Krah politikave të imigracionit, nevojat faktike të tregut të punës dhe pragu i pagave në vendet e destinacionit faktorizohen në vlerësimet ekonomike të migrantëve të ardhshëm dhe, si të tilla, duhen marrë parasysh për të kuptuar dhe parashikuar prirjet migratore.

##### ✓ Parashikimi dhe paralajmërimet për skenarët e migracionit të jashtëm për motive punësimi në të ardhmen

Rritja e ngadaltë e ekonomisë në Itali dhe Greqi, e kombinuar me zgjerimin e korridoreve të migracionit të kualifikuar nga politikëbërësit gjermanë dhe të Mbretërisë së Bashkuar mund të favorizojnë një skenar në të cilin migrantët e ardhshëm shqiptarë t'u largohen vendeve 'tradicionale' të migracionit, Italisë dhe Greqisë, duke zgjedhur në vend të tyre shtete si Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, me prag më të lartë të pagave minimale, kushte më të mira pune dhe jetese dhe një perspektivë më të mira integrimi në përgjithësi.

Megjithatë, analiza e nevojave të tregut të punës në vendet e destinacionit duhet kontekstualizuar gjithnjë nga faktorë të tjerë të pasigurt: për shembull, objekti dhe rreptësia e rregullave të migracionit për motive punësimi; rregulla të mundshme kufizimi për shkak të një vale tjetër të COVID-19-ës ose pasojat e konfliktit në Ukrainë mbi ekonominë dhe tregun e punës.

## 5. Migracioni dhe zgjedhjet arsimore

Shumë vende evropiane të zhvilluara kanë hartuar politika për të tërhequr të diplomuarit me kualifikim të lartë nga vendet më pak të zhvilluara. Nga ana tjetër, shumica e të rinjve shqiptarë aspirojnë të emigrojnë në vende të tjera të BE-së. Edhe pse vetëm 7% shprehen se arsimimi është arsyeja kryesore e migracionit, shumica dërrmuese e këtyre migrantëve të mundshëm të jashtëm (44% e tyre) janë studentë.

Migrantët e ardhshëm zgjedhin të studiojnë jashtë si një hap drejt migracionit afatgjatë në vendin pritës.

## 6. Faktorët shtytës dhe tërheqës të korridorit qendër-periferi të migracionit.

Shumë vende të zhvilluara kanë investuar qëllimisht për t'u bërë më tërheqëse për një lloj të caktuar migrantësh, që janë punonjës të rinj e të kualifikuar nga e gjithë bota. Grupi i faktorëve tërheqës përfshin promovimin e stimujve të caktuar financiarë, si dhe heqjen e pengesave politike dhe ligjore për të migruar. Vendet qendrore të zhvilluara evropiane kanë rritur fuqinë e butë, që do të thotë shkallën tërheqëse të modelit të tyre politik e kulturor. Për më tepër, këta faktorë shtytës veprojnë si frenues për migracionin e kthimit, duke i shkrajuar shumë punonjës të kualifikuar të kthehen në atdhe, edhe nëse do të donin ta bënin. Shumica e të rinjve (69% e tyre), kur pyeten për arsyen kryesore se pse duan të migrojnë, përmendin standardet më të mira të jetesës.

Një tjetër faktor shtytës, që i ndalon të rinjtë shqiptarë të kthehen në Shqipëri është fakti se tregu vendas i punës nuk iu kthen dot investimin financiar për arsimimin e tyre.

## 7. Ndikimi i imigracionit dhe imigracioni i kthimit në tregun e punës në Shqipëri gjatë COVID-19

Pandemia COVID-19 ndikoi në prirjet migratore nga Shqipëria dhe drejt saj, në vijim të kufizimeve të lëvizjes që u vendosën nga Shqipëria dhe vendet kryesore të destinacionit, por edhe për shkak të efekteve të menjëhershme në tregun shqiptar të punës, i cili përjetoi largime nga puna në masë të madhe, rritje të papunësisë dhe shtim të informalitetit. Pas shpërthimit të COVID-19-ës, shumë migrantë shqiptarë u detyruan të ktheheshin, pasi humbën punën – përkohësisht ose në mënyrë të përhershme – në vendet e destinacionit ose u përballën me shkurtim pagash.

Një efekt i dytë i tërthortë i COVID-19-ës në tregun shqiptar të punës ishte se papunësia dhe shkurtimi i pagave të punonjësve migrantë shqiptarë jashtë vendit me gjasë kanë kontribuar në uljen e dërgesave të marra nga familjet shqiptare. Një raport i fundit e BERZh-it tregon se dërgesat në vitin 2020 ranë me thujse 20%. Thuajse një e katërta e familjeve shqiptare mbështeten tërësisht te dërgesat si burim i të ardhurave. Kjo nënkupton se humbja e të ardhurave për shkak të papunësisë së një familjari migrant krijon boshllëqe të menjëhershme në nivelin jetësor ekonomik të një mase të konsiderueshme të familjeve shqiptare.

Flukset hyrëse të migrantëve ndërkombëtarë pësuan rënie të konsiderueshme pas shpërthimit të pandemisë Covid-19. Megjithatë, ende nuk ka të dhëna të konsoliduara për aktivitetet ekonomike të punonjësve ndërkombëtarë migrantë në Shqipëri.

## Pjesa II - Parashikimi i popullsisë së Shqipërisë për periudhën 2021-2050

### 1. Qasja metodologjike

Zhvillimi (dinamika) i popullsisë ose demografik është procesi i ndryshimit të popullsisë së dhënë në madhësi dhe në strukturën moshë-seks. Përcaktuesit e drejtpërdrejtë të këtij ndryshimi janë madhësia fillestare e popullsisë dhe struktura moshë-seks dhe proceset e pjesshme (komponentë) e riprodhimit të popullsisë - fertiliteti (lindshmëria), vdekshmëria, imigracioni dhe emigracioni.

Në rastin e Shqipërisë dhe popullsisë së saj, çdo përpjekje përshkruese, analitike dhe, për rrjedhojë, parashikuese u mbështet nga bazat e plota të të dhënave të popullsisë të siguruara nga INSTAT-i. Si burim informacioni u përdorën vetëm statistika zyrtare. Të dhënat e ofruara për stoqet dhe flukset bënë të mundur përpunimin e analizës përfaqësuese të popullsisë dhe parashikimin e plotë për Shqipërinë.

Kur punohet me rezultatet e çdo parashikimi, është e nevojshme të mbahen parasysh se përfundimet e prognozës janë një lloj specifik i vlerësimit të cilësuar. Si të tilla, ato kanë karakter probabilist dhe mbartin një shkallë më të madhe ose më të ulët pasigurie. Po ashtu, është e nevojshme të kujtohet se besueshmëria e rezultateve ulet në mënyrë domethënëse me shkurtimin e periudhës kohore. Parashikimet e popullsisë duhen përditësuar sistematikisht mbështetur në rregullat bazë të parashikimit dhe rekomandimet ndërkombëtare të pranuar për të ruajtur vlerën fillestare të dobisë së tyre.

## 2. Riprodhimi dhe komponentët aktualë të popullsisë

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, riprodhimi i popullsisë në Shqipëri kaloi në një pjesë të konsiderueshme të tranzicionit nga mënyra tradicionale e riprodhimit (ekstensive) tek ajo moderne (intensive).

Dhjetë vitet e shkuara (2011-2020), për të cilat kishte statistika zyrtare të hollësishme dhe të plota, u shënuan nga ulja e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Gjatë kësaj periudhe relativisht të shkurtër, popullsia e vendit u ul me rreth 78 mijë banorë, d.m.th., thajse 2,7 për qind. Numri i meshkujve u ul me rreth 46 mijë (3,1%) dhe i femrave me 32 mijë (2,2%).

Një tjetër karakteristikë dhe, në të njëjtën kohë, një tipar i veçantë i zhvillimit aktual të popullsisë së Shqipërisë është ndryshimi i strukturës së seksit të popullsisë. Procesi i migracionit dhe plakjes së popullsisë, së bashku me dallimet në vdekjen natyrore midis seksëve ka sjellë së pari një ulje të konsiderueshme të raportit të femrave në popullsinë e Shqipërisë në periudhën 2010-2015, nga 49,9% në 49,3% dhe, më pas, rritjen e kësaj vlere karakteristike në vitin 2020.

Përqindja e fëmijëve dhe adoleshentëve (0–19 vjeç) u ul me më shumë se tetë pikë përqindje, nga 31,4% në 23,2%. Të moshuarit u rritën në përqindje me më shumë se katër pikë përqindje, nga 11,0% në 15,2%. Për pasojë, popullsia në moshë riprodhuese (15-64 vjeç) e rriti përfaqësimin në popullsinë e vendit. E ashtuquajtura dritare e mundësisë demografike ishte e hapur në maksimum deri kohët e fundit. Megjithatë, ajo ka nisur me gjasë të mbyllet qyshkur u arrit përqindja më e lartë e popullsisë në moshë riprodhuese në vitin 2020.

Fertiliteti i përgjithshëm i femrave në Shqipëri ishte në nivelin mesatar evropian (midis 1,6 dhe 1,7 lindjeve të gjalla për femër). Megjithatë, shkalla e përgjithshme e fertilitetit pas vitit 2014 ra në rreth 1.3 lindje të gjalla. Ato u renditën në zonën “e fertilitetit më shumë se të ulët”.

Ndryshimet e vrojtuar në shpërndarjen moshore të fertilitetit në Shqipëri përkojnë me ndryshimet e hasura nga shumë vende, konkretisht, ato evropiane, më parë dhe kryesisht në nivele më të larta të fertilitetit të përgjithshëm. Gjatë vrojtimit të 10 viteve, jetëgjatësia u rrit në fillim, në rastin e meshkujve, nga 75,3 në 77,4 vjeç dhe në rastin e femrave, nga 79,9 në 80,9 vjeç. Sërish, pasojat e vdekshmërisë nga pandemia COVID-19 i kthyen vlerat empirike të jetëgjatësisë në lindje për të dyja sekset në vlerat e tyre të vitit 2011.

Përveç rritjes së jetëgjatësisë në lindje, u vërejt një rënie e konsiderueshme e vdekshmërisë përtej parashikimit të meshkujt (diferenca në jetëgjatësi midis femrave dhe meshkujve). Ky hendek është ngushtuar nga 4,6 vjet në vitin 2011 në më pak se 3,2 vjet në vitin 2017, për t'u kthyer në diferencën fillestare 4,6 vjet gjatë vitit të parë të pandemisë COVID-19.

Aktualisht, migracioni është komponenti më i rëndësishëm i zhvillimit të popullsisë së Shqipërisë, që përcakton karakterin e riprodhimit të përgjithshëm të popullsisë.

## 3. Perspektivat aktuale të zhvillimit të popullsisë

Statistikat zyrtare kombëtare për popullsinë tregojnë disa ndryshime të rëndësishme. Së pari, niveli dhe struktura moshë-seks e vdekshmërisë ndryshoi në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2020. Së dyti, kufizimet e pashembullta ndërkombëtare të lëvizjes së njerëzve, të vendosura për shkak të epidemisë, prekën kryesisht flukset migratore në kufijtë shtetërorë. Në vitin 2020, vetëm fertiliteti vazhdoi në nivelet e përcaktuara tashmë në vitin 2014 dhe nuk u vërejt asnjë ndryshim i jashtëzakonshëm.

Vazhdimi i pandemisë COVID-19, pasojat e saj me ndikim të gjerë dhe situata e re e sigurisë në Evropë pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, në shkurt 2022, krijuan kushte të reja parashikimi. E gjithë kjo solli pasiguri më të madhe në vizionin aktual për popullsinë e Shqipërisë në të ardhmen.

### ✓ Vështrim i shkurtër i hipotezave bazë

Kur vlerësuam zhvillimet e parametrave të fertilitetit, vdekshmërisë dhe migracionit në të ardhmen, ne ndoqëm



prirjet e fundit të identifikuar në analizën e detajuar të të dhënave të statistikave zyrtare të popullsisë. Niveli i përgjithshëm i fertilitetit në Shqipëri do të stabilizohet thuajse në nivelin e arritur në vitin 2019 dhe 2020, d.m.th., në rreth 1,3 lindje të gjalla për femër. Rënia afatgjatë në normat e vdekshmërisë ka ndalur, por duket se është vetëm e përkohshme. Ne supozojmë se një zhvillim i ngjashëm do të ndodhë edhe në rastin e migracionit, sidomos në komponentin e tij të emigracionit.

#### 4. Analiza e parashikimit

Rezultatet e parashikimit tregojnë se numri i përgjithshëm i banorëve në Shqipëri ka gjasë të ulët thuajse në mënyrë lineare gjatë tri dekadave të ardhshme. Nëse supozojmë se popullsia e vendit në fund të vitit 2020 ishte 2,83 milionë banorë, numri i përgjithshëm duhet të arrijë në nivelin pre 2,34 milionë banorësh brenda një kufiri realist midis 2,06 dhe 2,64 milionë banorësh deri në vitin 2050. Arsytet e kësaj rënieje janë të qarta - lindshmëria e ulët dhe në rënie, për shkak të tkurrjes së numrit të nënave të mundshme dhe fertilitetit të ulët; një numër relativisht i lartë dhe në rritje i vdekjeve të shkaktuara nga rritja e numrit të personave të moshuar dhe më dinamik sesa ulja e intensitetit të vdekshmërisë; plus, shkëmbimi migrator me humbje të larta gjatë një të tretës fillestare të periudhës së parashikimit.

##### ✓ Ndryshimet e pritshme në strukturën moshore të popullsisë

Rënia e numrit të popullsisë do të shoqërohet me plakjen e vazhdueshme të popullsisë, e përcaktuar kryesisht nga struktura fillestare moshore e popullsisë. Ne presim që mosha mesatare e popullsisë të rritet, nga vlera e saj fillestare 39,4 vjeç, në 49 vjeç deri në vitin 2050, sipas variantit mesatar të parashikimit.

Popullsia femërore e Shqipërisë duhet të jetë mesatarisht rreth 50 vjeçe. Popullsia mashkullore pritet të jetë thuajse dy vjet më e re se ajo femërore deri në fund të periudhës së parashikimit.

Ky ndryshim në moshën mesatare midis meshkujve dhe femrave është logjik. Ai rrjedh nga dy fakte: një përqindje natyrore më e lartë e djemve mes të sapolindurve dhe vdekshmëria përtej parashikimeve të pritshme të meshkujve të të gjitha moshave, duke sjellë numër më të madh të femrave në moshat më të mëdha.

##### ✓ Zhvillimi i kategorive të caktuara moshore

Numri i segmentit të popullsisë në moshë produktive ekonomikisht (20-64 vjeç) arriti në rreth 1,74 milionë persona në fund të vitit 2020. Rënia më e madhe absolute ka të ngjarë të ndodhë në vitet 2030.

Kontingjenti i përgjithshëm i fëmijëve dhe adoleshentëve në moshën deri në 23 vjeç duhet të ulët me rreth 47 për qind. Në nivelin e nëngrupeve individuale, rënia relative pritet të luhatet midis 44% dhe 50% në periudhën 2020-2050.

Nga kategoritë e qytetarëve të moshuar, dekadat e ardhshme qendra e rëndësës do të zhvendoset nga qytetarët e moshuar më të rinj tek ata më të vjetër. Rritja e numrit të personave të moshuar do të çojë në rritje të konsiderueshme të kërkesave për sigurime pensioni dhe kujdes shëndetësor që mbulohet nga buxheti publik.

#### 5. Përfundime

Analiza e riprodhimit të popullsisë së Shqipërisë, bazuar në njohuritë teorike, na jep mundësi të bëjmë pohimet e mëposhtme:

Fertiliteti shfaq në përgjithësi vlera të ulëta që i përkasin zonës demografike që emërtohet si fertiliteti më shumë se i ulët.

Intensiteti i vdekshmërisë u ul gjatë njëzet viteve të shkuara deri në shpërthimin e pandemisë COVID- 19. Më pas, ulja e vdekshmërisë duhet të vazhdojë në një linjë me prirjen përpara Covid-it dhe jetëgjatësia mesatare e femrave dhe meshkujve duhet të rritet po ashtu. Kjo rritje e jetëgjatësisë në lindje duhet të mbetet e konsiderueshme, por, në të njëjtën kohë, duhet të humbasë ngadalë dinamikën e saj.

Vëllimet e migracionit përtej kufijve të Shqipërisë do të ulen me shumë gjasë, për shkak të rënies së numrit të popullsisë dhe plakjes, që çon kryesisht në një numër gjithnjë e më të vogël të grupmoshave të reja – baza e potencialit migrator.

Fluksi i rëndësishëm dalës i të rinjve që vijon më tej në një të tretën e parë të periudhës së parashikimit do të përcaktojë popullsinë dhe plakjen e popullsisë në Shqipëri.

Duke marrë në konsideratë këto gjetje dhe pritshmëri, është e qartë se ndryshimet më të mundshme në numrin dhe strukturën seks-moshë të popullsisë së Shqipërisë do të kenë pasoja me ndikim të gjerë, që do të prekin

thuaje çdo aspekt të jetës së shoqërisë. Këto ndryshime do të ndikojnë pa dyshim te fushat kryesore me interes publik, si financat publike, sigurimet dhe ndihma sociale, sistemi shëndetësor publik dhe tregu i punës. Për më tepër, efektet e zhvillimit demografik mbi këta sektorë janë të ndërlidhura.

Plakja e shpejtë e popullsisë po vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e sistemit aktual të pensioneve. Kjo do të jetë një nga çështjet kryesore për t'u zgjidhur në kontekstin e zhvillimit të supozuar të popullsisë.

Popullsia në moshë produktive që përfaqëson forcën e mundshme të punës do të pësojë padyshim rënie dinamike dhe, në të njëjtën kohë, do të plakët gjatë periudhës së parashikuar. Këto ndryshime do të dobësojnë kërkesën për vende pune dhe potencialin për punë të popullsisë, duke ngritur kështu shqetësime për zhvillimin e popullsisë së Shqipërisë në të ardhmen.

Është thelbësore që të fillohet të vepohet në përputhje me këtë dhe të studiohet sistematikisht e ardhmja demografike dhe konteksti i saj dhe me më shumë hollësi, kur hartohen politikat. Parashikimet e popullsisë dhe rezultatet e modelit të parashikimit duhet të luajnë rol kryesor në hartimin dhe monitorimin e politikave të tilla.

### **Pjesa III - Rekomandimet për politika**

Kjo pjesë e raportit paraqet një gamë çështjesh që duhen marrë në konsideratë nga politikëbërësit gjatë ciklit të ardhshëm programor. Konkretisht, ato cekin modelin e rritjes, varësinë e tij nga dinamikat migratore dhe alternativat politike për t'i ulur këto varësi apo për t'i menaxhuar në mënyrë të sigurt dhe të rregullt.

#### **1. Alternativat ekzistuese të politikave publike për trajtimin e ndryshimeve demografike që sigurojnë një ofertë të mjaftueshme të forcës së punës në tregun shqiptar të punës, duke mbajtur parasysh perspektivën e ndjeshmërisë gjinore të politikave dhe të drejtat dhe mbrojtjen e punonjësve (migrantë).**

Shqipëria po përballë me një situatë të karakterizuar nga një ekonomi që jo vetëm rritet, po krijon gjithashtu vende pune. Megjithatë modeli socialekonomik i Shqipërisë vazhdon të jetë i rrënjësor thellë te migracioni i jashtëm dhe përfitimet e tij – dërgesat, çlirimi i trysnive të papunësisë, kthimi qarkullues i migrantëve me kualifikim të lartë. Kjo nënkupton se punëdhënësit shqiptarë po përballen dhe do të vazhdojnë të përballen në të ardhmen e afërt me sfida serioze në tërheqjen e forcës së punës me kualifikim të ulët dhe gjysmë të kualifikuar për të plotësuar vendet e lira të punës në rritje.

*Cilat janë alternativat e politikave për ta trajtuar dhe luftuar këtë mungesë ekuilibri?*

Së pari, rritja e produktivitetit të ekonomisë në tërësi, për të kërkuar më pak punonjës me të njëjtin nivel rendimenti.

Së dyti, lidhja e produktivitetit me pagat, duke e bërë tërheqës tregun e punës.

Së treti, përmirësimi i gjithë sistemit të menaxhimit të migracionit, duke faktorizuar si duhet migracionin e jashtëm dhe kompensimin e tij (të mundshëm) nga migracioni i brendshëm dhe i kthimit, si variable të fuqishme që ndikojnë në tregun e punës dhe në strukturën e forcës së punës vendase dhe të huaj në Shqipëri.

Së fundi, me një vizion për të ardhmen, politikëbërësit shqiptarë duhet të shqyrtojnë alternativat e politikave demografike dhe sociale që ofrojnë stimuj për familjet me fëmijë, duke u siguruar në të njëjtën kohë grave kanale për të hyrë sërish në tregun e punës pas periudhave të fertilitetit. Kjo siguron rezultate pozitive gjinore dhe punësimi edhe brenda një periudhe afatshkurtër.

#### **2. Mësimet që mund të nxirren nga përvoja e vendeve të ngjashme me Shqipërinë për t'u përballur me rrjedhjen e trurit dhe për të nxitur qarkullimin e trurit.**

Mësimet e nxjerra nga përvoja e vendeve të ngjashme me Shqipërinë, d.m.th., përjetimi i një migracioni negativ neto të vazhdueshëm, tregon se duhen identifikuar elementet për t'u marrë në konsideratë lidhur me rrjedhjen e trurit – dhe duhen hartuar strategjitë e përshtatshme përkatëse, si skema për qarkullimin e trurit – në nivele nënsektoriale e madje edhe profesionale. Sa u takon skemave të qarkullimit të trurit, stimujt e lëvizshmërisë së Shqipërisë duhen kombinuar me politika industriale në mënyrë të tillë që zhvendosja e proceseve prodhuese në Evropën kontinentale të përputhet me aftësitë e përfutuara nga të kthyerit që kanë punuar në profesione të kualifikuara prodhuese jashtë vendit.

# PJESA I - PRIRJET E TREGUT TË PUNËS DHE ANALIZA E MIGRACIONIT

## 1.1 - Metodologjia

Ky raport vlerësimi paraqet një pamje të gjithanshme të ndikimit të prirjeve aktuale migratore në Shqipëri dhe synon të parashikojë ndikimin e tyre afatgjatë të forca vendase e punës. Raporti ndërtohet mbi një punë gjithpërfshirëse të vlerësimit të tregut që këqyr prirjet e popullsisë në moshë pune, punësimin, papunësinë dhe personat që nuk punojnë, nuk ndjekin arsimin dhe nuk janë në kërkim të punës. Parashikimet demografike, të mbështetura nga skenarët e migracionit, ofrojnë tregues mbi evoluimin e popullsisë në moshë pune dhe, për rrjedhojë, mbi çështje si qëndrueshmëria e ofertës së punës në Shqipëri dhe ajo e sistemit të sigurimeve shoqërore. Parashikimet e zhvillimit të popullsisë për periudhën 2020-2050 - të përpiluara nga (Kucera 2022) – shërbejnë si bazë për parashikimet e nxjerra, efektet e të cilave analizohen nga ky raport, së bashku me vlerësimet për tregun e punës dhe migracionit.

Për të trajtuar pyetjet studimore që paraqet ky raport, ekipi studimor shqyrtoi gjerësisht të dhënat parësore, që u plotësuan nga analiza dokumentare dhe shqyrtimin e të dhënave dytësore të prodhuara nga institucionet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekipi studimor i plotësoi të dhënat e vlefshme publikisht nga INSTAT-i dhe burime të tjera të ofruara nga qeveria shqiptare me kërkesa për të dhëna nga institucionet qeveritare përkatëse. Ekipi dëshiron të shprehë mirënjohjen për mbështetjen bujare të INSTAT-it, tabelat e përkohshme të të dhënave të cilat na ofruan informacion thelbësor për këtë raport.

Ushtrimet e parashikimit sasior u ndërtuan nga tabelat kryesore dhe marrin në konsideratë e parashikojnë demografinë, pjesëmarrjen në forcën e punës dhe variablet e punësimit, me qëllim që të vlerësojnë skenarët e zhvillimit sektorial, duke pasur si qëllim përfundimtar analizën dhe identifikimin e efekteve të atyre politikave që do të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi migracionin 10 vitet e ardhshme. Analiza e të dhënave të migracionit mbështet vlerësimin e tregut të punës, për të shquar prirjet afatgjata, ndërkohë që parashikimi demografik siguron informacione për prirjet e popullsisë në moshë pune që sinjalizojnë mungesa të fuqisë punëtore dhe, për rrjedhojë, potenciale për migracion të brendshëm në Shqipëri. Bashkë me prirjet sektoriale, këto të fundit mund të orientojnë mungesat e mundshme të aftësive në sektorë të tillë si ndërtimi, bujqësia, prodhimi ose kujdesi në ekonomi. Së fundi, u krye një shqyrtim sistematik i korpusit ekzistues të literaturës për të marrë informacion për rekomandimet për politika që jepen në këtë raport.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve studimore të këtij raporti, ekipi u detyrua të mbështetej kryesisht te burimet dytësore të të dhënave. Për këtë u përdor analiza dokumentare, duke shfrytëzuar dokumentet dhe të dhënat dytësore të prodhuara nga një sërë institucionesh kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar: Institutin Kombëtar të Statistikave (INSTAT) dhe Anketën e tij të Aftësive të Forcës së Punës (AAFP), EUROSTAT-in, IOM-in, UNESCO-n, UNICEF-in, Fondacionin "Friedrich Ebert" (FES), Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (MAS), Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe institute të tjera kërkimore vendase, si IDRA dhe IDM-ja. Për më tepër, ekipi studimor mori dhe analizoi një sërë ligjesh, aktesh nënligjore dhe dokumente politikash (p.sh., strategji, vendime dhe urdhra). Përveç kësaj, u krye një shqyrtim sistematik i korpusit ekzistues të literaturës për t'i vendosur gjetjet e këtij studimi në një kontekst më të gjerë social dhe ekonomik.

Së pari, ekipi studimor përpiloi një listë të të dhënave të nevojshme për studimin, që përfshinë të dhënat demografike dhe të tregut të punës dhe, më pas, u organizua një analizë paraprake e burimeve të të dhënave.

Më tej, ekipi studimor u vu në kontakt me INSTAT-in dhe institucionet e tjera përkatëse të përmendura më lart, për të marrë të dhënat e nevojshme. Së fundi, ekipi studimor vizitoi faqet zyrtare të internetit dhe burime të tjera të vlefshme publikisht (p.sh., gazeta zyrtare), për të përfutur të dhënat e nevojshme për këtë studim.

### • Analiza e të dhënave, vlefshmëria dhe besueshmëria e gjetjeve

Studimi i dokumenteve përfshiu një analizë gjithpërfshirëse të kuadreve përkatëse të politikave lidhur me mbrojtjen, mbrojtjen sociale dhe bashkëpunimin rajonal ose ndërkombëtar.

Për vlerësimin e situatës aktuale të forcës së tregut të punës, ekipi studimor i analizoi të dhënat përmes procesit të përsëritur të thjeshtimit të të dhënave. Një theks i veçantë u vendos tek analiza e të dhënave dhe interpretimi

i tyre nga një optikë me ndjeshmëri gjinore, që u bë e mundur përmes marrjes dhe organizimit të të dhënave statistikore sipas gjinisë.

Më tej, u përdorën konceptet e “hermeneutikës kritike” dhe testet e rezultateve shtesë për të rritur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve. Kjo nënkupton se në analizën e dokumenteve u përdor modeli i “hermeneutikës kritike” (Philips & Brown’s, 1993) për t’i analizuar tekstet në një kontekst më të gjerë social dhe ekonomik. Për ta ilustruar, në mënyrë që të përftohej ndikimi i migracionit të mundshëm mbi ekonominë shqiptare, të dhënat statistikore u analizuan në kontekst me informacionet e tjera që kemi lidhur me strukturën ekonomike të Shqipërisë, zhvillimet e fundit dhe dukuritë shoqërore afatgjata që kanë qenë të pranishme në shoqërinë shqiptare. Po kështu, u përdor testi ndihmës për të testuar gjetjet paraprake të këtij studimi, duke mbledhur të dhëna shtesë që konfirmonin ose nuk konfirmonin gjetjet tona. Për shembull, gjetjet paraprake që tregonin dëshirë të madhe për të emigruar te studentët shqiptarë u krahasuan me të dhënat statistikore mbi normat faktike të migracionit të jashtëm të studentëve, si dhe përpjekjet reale që ata kanë bërë për të studiuar në një vend tjetër, si numri i aplikimeve të paraqitura për të studiuar jashtë.


Për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve, ekipi studimor ka përdorur zbatimin e metodave të ndryshme të verifikimit krahasues të të dhënave, përfshi verifikimin krahasues të burimeve. Kjo nënkupton se çdo gjetje e rëndësishme paraprake verifikohet duke përdorur të dhëna nga një larmi burimesh të pavarura. Për shembull, një sërë bazash të të dhënave janë përdorur për të nxjerrë prirjet e migracionit të jashtëm, si dhe dëshirën për të migruar jashtë vendit, përfshi bazat zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave, si INSTAT-i, EUROSTAT-i dhe UNESCO.

Siç mund të shihet nga lista e referencave, për t’iu përgjigjur pyetjeve studimore, janë përdorur burime të ndryshme. Për më tepër, është përdorur verifikimi i vlefshmërisë përmes komenteve, për të konfirmuar gjetjet, që përfshin konfirmimin e gjetjeve tona paraprake përmes personave të informuar. Përveç kësaj, verifikimi përmes komenteve u siguroi me seminare të verifikimit të vlefshmërisë të organizuara nga IOM-i me përfaqësues të institucioneve publike.

## 1.2 - Përbërja e migracionit në Shqipëri


Kjo rubrikë trajton përbërjen e migracionit të jashtëm. Të dhënat e INSTAT-it (2022) tregojnë se pjesa më e madhe e migrantëve të jashtëm janë të rinj midis moshës 20 dhe 39 vjeçe (shih Grafikonin 1 më poshtë). Edhe pse numri i përgjithshëm i migrantëve të jashtëm është ulatur me kalimin e viteve, përqindja e grupit në fjalë mbetet konstante. Është me rëndësi të theksohet se kjo grupmoshë shihet si më produktivja në terma ekonomike (Grosse et.al, 2009). Më tej, duke pasur parasysh se kjo grupmoshë ka më shumë të ngjarë të lindë fëmijë, flukset e tyre migratore mund të ketë efekte të mëtejshme afatgjata për popullsinë e vendit dërgues (d.m.th., Shqipërinë).

Grafiku-1. Emigracioni sipas moshës




Sa i takon gjinisë, Grafiku 2. (më poshtë) tregon se, gjatë viteve, ka pasur një rritje të prirjes së burrave që ka të ngjarë më shumë të emigrojnë sesa gratë. Këto të dhëna mund të tregojnë një prirje të burrave, të cilët, shpesh, mbajnë përgjegjësitë e atij që fiton jetesën në shoqërinë shqiptare, për të kërkuar punësim të përkohshëm jashtë, si një mënyrë për të ndihmuar familjen që kanë lënë pas. Për shembull, është parë se në periudhën 2016 – 2017, numri i grave migrante pësoi rënie duke shkuar në rreth një të katërtën e atij që ishte një vit më parë, çka mund të jetë ndikuar ose të kishte lidhje me krizën e migrantëve të vitit 2015. Nga ana tjetër, luhatjet në numrin e grave migrante në vitin 2019 – 2020 mund të jenë ndikuar nga pandemia Covid-19 dhe kufizimet e udhëtimit që e shoqëruan.

Grafiku-2. Emigracioni sipas moshës



Në përputhje me këtë, të dhënat e IOM-it (2022), të paraqitura në Grafikon 3 (më poshtë), tregojnë se gratë kanë më pak të ngjarë të bëhen migrante të jashtme.


Grafiku-3. Gjinia e migrantëve të jashtëm



Megjithatë, luhatjet në grafik mund të tregojnë edhe një prirje më të lartë të burrave në moshë të re për të marrë rreziqe dhe për të qenë të parët që emigrojnë, me shpresën për të marrë partneret e tyre me vete më vonë. Grafiku 4 (më poshtë) tregon se, edhe pse raportohet që 78% e migrantëve të jashtëm kanë fëmijë, vetëm pak (4%) prej tyre kanë më shumë se tre fëmijë. Në përputhje me këtë, mund të argumentojmë se të pasurit

e fëmijëve mund të veprojnë edhe si frenues për njerëzit që të emigrojnë. Megjithatë, kjo mund të tregojë edhe një prirje për migrantët e ardhshëm që të mos kenë fëmijë derisa të kenë arritur të shkojnë në një vend pritës. Thënë kjo, ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në këto rezultate, si mosha e migrantëve, karriera e ardhshme në vendin pritës dhe planet jetësore, që ndikojnë në vendimin e tyre për të migruar. Sa i takon ndryshimit midis zonave rurale dhe urbane, ka një prirje paksa më të lartë të migrantëve të jashtëm ruralë të emigrojnë nëse kanë fëmijë.


**Grafiku-4. Origjina e migrantëve të jashtëm**



Sa i takon arsimimit, ashtu siç tregon Grafiku 5 (më poshtë), vetëm një fraksion, 13%, i migrantëve të jashtëm kanë përfunduar arsimin e lartë në Shqipëri (IOM, 2022). Këto të dhëna mund të tregojnë një prirje më të lartë migratore të forcës më pak të kualifikuar të punës, por kjo nuk do të ishte në përputhje me të dhënat e shfaqura në Grafikon 5 (më poshtë). Në fakt, politikat përzgjedhëse të migracionit në disa prej vendeve pritëse shpesh konceptohen duke pasur parasysh forcën e kualifikuar të punës. Studiues të ndryshëm, të mbështetur nga të dhënat, kanë treguar se gjatë dekadave të fundit, një kombinim i politikave përzgjedhëse të imigracionit u ka dhënë mundësi vendeve të zhvilluara të tërheqin ‘më të mirët dhe mendjet më të ndritura’ (Lucas, 2005; Teferra, 2005; Faini, 2003; Cervantes & Guellec, 2002).


Nga ana tjetër, këto të dhëna mund të tregojnë edhe njëanshmëri të dhënave të INSTAT-it për mbledhjen e të dhënave kryesisht mbi azilkërkuesit që mund të tregojnë prirje për të pasur një nivel arsimor më të ulët.

**Grafiku-5. Niveli arsimor i migrantëve të jashtëm**




Statistikat e IOM-it (2022), të paraqitura në Grafikon 6 (më poshtë), tregojnë se burrat me diplomë universitare ka më shumë të ngjarë të punësohen sesa gratë me diplomë të nivelit të tretë apo se burrat me diplomë të shkollës së mesme. Duke marrë parasysh se nuk ka një ndryshim domethënës midis burrave dhe grave sa i takon nivelin arsimor të migrantëve të jashtëm (shih Grafikon 7, më poshtë), mund të nxjerrim si rrjedhojë se integrimi i forcës së punës në vendin pritës është më i vështirë për femrat migrante me arsim të lartë. Arsyeja për këtë mund të jetë preferenca për punë me kualifikim të ulët në vendin pritës, por mund të lidhet po ashtu me historikun e tyre të migracionit. Për shembull, Shabani (2020) konstatoi se vende kryesore të BE-së kanë zbatuar politika migratore që u japin mundësi migrantëve të brendshëm me arsim të lartë të sjellin familjarët e tyre në vendin pritës. Kështu, meshkujt migrantë me arsim universitar mund të jenë në gjendje të sjellin partneret e tyre femra me arsim të lartë në vendin pritës ku kanë migruar në kërkim të një oferte pune.

**Grafiku-6. Statusi i punësimit të migrantëve të jashtëm**




Për më tepër, edhe pse Grafiku 8 (më poshtë), tregon se gratë që punojnë në sektorin e shërbimeve dhe ato të angazhuara në profesionet elementare, kanë shumë më të ngjarë të emigrojnë se burrat, ai tregon po ashtu një prirje më të lartë për të emigruar te burrat e angazhuar në punë në bujqësi, zejtari dhe fabrika. Këto prirje mund të lidhen me faktorët tërheqës dhe, për pasojë, tregojnë ndryshim në preferencat për këto profesione në vendet pritëse. Megjithatë, mund të jenë të lidhura edhe me faktorë shtytës e, për pasojë, të tregojnë një preferencë më të madhe të personave të angazhuar në këto profesione për të emigruar, për shkak të kushteve aktuale në vendin dërgues (d.m.th., Shqipëri). Më tej, ato mund të pasqyrojnë normat sociale në vendin dërgues, të cilat vendosin prishmëri të ndryshme për të rinjtë, bazuar në gjini, për zgjedhjet profesionale dhe jetësore që bëjnë.

**Grafiku-7. Niveli arsimor dhe gjinia e migrantëve të jashtëm**




**Grafiku-8. Sektori i punësimit dhe gjinia e migrantëve të jashtëm**



## Përbërja e migracionit të brendshëm në Shqipëri

Të dhënat për migrantët ndërkombëtarë për motive punësimi në Shqipëri vijnë kryesisht nga dy burime: së pari, të dhënat administrative nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit për lejet e qëndrimit, mbledh informacionin mbi numrin dhe karakteristikat e kërkesave dhe vendimeve pasuese për rastet e lejes së qëndrimit dhe, së dyti, të dhënat mbi migracionin ndërkombëtar. Për të dhënat mbi migracionin ndërkombëtar, INSTAT-i mbështetet në vlerësimet e flukseve migratore mbështetur në të dhënat e modulit të migracionit të anketës së forcës së punës, kombinuar me normat e parashikimit të popullsisë. Duke iu referuar të dhënave administrative për lejet e qëndrimit, është e qartë se, edhe pse popullsia e huaj në Shqipëri është rritur gjatë dy dekadave të fundit, në shifra absolute, ajo mbetet mjaft e vogël. Popullsia e përgjithshme e migrantëve të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri mbetet e papërfillshme, edhe pse ka shënuar rritje nga 2 400 persona në vitin 2005, në 14 921 persona në vitin 2021 (shih Figurën 1).

Figura-1. Të huajt me leje qëndrimi sipas grupmoshës (2005-2021)



Siç diskutohet në këtë raport, është bilanci i migracionit neto, më shumë sesa vetëm shifrat e migracionit të jashtëm, që tregon forcën tërheqëse të një ekonomie. Me këtë logjikë, Shqipëria ka një bilanc negativ të migracionit neto, çka nënkupton se ka më shumë migrantë që largohen nga vendi sesa migrantë që hyjnë (IOM, 2022).

Përbërja e migrantëve të brendshëm në Shqipëri është 64% burra dhe 36% gra. E njëjta gjë vlen edhe për migrantët ndërkombëtar dhe të kthyerit. Përbërja demografike e popullsisë ndërkombëtare migrante në Shqipëri është e shpërndarë në mënyrë relativisht të barabartë të grupmoshat përgjatë periudhës 10 vjeçare (shih Figurën 1). Në vitin 2021, 20,4% e mbajtësve të lejes së qëndrimit ishin në grupmoshën 30-39 vjeçe, ndjekur ngushtë nga grupmosha 50-59 vjeçe me 19,7% dhe 18,5% për grupmoshën 40-49 vjeçe. Është e qartë se 38,3% e mbajtësve të lejeve të qëndrimit janë 50 vjeç e lart, duke përfaqësuar një shpërndarje krahasimisht mbi mesataren të përbërjes demografike të të huajve me leje qëndrimi. Duke qenë se moshja e pensionit në Shqipëri është 65 vjeç, fakti që një e treta e mbajtësve të lejes së qëndrimit po i afrohen moshës së pensionit ose e kanë kaluar tashmë këtë moshë, nënkupton se kontributi afatgjatë i mbajtësve aktualë të lejeve të qëndrimit në tregun e punës mund të jetë edhe më i kufizuar sesa tregojnë shifrat absolute.


Në vitin 2020, numri i migrantëve ndërkombëtarë që paraqitën kërkesë për leje qëndrimi ishte 7,661 persona. Mes tyre, 45% ishin irakianë dhe italianë. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave, 72,4% kërkonin një afat qëndrimi 12-mujor ose më pak, 23,2% qëndrim 24-mujor dhe 1,4% qëndrim 5-vjeçar. Vetëm 3% e aplikuesve kërkuan qëndrim të përhershëm në Shqipëri. Gjatë pesë viteve të fundit, përqindjet e imigrantëve evropianë, aziatikë, amerikanë, afrikanë dhe nga Oqeania kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme, siç tregohet në Figurën 2.

1. Metoda e vlerësimit nga INSTAT bazohet në të dhënat e mbledhura nga moduli i vrojtimit të migracionit të fuqisë punëtore të kombinuara me normat e projekcionit të popullsisë për vitet 2011-2031.



Megjithatë, në vitin 2020, përqindja e evropianëve mes mbajtësve të lejes së qëndrimit ra në 56,8%, krahasuar me 66,4% në vitin 2019. Kjo rënie ka të ngjarë të jetë e lidhur me lëvizjet e kthimit, si dhe me numrin e kufizuar të kërkesave të reja për leje qëndrimi, për shkak të ndalimeve të udhëtimit dhe lëvizjes që erdhën si pasojë e shpërthimit të pandemisë COVID-19.


Figura-2. Të huajt mbajtës të lejeve të qëndrimit sipas rajonit të origjinës, 2005-2020



Burimi: Të huajt në Shqipëri 2020 (INSTAT)

Arsyet që migrantët ndërkombëtarë kanë dhënë për kërkesat për leje qëndrimi ndryshojnë në varësi të vendit të tyre të origjinës, siç shihet në Figurën 3. Ndërkohë që iranianët kanë imigruar thuajse ekskluzivisht për arsye humanitare, nxitësi mbizotërues për aplikuesit nga vendet e tjera të origjinës është punësimi (47,7%). Bashkimi familjar është nxitësi i dytë më i rëndësishëm i migracionit në Shqipëri dhe më i theksuar për Kosovën (41,7%), më pas, për Turqinë (32,3%) dhe Italinë (18,3%). Vetëm 2% e migrantëve ndërkombëtarë aplikojnë për leje qëndrimi për të studiuar në Shqipëri.

Figura-3. Mbajtësit e lejes së qëndrimit sipas vendit të origjinës dhe qëllimit të aplikimit, 2020




Burimi: Të huajt në Shqipëri 2020 (INSTAT)

Përtej të dhënave administrative mbi lejet e qëndrimit, INSTAT-i përgatit përlogaritje të fluksit migrator bazuar në të dhënat e mbledhura nga moduli i migracionit i anketës së forcës së punës, kombinuar me normat e parashikimit të popullsisë për periudhën 2011-2031. Nëse shohim këtë burim të dytë të dhënash mbi migracionin ndërkombëtar, shfaqet një tablo ndryshe. Është me interes të vërehet mospërputhja midis vlerësimeve nga kampionët e anketave dhe atyre nga të dhënat administrative. Një analizë kritike e burimeve do të na kthente te rritja e konsistencës së tyre.

Edhe pse në vitin 2011, Shqipëria priti një numër prej 36 397 migrantësh ndërkombëtarë, në vitin 2019, kjo shifër u ul në 20 753. Për vitin 2020, përlogaritjet e INSTAT-it treguan një numër prej 7 170 migrantësh ndërkombëtarë në Shqipëri, ndërkohë që në vitin 2021 u shënuar një ringritje e lehtë në 9,195 migrantë, në vijim të lehtësimit të kufizimeve të udhëtimit për shkak të COVID-19-së. Pa përfshirë 'faktorët përjashtimorë' të vitit 2020 dhe 2021, vlerësimet e INSTAT-it treguan se, në periudhën 2011-2019, Shqipëria kishte pasur një normë të përbërë rritjeje vjetore (CAGR) prej -6.8% në imigracionin ndërkombëtar (shih figurën 4). Gjatë dy viteve të vrojtimeve të pandemisë COVID-19 (2019-2021), CAGR-ja negative u rrit ndjeshëm deri në -33.4%. Duke i parë këto vlerësime me të dhënat për prirjet e migracionit të jashtëm vitet e fundit – që u ngadalësua me një ritëm më të ulët sesa normat e imigracionit ndërkombëtar – shihet qartë se migracioni ndërkombëtar, nëse gjithçka mbetet njësoj, nuk do të mundë të kompensojë migracionin e jashtëm në të ardhmen e afërt.

Ndërsa të dhënat ekzistuese administrative për lejet e qëndrimit, përfshi vlerësimet sipas vendit të origjinës, arsytet për paraqitjen e kërkesës, si dhe zbrëthimin sipas gjinisë dhe moshës, përbëjnë një pikënisje të qëndrueshme, është me rëndësi të përmendet se mungojnë një mori të dhënash që do të ishin thelbësore për të kuptuar më mirë ndikimin e tregut të punës te migrantët ndërkombëtarë në Shqipëri.

Figura-4. Numri i migrantëve ndërkombëtarë në Shqipëri dhe CAGR-ja, 2011-2021



Më në veçanti, mungojnë të dhëna mbi:

- ✓ Profilet e përgjithshme arsimore dhe të arsimit dhe arsimit e formimin teknik dhe profesional (AFTP) që kanë mbajtësit e lejeve
- ✓ Sektorin ekonomik (ISIC, niveli dyshifror) dhe profesionin e (ISCO, niveli dyshifror) i mbajtësve të lejeve.

### 1.3 - Prirjet e forcës së punës në Shqipëri


Ekonomia shqiptare ka treguar rritje të qëndrueshme të PBB-së gjatë periudhës 2011-2021, me përjashtim të viteve 2015 dhe 2019. Më tej, parashikimet për periudhën e ardhshëm programore, 2022-2027, sugjerojnë vazhdimësi të rritjes së ekonomisë në tërësi, si dhe për secilin prej tre sektorëve kryesorë. Kjo prirje kombinohet me atë të punësimit, që gjithashtu është rritur në periudhën 2011-2021. Ekonomia jo vetëm rritet sa u takon produkteve, por krijon po ashtu vende pune. Ky vlerësim është posaçërisht i rëndësishëm për sistemin socialekonomik të Shqipërisë, i cili karakterizohet kaq ndjeshëm nga migracioni i jashtëm që prej rënies së regjimit komunist, në vitin 1989. Nëse parashikimet ekonomike konfirmohen, ka të ngjarë që ekonomia të vazhdojë të ketë kërkesë për më shumë njerëz për të mbështetur prodhimin dhe rritjen e saj.

Mbështetur në normat e larta të fertilitetit në vitet '90 – më të lartat nga vendet jo vetëm të Evropës Juglindore, por të Evropës në tërësi – shqiptarët në moshë pune që hynë në treg kontribuan si për rritjen neto të agregateve të punësimit në ekonominë kombëtare, ashtu edhe në numrin e të rinjve që kërkonin perspektiva më të mira punësimi në Evropë. Me fjalë të tjera, të rinjtë që hyjnë në tregun e punës 15 vitet e ardhshme do të tërhiqen si nga ekonomia që jo vetëm rritet, por krijon edhe vende pune, ashtu edhe nga tregu i punës në Evropën Perëndimore që karakterizohet nga mungesa neto në të gjithë sektorët e ekonomisë, edhe nga shtimi dhe diversifikimi i rrugëve të migracionit për studentët dhe migrantët për motive punësimi.

- Përbërja sektoriale e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB)

Figura 5 tregon prirjen e PBB-së shqiptare në periudhën 2011-2021. PBB-ja pësoi ulje të lehtë midis vitit 2011 dhe 2012 dhe sërish midis vitit 2014 dhe 2015. Nga viti 2016 e këtej, PBB-ja u zhvillua pozitivisht, përveç një uljeje të lehtë në vitin 2018-2019.

Figura-5. Evoluimi i PBB-së në Shqipëri për periudhën 2011-2021 sipas sektorëve makroekonomikë (në miliarda dollarë amerikanë)



Prirjet e lartpërmendura për ekonominë në tërësi reflektohen nga sektori bujqësor, i cili, gjatë dekadës së fundit, ka përjetuar një mekanizim të prodhimit të ngjashëm me atë të vendeve të tjera të Evropës Juglindore, si Bullgaria dhe Rumania. Mundësitë e punësimit në pjesën perëndimore të Evropës ka të ngjarë ta lënë pa kujdes sektorin, duke krijuar potencial për migracion të brendshëm. Shkalla në të cilën sektori do të kërkojë punonjës të kualifikuar

2. Shih INSTAT (2022), Llogaritë Kombëtare dhe Anketat e Forcës së Punës, në [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al).

3. Harizanova-Bartos, H., & Terziyska, R. (2019). Innovations and diversifications toward sustainable Bulgarian agriculture. *Zagadnienia Ekonomiki Rolnej/Problems of Agricultural Economics*, (2).


4. Tudor, V. C., Dinu, T. A., Vladu, M., Smedescu, D., Vlad, I. M., Dumitru, E. A., ... & Costuleanu, C. L. (2022). Labour Implications on Agricultural Production in Romania. *Sustainability*, 14(14), 8549.

në bujqësi kundrejt forcës së pakualifikuar të punës ka të ngjarë t'u ofrojë politikëbërësve shqiptarë mundësi për të kuptuar alternativat e migracionit të brendshëm. Nga njëra anë, kërkesa për forcë pune të pakualifikuar rrezikon shpesh të krijojë stimuj për migracion të parregullt në një vend që është në udhëkryqin e korridorit ballkanik të migracionit. Nga ana tjetër, vendet e lira të punës në vend për forcën e kualifikuar të punës në bujqësi mund të paraqesin një mundësi për të ardhura më të mira për shqiptarët e papunë ose për migrantët e rregullt nga Lindja. Sistemi i migracionit të rregullt të brendshëm në Shqipëri ka nisur të tërheqë punonjës nga vende, si Filipinet dhe vende të tjera të Azisë Jugore, sidomos në sektorin e prodhimit që ka intensitet punësimi dhe ka përjetuar një rigjallërim pas zhvendosjes së aktiviteteve të prodhimit të veshjeve nga Azia Lindore gjatë pesë viteve të fundit<sup>5</sup>. Potenciali i migracionit të brendshëm mund të ushqejë në mënyrë të ndërthurur jo vetëm sektorin e shërbimit, por edhe atë të bujqësisë. Është e pamundur të bëhen parashikime për bilancin e migrantëve dhe vendasve që do të tërhiqen nga secili sektor, pasi kjo do të përcaktohet nga shkalla në të cilën vende si Gjermania dhe Italia, por edhe Austria dhe shtete të tjera anëtare të BE-së do të tërheqin punonjës shqiptarë që janë më të mirëpaguar dhe me tregje pune më të mbrojtura.

Sektori i shërbimeve ka pasur përfitime sa i takon përqindjes së PBB-së së përgjithshme (nga 44,3% në vitin 2011, në 47,7% në vitin 2021), në përputhje me rajonin e Ballkanit Perëndimor në tërësi. Në të kundërt, sektori i industrisë humbi aksione (nga 24,5% në vitin 2011 në 21,8% në vitin 2021). Këto të dhëna theksojnë se lulëzimi i rishte i sektorit fason nuk kompensonte zhvendosjen e veprimtarive ekonomike nga bujqësia dhe prodhimi me pagë të ulët drejt një sektori shërbimesh që ka përjetuar krijimin e qendrave të shërbimit të shoqërive shumëkombëshe nga jashtë vendit. Ndërsa për këto të fundit duhet parë zyrtarisht se si përkohë me PBB-në dhe punësimin, rritja e prodhimit me produktivitet të ulët rrezikon shpesh të bjerë në rrjetat e ekonomisë informale. Për këtë arsye, rritja e PBB-së në prodhim mund të jetë e nënvlerësuar. Për veprimtaritë industriale në Shqipëri, sidomos duke parë që prirjet gjeopolitike po na bëjnë dëshmitarë të riorganizimit të prodhimit në kufijtë e afërt lindorë me Bashkimin Evropian, mbetet një potencial i rëndësishëm për prirjet e tregut dhe të migracionit. Në fakt, analizat sektoriale të zhvilluara në Shqipëri, raportuan që punëdhënësit e sektorit të fasonerisë kërkuan masa politikash për të shtuar forcën e punës me një faktor 30% të popullsisë së punësuar në nivelet para COVID-it. Kjo do të shkonte shumë përtej rritjes së PBB-së së regjistruar nga prodhimi dhe tregon prani të informalitetit në sektor, si dhe potencial të fortë për pozicione të lira pune që nuk janë tërheqëse, përveç një grupi në tkurrje punëkërkuësesh me kualifikim të ulët. Për të trajtuar çështjet e renditura më sipër, politikatat për fuqizimin e grave në shoqëri dhe në tregun e punës mund të kombinohen me ato për përfshirjen e refugjatëve në forcën e punës dhe regjime proaktive liberale migracioni nga vendet jovevropiane.

Sipas Figurës 6, parashikimet e PBB-së për Shqipërinë janë pozitive (me përjashtim të një tkurrjeje të lehtë në periudhën 2021-2022 në sektorin e industrisë, që ndoshta mund t'i atribuohet pandemisë). PBB-ja do të arrijë në rreth 25 miliardë dollarë në vitin in 2027, ndërkohë që do të marrin rëndësi sektorët e shërbimeve.

**Figura-6. Parashikimet e evoluimit të PBB-së në Shqipëri deri në vitin 2027 sipas sektorëve makroekonomikë (në miliardë dollarë amerikanë)**



5. Hila, E. (2021, July 20). Asian migrants fill jobs that picky Albanians now Spurn. Balkan Insight. Marrë më 12 tetor 2022, nga <https://balkaninsight.com/2021/07/20/asian-migrants-fill-jobs-that-picky-albanians-now-spurn/>.

- Prirjet gjinore në punësim dhe papunësi

Tabela 1 tregon një prirje të qartë pozitive për normat e punësimit të meshkujt në Shqipëri, me përjashtim të dy viteve të fundit të vrojtit (sidomos të grupmoshat më të reja), periudhë gjatë së cilës ekonomia shqiptare u tkurr për shkak të kufizimeve të vendosura nga pandemia COVID-19. Megjithatë, prirjet pozitive të niveleve të punësimit janë ulur ngadalë që prej vitit 2014 për të gjitha grupmoshat. Ky zhvillim pasqyrohet te prirjet e niveleve të punësimit të gratë në Shqipëri (shih Tabelën 2).

Gjatë dekadës së shkuar, si rezultat edhe i rritjes së qëndrueshme të PBB-së, tregu i punës për të rinj ka mundur të frenojë fluksin dalës të punonjësve të rinj, që përjetoi gjatë viteve '90 dhe 2000. Përveç luhatjeve që kaloi gjatë viteve të COVID-19-ës (2020 dhe 2021), norma e punësimit e grave dhe burrave të grupmoshës 15-29 vjeçe u rrit me të njëjtin ritëm si në vitet e rimëkëmbjes nga kriza ekonomike e financiare globale (2012 dhe në vazhdim). Kjo sinjalizon një reagim të pakët për grupmoshat që ishin më të ekspozuara ndaj migracionit të jashtëm drejt Evropës Perëndimore dhe ShBA-ve në dekadat e kaluara. Prirja është më e theksuar te gratë sesa te burrat. Shqipëria vijon të karakterizohet nga strukturat tradicionale të familjes, ku burrat janë më të prirur të emigrojnë e, për pasojë, ky dallim ka gjasë të gjejë pasqyrim te prirja më e madhe e burrave të rinj për të migruar. Më tej, vendet e hapura të punës në sektorin e shërbimeve mund të kenë qenë më tërheqëse për gratë sesa për burrat.

Tabela-1. Prirjet e normës së punësimit të meshkujt sipas moshës (2012-2021)<sup>6</sup>

	15-29 vjeç	30-44 vjeç	45-59 vjeç
1v	99.2%	99.3%	102.1%
2v	99.9%	97.2%	101.3%
3v	104.0%	99.3%	100.8%
4v	120.8%	100.2%	104.2%
5v	128.1%	103.7%	107.8%
6v	130.2%	104.6%	107.6%
7v	141.1%	107.8%	111.1%
8v	136.8%	112.7%	110.2%
9v	120.1%	106.6%	104.9%
Mesatare	120.0%	103.5%	105.5%

Tabela-2. Prirjet e normës së punësimit te femrat sipas moshës (2012-2021)<sup>7</sup>

	15-29 vjeç	30-44 vjeç	45-59 vjeç
1v	103.1%	100.2%	99.0%
2v	101.9%	95.9%	98.1%
3v	113.9%	97.3%	100.9%
4v	128.7%	102.3%	106.8%
5v	130.0%	103.3%	107.4%
6v	157.5%	108.4%	110.6%
7v	156.4%	115.3%	117.0%
8v	157.1%	118.3%	114.6%
9v	123.7%	106.7%	112.1%
Mesatare	130.3%	105.3%	107.4%


Shënim: "1v" u referohet prirjeve të normës së punësimit të meshkujve në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, "2v" u referohet prirjeve të vitit 2021 krahasuar me vitin 2019 etj.

Në periudhën 2011-2019, gjatë viteve të rimëkëmbjes pas krizës financiare globale të vitit 2009, pati një gjallërim të punësimit, që u shfaq jo vetëm në Shqipëri, por në shumicën e tregjeve kombëtare të punës në mbarë botën. Ringritja e tregjeve të punës ndikoi pozitivisht jo vetëm te të rinjtë shqiptarë, por edhe te punonjësit në moshën më produktive dhe ata më të vjetër. Megjithatë, prirja për grupmoshat e dyta është më pak e theksuar, krahasuar me atë që u regjistrua për grupmoshën 15-29 vjeçe. Nëse këto prirje lexohen së bashku me parashikimet ekonomike, analiza paraqet jo vetëm një ekonomi që rritet dhe krijon vende pune, por edhe një aftësi reaguese të forcës kombëtare të punës për t'u bërë pjesë e për të mbështetur ekonominë shqiptare. Grupmosha e të rinjve shqiptarë, më të arsimuar dhe më kërkues edhe kur vjen fjala për të konsideruar mundësitë në Perëndim, do të jetë, sidoqoftë, më pak e prirur t'iu bashkuar prodhimit me produktivitet të ulët, si fasoneria apo të mbetet në punësimin në zonat rurale për të siguruar jetesën. Nga pikëpamja e migracionit, nëse politikëbërësit duan të mbështeten më pak te stimuli i migracionit të brendshëm, është me rëndësi që të ndërmerren politika që nxitin produktivitetin dhe teknologjinë në një vend ku forca e punës është jo vetëm më e arsimuar, por edhe të ketë stimuj për të migruar, pasi punët e kualifikuara ofrohen në Evropën Perëndimore.

Grafiku 9 – paraqet në format grafik ndryshimin midis rritjes në normat e punësimit për grupmoshën 15-29 vjeçe kundrejt punonjësve në moshë kulmore dhe më të vjetër.

6. Mbështetur në të dhënat e siguruar nga INSTAT-i.

**Grafik-9. Prirjet e mesatare të normave të punësimit sipas moshës dhe gjinisë (2012-2021).**



Gjatë 10 viteve të fundit, raporti midis popullsisë së papunë dhe popullsisë së përgjithshme në moshë pune është ulur për meshkujt e të gjitha grupmoshave, siç tregohet në Tabelën 3. Normat e papunësisë janë tkurrur në mënyrë konstante gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Sërish me një fluks të kufizuar hyrës të migrantëve për motive punësimi në Shqipëri, Tabela 3 tregon se tregu i punës u bë më i shtrënguar gjatë 10 viteve të fundit, një tjetër provë se ekonomia shqiptare po bëhet tërheqëse për forcën kombëtare të punës, së bashku me rrugët më të lehta të migracionit të jashtëm drejt skajit perëndimor të Evropës. Tabela 4 na tregon se raporti midis popullsisë së papunë dhe popullsisë së përgjithshme në moshë pune nuk ka një strukturë të qartë për femrat, sidomos për grupmoshën 45-59 vjeçe.

**Tabela-3. Prirjet e raportit midis popullsisë mashkullore të papunë dhe në moshë pune sipas moshës (2012-2021)**

	15-29 vjeç	30-44 vjeç	45-59 vjeç
1v	97.4%	92.4%	85.0%
2v	95.3%	91.8%	97.0%
3v	89.3%	84.6%	96.4%
4v	84.2%	72.8%	72.6%
5v	78.3%	71.0%	66.9%
6v	70.5%	71.6%	63.3%
7v	65.9%	60.4%	59.6%
8v	86.4%	54.4%	60.6%
9v	78.3%	64.8%	94.3%
Mesatare	82.8%	73.8%	77.3%

**Tabela-4. Prirjet e raportit midis popullsisë femërore të papunë dhe në moshë pune sipas moshës (2012-2021)**


	15-29 vjeç	30-44 vjeç	45-59 vjeç
1v	104.6%	81.9%	108.5%
2v	100.0%	104.8%	104.8%
3v	103.2%	98.4%	101.1%
4v	110.6%	94.6%	93.2%
5v	91.8%	79.2%	89.0%
6v	80.5%	69.4%	83.0%
7v	112.8%	77.6%	92.7%
8v	142.3%	91.7%	95.1%
9v	118.9%	97.0%	110.6%
Mesatare	107.2%	88.3%	97.6%

*Shënim: "1v" u referohet prirjeve në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, "2v" u referohet prirjeve në vitin 2021, krahasuar me vitin 2019 etj.*

Prirjet e papunësisë zbulojnë dallimet gjinore: ndërkohë që ulja e normave të papunësisë është e përhapur te burrat e të gjitha grupmoshave për krejt periudhën e marrë në konsideratë, tregu i punës së grave paraqet një tablo të përzier për dekadën e fundit. Gratë në moshën kulmore (30-44 vjeçe) janë ato që shfaqin prirjen më të ngjashme me atë të burrave. Përveç vitit 2012 që është përjashtim, norma e papunësisë ka pasur ulje strukturore gjatë dekadës së shkuar, përfshi vrojtimet që kanë të bëjnë me vitet e COVID-19. Të njëjtat vlerësime mund të nxirren edhe për punonjëset femra në moshë më të madhe. Ndryshe është situata për gratë e reja, të cilat

u përballën me prirje të luhatshme të variacionit të normës së papunësisë. Prirja tregon disa hipoteza: dallimet gjinore mund t'i kufizojnë gratë të migrojnë jashtë, veçanërisht, në një kontest që karakterizohet nga strukturat e familjes tradicionale. Së dyti, gratë shpesh punësohen në aktivitet familjare dhe janë më të ekspozuara ndaj hyrjedaljeve të shpeshta në punësim, si punët në sektorin e shërbimeve. Politikat e punësimit me ndjeshmëri gjinore mund të lehtësojnë migracionin e jashtëm të grave, si dhe të ofrojnë perspektiva më të qëndrueshme për ato që duan të qëndrojnë ose të kthehen në Shqipëri. Grafiku 10 tregon se gratë e reja janë grupi i vetëm me një mbipërfaqësim mesatar të viteve në të cilat papunësia e tyre rritet.

**Grafik-10. Mesataret e prirjeve të raportit midis popullatës së papunë dhe asaj në moshë pune sipas moshës dhe gjinisë (2012-2021)**




• **Punësimi - prirjet dhe perspektivat sektoriale**

Me më shumë se një gjeneratë vonësë krahasuar me vendet e tjera evropiane, Shqipëria vazhdon të përballët me lëvizje ndërsektoriale, nga aktivitetet bujqësore tek ato jobujqësore. Prirja vlen si për gratë, ashtu edhe për burrat. Kjo sjell disa ndikime në perspektivat e punës dhe migracionit në të ardhmen. Familjet që lënë veprimtaritë bujqësore do të vazhdojnë të rritin ushtrinë e rezervave në zonat urbane ku përqendrohen, duke qenë se, sipas literaturës, njerëzit nga zonat rurale janë më të prirur të migrojnë së brendshmi, në vend që të përfshihen në migracionin e jashtëm ndërkombëtar. Për këtë arsye, ka të ngjarë që mekanizimi i veprimtarive bujqësore të mos mundë të kapë ritmin e peronave që largohen drejt zonave urbane. Kjo kërkon që politikëbërësit shqiptarë të gjejnë instrumente që lejojnë hyrjen e migrantëve për motive punësimi, të gatshëm të bëjnë punë në bujqësi. Për këtë, Shqipëria konkurren thujse me të gjitha vendet në Evropë, që kërkojnë forcë pune në bujqësi. Nëse nuk ka alternativa të qëndrueshme të politikave migratore, kjo mund të çojë në rritjen e çmimeve të mallrave të shportës dhe artikujve të tjerë bujqësore, për një vend që ende varet shumë nga prodhimi vendas.


Ka disa vjet që studimet sektoriale vazhdojnë të raportojnë mungesa në fuqinë punëtore në bujqësi, si dhe në ndërtim dhe në prodhim, i cili ka intensitet punësimi. Për një vend si Shqipëria, e integruar gjeografikisht në kontinentin evropian, kushti i dobishmërisë për t'u larguar nga fshati nuk përfshin vetëm sektorin jobujqësor, por edhe të gjitha ato vende pune që u vihen në dispozicion shqiptarëve në BE, numri i të cilave u rrit. Ai ka gjasë të rritet me politikën e Pakteve të BE-së për Migracionin.

Grafiku-11. Meshkujt, viti 2021 krahasuar me vitin 2017 sipas sektorëve makroekonomikë<sup>7</sup>



Grafiku 11 tregon se përqindja e meshkujve të punësuar në sektorin bujqësor është ulur gjatë katër viteve të fundit. Në të kundërt, përqindja e meshkujve të punësuar në sektorin jobujqësor ka arritur në më shumë se 70%.

Grafiku-12. Femra, viti 2021 krahasuar me vitin 2017 sipas sektorëve makroekonomikë<sup>8</sup>



Grafiku 12 tregon se përqindja e femrave të punësuar në sektorin bujqësor është ulur gjatë katër viteve të fundit, edhe pse ulja ka qenë me ritëm më të ulët krahasuar me meshkujt. Nga ana tjetër, përqindja e femrave të punësuar në sektorin jobujqësor u rrit, nga 57% në vitin 2017, në 60% në vitin 2021.

Një prirje e re që nuk është e zakonit vetëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe në të gjitha vendet e BE-së fqinje me Lindjen e Afërt, është rritja e përqindjes së punonjësve të angazhuar në veprimtari industriale. Në rastin e Shqipërisë, raportohen lëvizje ndërsektoriale të popullsisë mashkullore të punësuar, nga sektori i shërbimeve, në sektorin industrial. Të dhënat zyrtare raportojnë se prirja të gratë është e kundërt.

Një vëzhgim më i imtë konfirmon se këto lëvizje janë të përqendruara në sektorin e prodhimit, pasi punësimi në ndërtim jo vetëm mbizotërohet nga burrat, por përqindja e tij në raport me totalin e veprimtarive jobujqësore u ul gjatë ciklit të kaluar ekonomik. Burrat e punësuar shfaqin gjithashtu lëvizje nga shërbimet e minierave dhe gurorëve dhe shërbimet jotregtare në shërbimet e tregut.

Të dhënat zyrtare raportojnë prirje pjesërisht të ndryshme për gratë, ulja e veprimtarive industriale të cilave mund të shpjegohet ose nga një prani më e madhe e kontributit të tyre për të nxitur aktivitetet ku informaliteti është i lartë dhe/ose duke lëvizur në sektorët e karakterizuar nga forca punëtore e kualifikuar dhe e arsimuar, konkretisht, në shërbimet e tregut ose prodhimin me produktivitet më të lartë. Në përgjithësi, prirjet sektoriale tregojnë një modernizim të ekonomisë shqiptare kombinuar me veprimtaritë ekonomike që kërkojnë forcë pune më të kualifikuar, krahasuar me të shkuarën.

Efektet mbi prirjet migratore vitet e ardhshme janë të shumta. Një forcë shqiptare pune, sidomos e grave, më e prirur të angazhohet me punonjës të kualifikuar ka të ngjarë të jetë më tërheqëse jo vetëm për veprimtaritë brenda vendit, por edhe për sektorët me mungesa në Evropën Perëndimore, të cilët kërkojnë kryesisht fuqi punëtore të kualifikuar. Përveç kësaj, kjo duhet të paralajmërojë politikëbërësit shqiptarë për nevojën për të krijuar rrugë për migracionin e brendshëm jo vetëm për punonjësit e pakualifikuar, por edhe për profesionet, sidomos në sektorin e shëndetësisë, ku prania e kandidatëve të kualifikuar shqiptarë ka të ngjarë të tkurret viteve që vijnë. Prirjet e pikasura nga situata e pesë viteve të shkuara janë të strukturuar.

7. Përlogaritjet mbështeten në të dhënat e siguruar nga INSTAT-it.


8. Përlogaritjet mbështeten në të dhënat e siguruar nga INSTAT-it.



Ka të ngjarë që ato të vazhdojnë kështu edhe në skenarin e keq të një krize ekonomike, që do të ishte rezultat i uljes së kërkesës nga Perëndimi dhe e lidhur, gjatë kohës së përgatitjes së këtij studimi, me krizën ukrainase. Mungesat në forcën e punës që raportohen nga punëdhënësit në bujqësi dhe ndërtim mund të shtrihen në sektorë të tjerë të ekonomisë si nxjerrja e materialeve të ndërtimit.


Në fund fare, kërkesa shqiptare për punonjës migrantë ka të ngjarë të reflektojë faktin se vendi po hyn për herë të parë në grupin e vendeve të destinacionit. Disa sektorë do të kërkojnë kryesisht krahun femëror të punës në pozicione gjysmë të kualifikuara dhe me kualifikim të lartë. Punonjësit meshkuj të do të kërkojnë në sektorë me kualifikim të ulët, si ndërtimi, minierat dhe bujqësia, kurse pozicionet e lira të paplotësuara në prodhimin me produktivitet të ulët do të tërheqin, me gjasë, si burrat ashtu edhe gratë. Sasia e vendeve të punës për të cilat ka kërkesë në këto veprimtari industriale varet nga prirja për t'i zhvendosur aktivitetet industriale nga Azia, kostot e të cilave janë rritur dekadën e shkuar.

**Grafiku-13. Meshkujt dhe femrat e punësuar sipas sektorëve jobujqësorë në vitin 2021 krahasuar 2017<sup>9</sup>**



Gratë janë të mbipërfaqësuar në shërbime krahasuar me meshkujt, të cilët ndërkohë përbëjnë shumicën e forcës së punës në prodhim se nënsektorë të tjerë të industrisë (shih Grafikonin 13). Kjo prirje vazhdoi të polarizonte gratë dhe burrat në sektorë të ndryshëm, me një angazhim edhe më të madh të grave në shërbime. Kjo e fundit paraqet kërcënim për mbrojtjen e grave në tregun e punës, pasi punonjësit e shërbimeve janë më të ekspozuar ndaj pagave të ulëta dhe një punësim që u ofron mbrotje të pakët në aktivitete ekonomike që, shpesh, janë më të rrezikuara nga marrëveshje kontraktuale joformale.

**Grafiku-14. Ndryshimet te femrat krahasuar me meshkujt në periudhën 2017-2021 sipas sektorëve makroekonomike dhe për të gjithë tregun shqiptar të punës<sup>10</sup>**



Grafiku 14 tregon se tregu shqiptar i punës po bëhet më i barabartë nga pikëpamja gjinore, së paku, sa i takon numrit të të punësuarve për çdo sektor. Në fakt, raporti midis femrave dhe meshkujve të punësuar në tregun e punës është më pozitiv në periudhën 2017-2021. Kjo vlen sidomos për sektorin bujqësor, por edhe për sektorët jobujqësorë, edhe pse në një shkallë më të ulët.

9. Përlllogaritjet mbështeten në të dhënat e siguruar nga INSTAT-it.  
 10. Përlllogaritjet mbështeten në të dhënat e siguruar nga INSTAT-it.

- Parashikimi i popullsisë


Popullsia e grupmoshës 0-64 vjeçe në Shqipëri do të ulet në mënyrë progresive nga viti 2021 deri në vitin 2036. Veçanërisht, në vitin 2021, popullsia e vlerësuar në moshë pune në grupmoshën 15-64 vjeçe përfaqëson 68% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë, një shifër që duhet konsideruar e lartë nëse do të krahasohej me atë të BE-së (64%). I njëjti agregat parashikohet se do të pësojë rënie në 62% të popullsisë vetëm në vitin 2036. Për rrjedhojë, popullsia në moshë pune do të mbetet e lartë, çka nënkupton më pak sfida të mëdha lidhur me plakjen e popullsisë, krahasuar me çdo vend tjetër të rajonit të BE-së. Të dhënat përfshijnë tashmë faktorë si flukset e migracionit neto dhe normat e vdekshmërisë. Me fjalë të tjera, përqindja e popullsisë në pension do të rritet, por më vonë krahasuar me fqinjët e Shqipërisë dhe përqindja e popullsisë në moshë pune do të ulet, por duke nisur nga vlera që mbeten të larta.

Tabela-5. Parashikimet e përbërjes së popullsisë në 2021, 2026 dhe 2036 sipas moshës dhe gjinisë<sup>11</sup>

Mosha	M 2021	F 2021	M 2026	F 2026	M 2036	F 2036
<b>Gjithsej</b>	1,392,701	1,412,189	1,325,498	1,363,387	1,263,127	1,298,325
<b>0-14</b>	233,319	224,507	206,854	201,811	166,059	159,068
<b>15-64</b>	948,993	956,660	877,166	886,415	809,555	794,087
<b>64+</b>	210,390	231,022	241,477	275,161	287,513	345,170

E vetmja grupmoshë që do të rritet është ajo e personave 64 vjeç e lart, duke krijuar nevoja të ngutshme si për qëndrueshmërinë e sigurimeve shoqërore, ashtu edhe për kujdesin e sistemeve të ekonomisë. Krahas kësaj, ulja e normave të fertilitetit sjellin si rezultat një tkurrje të grupmoshës së personave 0 deri në 14 vjeç, duke çuar në mungesa të rinjve që hyjnë në tregun e punës. Kjo mungesë i shtohet asaj të një vendi që ka përjetuar një migracion të jashtëm masiv gjatë 30 viteve të fundit dhe shtron çështjen e një sistemi politikash të kombinuara që bëjnë të mundur qëndrueshmërinë e të ardhurave kombëtare të mbështetura nga migracioni i jashtëm dhe dërgesat dhe ruajtjen e një ekonomie funksionale vendase përmes fluksit të mjaftueshëm hyrës të fuqisë punëtore, për të zëvendësuar ata që e kalojnë moshën e punës (shih Grafikonin 15).

Grafiku-15. Parashikimet e evoluimit të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë pesë vitet e ardhshme (2021 deri në 2026)



11. Kucera, 2022.


Në shifra absolute, hyrjet e reja të forcës së punës nuk do të jenë të mjaftueshme për të zëvendësuar popullatën që e kalon moshën për punë. Për ta paraqitur në mënyrë sasiore këtë shpërpjesëtim, në vitin 2036, popullsia e grupmoshës 0 deri në 14 vjeç do të jetë rreth 70% e popullsisë së të njëjtës grupmoshë në vitin 2021, si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Në nivel absolut, hyrjet e reja në tregun e punës nuk do të jenë të mjaftueshme për të zëvendësuar largimin e popullsisë që nuk është më në moshë pune. Për ta paraqitur në mënyrë sasiore këtë shpërpjesëtim, në vitin 2036, popullsia e grupmoshës 0 deri në 14 vjeç do të jetë rreth 70% e popullsisë së të njëjtës grupmoshë në vitin 2021, si për meshkujt, ashtu edhe për femrat; nga ana tjetër, popullsia e grupmoshës 64 vjeçe e lart do të rritet me rreth 40% për meshkujt dhe 45% për femrat (shih Grafikonin 16).

Si do ta përballojë Shqipëria, si sistem socialekonomik, këtë çekuilibër nga pikëpamja e politikave? E përballur vonë me këtë fazë të tranzicionit demografik, Shqipëria mund të mësojë nga përvoja e shumicës së vendeve që janë përballur me këtë sfidë dekadat e shkuara.

Alternativat politike janë të njohura dhe receta për përballimin e plakjes së popullsisë është, padyshim, një kombinim i masave të mëposhtme:

- i. rritja planifikimit të migracionit hyrës për motive punësimi, për masa zëvendësimi sektor pas sektori;
- ii. rritja e produktivitetit të një ekonomie që kërkon më pak punonjës për të njëjtën vlerë PBB-je;
- iii. transferimi i pjesëve të ekonomisë jashtë vendit në territoret ku ka ende tepriçë të fuqisë punëtore.

**Grafiku-16. Parashikimet e evoluimit të popullsisë sipas moshës dhe gjinisë 15 vitet e ardhshme (2021 kundrejt 2036)**



- **Evoluimi i popullsisë në moshë pune**

Nëse e shohim më nga afër evoluimin e popullsisë në moshë pune, mund të vërejmë sesa rëndësi marrin elementet gjinore, sidomos për një vend që e ka shndërruar migracionin e jashtëm në një strategji socialekonomike në qendër të tri dekadave të fundit. Mungojnë njerëz dhe, konkretisht, burrat në grupmoshat 15-19, 20-24, 45-49, dhe 50-54 janë më të pakët, duke qenë se mbipërfaqësohen tek ata që kanë migruar jashtë (shih Tabelën 6).

Tabela-6. Prirjet e popullsisë mashkullore në moshë pune sipas moshës (2012-2021)<sup>12</sup>

	15-19vj	20-24vj	25-29vj	30-34vj	35-39vj	40-44vj	45-49vj	50-54vj	55-59vj	60-64vj	65+
1v	100.3%	91.7%	101.1%	106.1%	102.5%	102.4%	97.4%	93.2%	101.4%	99.4%	101.8%
2v	95.1%	88.5%	100.2%	97.8%	113.4%	105.6%	94.5%	91.8%	97.7%	102.4%	107.1%
3v	85.5%	84.5%	103.3%	101.7%	114.7%	103.9%	93.3%	87.3%	101.8%	106.4%	110.7%
4v	76.6%	92.0%	115.0%	96.2%	101.0%	91.1%	83.1%	81.3%	101.6%	114.7%	116.8%
5v	75.2%	96.4%	112.2%	104.8%	104.0%	92.5%	83.2%	81.6%	94.2%	110.6%	115.5%
6v	73.4%	86.8%	112.6%	140.8%	130.9%	94.7%	83.5%	78.4%	90.1%	103.8%	120.6%
7v	78.1%	83.8%	111.7%	127.8%	117.1%	100.9%	86.3%	77.8%	97.3%	124.5%	125.5%
8v	74.6%	90.7%	139.1%	164.8%	140.0%	98.1%	82.2%	76.1%	108.5%	138.3%	128.2%
9v	65.4%	89.1%	145.2%	168.0%	145.5%	89.6%	70.6%	67.7%	101.5%	113.2%	130.2%
Mesatare	80.5%	89.3%	115.6%	123.1%	118.8%	97.6%	86.0%	81.7%	99.3%	112.6%	117.4%

15-19vj	20-24vj	25-29vj	30-34vj	35-39vj	40-44vj	45-49vj	50-54vj	55-59vj	60-64vj	65+
---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	-----

Legjenda: Tabela tregon variacionet e madhësisë së çdo grupmoshe meshkujsh krahasuar me vitin e mëparshëm (1 vit), d.m.th., variacionet midis vitit 2021 dhe 2020, me vitin 2019 (2 vjet), me vitin 2018 (3 vjet) e kështu me radhë.

Duke pasqyruar zhvillimet demografike në popullsinë mashkullore në moshë pune, ka një prirje të qartë negative mes femrave të grupmoshave 15-19, 35-39, 40-44, 45-49, dhe 55-59 vjeçe, ndërkohë që mund të vërehet një prirje pozitive në grupmoshat 60-64 dhe 65+ vjeçe (shih Tabelën 7). Për grupmoshat 20-24, 25-29, 30-34 dhe 50-54, rezultati është i pasigurt, edhe pse ka një tendencë për prirje pozitive në grupmoshat 20 deri në 34 vjeçe dhe një prirje negative për grupmoshën 50-54 vjeçe.

Tabela-7. Prirjet e popullsisë femërore në moshë pune sipas moshës (2012-2021)

	15-19vj	20-24vj	25-29vj	30-34vj	35-39vj	40-44vj	45-49vj	50-54vj	55-59vj	60-64vj	65+
1v	91.4%	101.8%	96.8%	100.8%	100.5%	96.6%	98.3%	104.5%	94.3%	104.0%	103.6%
2v	87.5%	96.2%	97.9%	114.7%	96.9%	92.1%	95.9%	103.4%	94.5%	107.7%	106.9%
3v	91.0%	92.7%	97.5%	113.4%	100.6%	90.7%	93.2%	104.0%	93.1%	111.2%	111.0%
4v	86.1%	120.9%	109.9%	93.9%	90.6%	81.0%	88.0%	100.1%	92.8%	127.8%	115.8%
5v	87.8%	110.4%	116.5%	97.8%	93.2%	83.7%	84.8%	96.4%	92.3%	122.8%	117.7%
6v	82.1%	95.2%	117.0%	127.4%	97.7%	83.5%	83.9%	90.7%	91.1%	119.8%	119.0%
7v	77.0%	90.3%	113.1%	107.9%	97.5%	75.0%	91.0%	97.3%	97.8%	127.4%	122.6%
8v	60.8%	103.1%	130.5%	126.1%	98.3%	80.2%	80.5%	98.7%	106.7%	141.9%	134.8%
9v	74.1%	114.6%	155.8%	132.2%	87.1%	69.1%	82.6%	88.1%	104.4%	134.4%	127.3%
Mesatare	82.0%	102.8%	115.0%	112.7%	95.8%	83.5%	88.7%	98.1%	96.3%	121.9%	117.6%


15-19vj	20-24vj	25-29vj	30-34vj	35-39vj	40-44vj	45-49vj	50-54vj	55-59vj	60-64vj	65+
---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	-----

Legjenda: Tabela tregon variacionet e madhësisë së çdo grupmoshe femërore kundrejt vitit paraardhës (1v), d.m.th., variacionin midis vitit 2021 dhe 2020, me vitin 2019 (2v), me vitin 2018 (3v) dhe kështu me radhë.

Grafiku 17 tregon se mesatarja e prirjeve të popullatës në moshë pune 10 vitet e fundit është e ngjashme midis meshkujve dhe femrave. Diferenca kryesore ka të bëjë me zhvendosjen në të djathtë të kurbës mashkullore. Si popullata mashkullore, ashtu edhe ajo femërore në moshë pune shfaqin një prirje pozitive për grupmoshat nga 25 deri në 34 vjeç, pasi Shqipëria, në vitet '90, përjetoi norma jashtëzakonisht të larta lindjeje, duke përbërë përjashtim nga vendet e tjera të rajonit.

12. Përlllogaritjet mbështeten në të dhënat e ofruara nga INSTAT-i.


Grafiku-17. Mesatarja e prirjeve të popullsisë në moshë pune sipas moshës dhe gjinisë (2012-2021)



#### 1.4 Profilet sektoriale dhe profesionale të prekura nga migracioni


Ndikimi i migracionit të jashtëm në ekonomi kuptohet më mirë kur shohim migracionin neto, që del si rezultat i zbritjes së numrit të migrantëve të brendshëm nga numri i migracionit të jashtëm. Grafiku 18 (më poshtë) tregon se, në shifra absolute, numri i migrantëve në Shqipëri nuk mund të zëvendësojë atë që ka humbur përmes migracionit të jashtëm. Po kështu, ai tregon se, edhe pse numri i migrantëve të jashtëm po rritet në mënyrë të qëndrueshme (me përjashtim të vitit 2020, kur kufijtë u mbyllën), ka një prirje në rënie në shifrat e migrantëve që vijnë në Shqipëri. Kështu, Shqipëria ka një bilanc negativ të migracionit neto.

Grafiku-18. Numri i emigrantëve kundrejt imigrantëve




Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se të rinjtë, nga 20 deri në 39 vjeç, përfaqësojnë pjesën më të madhe të migrantëve hyrës në Shqipëri (shih Grafikon 19). Në vijim të asaj që u trajtua në këtë raport, këto shifra tregojnë se, edhe pse ka një bilanc negativ neto të migracionit, mosha e re e imigrantëve mund të paraqesë potencial për të zëvendësuar, edhe pjesërisht, atë çfarë është humbur nga prirjet e larta të migracionit të jashtëm te grupmoshat më të reja të shoqërisë shqiptare

**Grafiku-19. Imigracioni sipas grupmoshës**



Ashtu si me përbërjen gjinore të migracionit të jashtëm, mund të shohim nga Grafiku 20 (më poshtë) se ka më shumë migrantë të brendshëm meshkuj në Shqipëri, sesa femra imigrante. Kjo mund të përforcojë argumentet e diskutuara rreth prirjes më të madhe të burrave për të migruar.

**Grafiku-20. Imigracioni në vite sipas gjinisë**




Më tej, përbërja e migracionit të jashtëm dhe bilanci i tij neto varen nga një sërë faktorësh tërheqës dhe shtytës që veprojnë si në vendin dërgues, ashtu edhe në vendin pritës. Për ta ilustruar, ndryshimi në kërkesat për fuqi punëtore në vendet e zhvilluara të BE-së do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në përbërjen e migrantëve të jashtëm që largohen nga Shqipëria dhe do të ndikojë, për rrjedhojë, në sektorët ekonomikë.

Për të vlerësuar efektin e migracionit të jashtëm në shterjen e kapitalit njerëzor në Shqipëri, duhet të shohim sektorët ku punojnë aktualisht shumica e migrantëve të jashtëm, si dhe migrantët e mundshëm.

Në këtë linjë, statistikën e IOM-it (2022) që shfaqen në Grafikon 21 (më poshtë) tregojnë se më shumë se një në tre migrantë të jashtëm, 36,1% e tyre, vijnë nga sektori bujqësor, duke e bërë atë një prej sektorëve më të ekspozuar të ekonomisë ndaj ndikimit të nivelit të lartë të migracionit të jashtëm.


**Grafiku-21. Sektori i punësimit të migrantëve të jashtëm**




Kjo prirje e lartë e forcës së punës së angazhuar në sektorin bujqësor për të migruar bëhet edhe më e konsiderueshme, duke marrë parasysh se vetëm një e treta e forcës së punës punon në këtë sektor, siç tregohet në Grafikon 22 (më poshtë).

**Grafiku 22 – Forca e punës në sektorin bujqësor**

Megjithatë, kjo mund të ndikohet edhe nga faktorë shtytës në vendin dërgues (d.m.th. Shqipëria), që mund të lidhet me vështirësitë financiare të njerëzve që banojnë në fshatra. Për ta ilustruar këtë pikë, mund të përmendim se, sipas INSTAT-it, pensionet mesatare që u jepen pensionistëve të cilët jetojnë në zonat rurale janë shumë më të ulëta sesa ato që u jepen pensionistëve në zonat urbane (shih Grafikon 23 më poshtë).




**Grafiku-23. Pensioni mesatar**



Më tej, grupi i dytë më i madh i migrantëve të jashtëm janë ata që punësohen në shërbimet e tregut (27,2%), ndërsa 18,2% e tyre vijnë nga prodhimi (shih Grafikun 21, më sipër). Për t'i vënë në perspektivë këto shifra, Grafiku 24 (më poshtë) tregon se 40% e forcës shqiptare të punës punon në shërbimet e tregut, 27% në shërbime jotregtare, 17% në prodhim dhe 12% në sektorin e ndërtimit (INSTAT, 2022). Kështu, këto të dhëna mund të tregojnë se sektori i shërbimeve është më pak i prirur të ekspozohet ndaj shterimit të burimeve njerëzore. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të shërbimeve (shërbimet tregtare dhe jotregtare) për ekonominë e Shqipërisë, humbja e kapitalit njerëzor nga ky sektor mund të ketë pasoja më të mëdha ekonomike për të gjithë ekonominë.

Duke e përmbledhur, të dhënat tona tregojnë se bujqësia është më e ekspozuar ndaj zbrazjes së burimeve njerëzore, për shkak të prirjeve të migracionit të jashtëm. Thënë kjo, është me rëndësi të theksohet se, edhe pse migracioni i jashtëm dëmton disa sektorë dhe profile arsimore më shumë se të tjera, shterimi i burimeve njerëzore paraqet një rrezik të lartë për ekonominë në tërësi.

**Grafiku-24. Punësimi sipas sektorit**



## 1.5 Prirjet aktuale të migracionit dhe efektet në sistemin arsimor në Shqipëri

Flukset migratore formësohen nga faktorë të jashtëm, si dhe vendimet personale të migrantëve, mbështetur në aspiratat, aftësitë dhe kapacitetet e tyre. Ky kapitull synon të vlerësojë efektin e faktorëve tërheqës që burojnë prej vendeve të destinacionit mbi prirjet e migracionit të jashtëm të punonjësve migrantë shqiptarë. Për ta bërë këtë, pjesa e parë hedh dritë mbi stoqet dhe flukset migratore të jashtme shqiptare dhe mbi karakteristikat tipike të punonjësve migrantë shqiptarë. Hapi tjetër është analiza e emigracionit, për të identifikuar faktorët përkatës tërheqës sipas vendit që ka të ngjarë të formësojnë drejtimin e prirjeve migratore të jashtme në Shqipëri.

Megjithatë, një kusht është se ka rëndësi të vërehet se pandemia COVID-19 ka ndikuar rëndë ekonomitë e të gjitha vendeve të destinacionit dhe ka krijuar pasiguri të konsiderueshme për nevojat e tyre të ardhshme të tregut të punës dhe mungesën e kualifikimeve. Më tej, lufta në Ukrainë ka ndikuar në vendet e destinacionit në mënyra të ndryshme, për shembull, duke ofruar përkohësisht shifra të larta të ukrainasve në moshë pune me statusin e mbrojtjes së përkohshme në tregjet e tyre të punës. Duke qenë se kohëzgjatja e konfliktit në Ukrainë, ndikimi i saj në rritjen ekonomike në BE dhe kohëzgjatja e qëndrimit të migrantëve ukrainas është tërësisht e pasigurt, është e pamundur të vlerësohen pasojat në perspektivat e migracionit për motive punësimi dhe përfitimet e tij për punonjësit migrantë shqiptarë në të ardhmen. Në këtë rubrikë, do të jepet një përmbledhje e nevojave të tregut të punës së Greqisë, Italisë dhe Gjermanisë, krahas atyre të një vendi tjetër kyç destinacioni, Mbretërisë së Bashkuar.

Të dhënat për flukset e jashtme migratore të migrantëve shqiptarë kufizohen vetëm në vlerësimet e INSTAT-it, pasi Shqipëria nuk ka bërë ende një regjistrim të popullsisë. Numri i emigrantëve shqiptarë vlerësohet në bazë të të dhënave nga vendet e destinacionit, vlerësimet rreth zhvillimit të popullsisë shqiptare dhe informacionit të marrë nga anketa e forcës së punës. Siç është theksuar në Pikën 2.1, si imigracioni, ashtu edhe emigracioni pësuan rënie gjatë dekadës së shkuar, një prirje që është intensifikuar me shpërthimin e pandemisë COVID-19. Në një periudhë afatgjatë, migracioni i jashtëm u ul nga më shumë se 55 000 persona në 2011, në më pak se 24 000



në 2020, ndjekur nga një rikthim në mbi 42 000 migrantë të jashtëm në vitin 2021. Prirja e imigracionit është e ngjashme, ndaj migracioni absolut neto mbeti negativ për të gjithë periudhën e marrë në konsideratë.

Kur vjen fjala për të zgjedhur vendin e destinacionit, duhet marrë parasysh se për 35% të migrantëve shqiptarëve, gjëja kryesore që marrin në konsideratë është prania e një rrjeti kontaktesh shoqërore në vendin e ardhshëm të destinacionit. Një rrjet personal është një mënyrë për të lehtësuar trysnitë e përshtatjes në periudhën pas mbërritjes dhe për të zbutur kufizimet financiare, duke qenë se familjarët ose miqtë që punojnë tashmë jashtë mund të ofrojnë mbështetje jomateriale dhe strehim ose mund të sigurojnë kapitalin fillestar për të nisur një jetë të re jashtë vendit. Duke qenë se vendet kryesore të destinacionit historikisht dhe aktualisht janë Greqia, Italia dhe Gjermania, analiza në këtë kapitull do të përqendrohet në këto vende.

Një raport i Bankës Botërore nga viti 2010 tregon se 44% e shqiptarëve donin të migronin, nga të cilët një e katërta e shqiptarëve shpreheshin se synonin të emigronin brenda dy viteve të ardhshme. Edhe pse raporti i vitit 2010 nuk mund të ofrojë vështrime mbi zhvillimet e fundit, ai mund të shërbejë si pikënisje për hetimin e faktorëve shtytës dhe faktorëve tërheqës sipas vendeve. Raporti identifikon qartë aftësitë gjuhësore dhe përpjekjet burokratike për të marrë dokumentet e nevojshme, si dy elemente kryesore që merren parasysh nga migrantët e ardhshëm, si dhe efektet e reagimeve nga përvojat pozitive të migracionit që i motivojnë të kthyerit të migrojnë sërish ose mund të ndikojnë të tjerët të migrojnë për herë të parë.

Përpos rrjeteve familjare, gjetja e punësimit dhe marrja e arsimimit konsiderohen si faktorë motivues nxitës. Të dhënat përshkruese të anketës nga raporti i Bankës Botërore tregojnë se motivimi për t'u larguar nga Shqipëria në thuajse dy të tretat e rasteve është ekonomik, i lidhur me dëshirën për të përmirësuar standardet e jetesës dhe për të gjetur një punë. Ndryshe nga kjo, financimi i arsimimit të fëmijëve u raportua si motivi kryesor për 8% të emigrantëve shqiptarë.

Të dhënat më të fundit nga Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje i mbështesin këto gjetje dhe ofron disa vështrime më të thelluara. Dy të tretat e familjeve të anketuara u përgjigjën se arsyet ekonomike, si standarde më të mira jetese, ishin nxitësit kryesorë të emigracionit. Historikisht, këta faktorë kanë qenë edhe më të fortë. "Arsyet financiare" dhe 'Kërkimi i standardeve më të mira të punës dhe jetesës' u përmendën nga më shumë se 85% e emigrantëve u bënë më të rëndësishme. Këta numra pësuan rënie gjatë 30 viteve të fundit dhe "arsyet familjare" shtesë morën - këtu mund të vërejmë një rritje nga 10% deri në më shumë sesa 24%.

Po ashtu, faktorët arsimor kanë marrë më shumë rëndësi, nga 3,5% gjatë viteve '90 deri në 7,4% në dekadën e shkuar, sipas AKMF-së. Ndryshe nga këto gjetje, statistikat e Eurostat-it konstatojnë një tjetër rend të burimeve të migracionit, duke përcaktuar arsyet familjare si më të rëndësishmet, të ndjekura nga arsyet arsimore dhe aktivitetet ekonomike. Eurostat-i mbështetet te statistikat e përftuara nga vendet pritëse, ndërkohë AKMF-ja anketon anëtarët e familjes që kanë qëndruar në Shqipëri. Për rrjedhojë, ka të ngjarë që AKMF-ja merr gjithashtu informacion për migracionin e parregullt. Megjithatë, arsyet ekonomike duket se janë nxitësit kryesorë, si dhe arsyet familjare dhe arsimore. Duke marrë gjininë parasysh, statistikat e Eurostat-it tregojnë se migracioni i lidhur me motivet financiare dhe kërkimin i kushteve më të mira të punës dhe jetesës janë shumë më të përhapura te burrat (përkatesisht, 42,3% dhe 36,6%) sesa te gratë (17% dhe 25,4%). Në të kundërt, migracioni te gratë ndodh më shpesh për shkak të arsyeve familjare (43,9%) sesa te burrat (11,9%). Kjo mund të tregojë se gratë migrante ndjekin bashkëshortët meshkuj, të cilët, fillimisht, migrojnë kryesisht prej motiveve ekonomike.

Të dhënat e AKMF-së tregojnë gjithashtu se statusi ekonomik i migrantëve përpara migracionit ndikon vendimet për migracionin e jashtëm. Faktorët ekonomikë janë më të përhapura te shqiptarët në moshë pune, edhe pse arsyet arsimore dhe arsyet shëndetësore janë shkaqet mbizotëruese të migracionit, përkatesisht, për studentët dhe personat me aftësi të kufizuara. Ndjekja e studimeve jashtë po shfaqet si faktor gjithnjë e më i rëndësishëm motivues për migracionin e jashtëm. Duke qenë se sistemet italiane dhe gjermane të arsimit të lartë mbeten mjaft konkurruese mes atyre të 27 vendeve anëtare të BE-së, të dyja vendet ka gjasë të tërheqin një numër në rritje të migrantëve shqiptarë për motive arsimimi.

13. <http://icm-westernbalkans.com/wp-content/uploads/2015/04/536420PUB0Migr101Official0Use0Only1.pdf>.

14. Po aty

15. Po aty

- **Politikat shtrënguese të imigracionit në vendet e destinacionit**

Të tria vendet kryesore të destinacionit (Greqia, Italia dhe Gjermania) kanë vendosur disa politika shtrënguese imigracioni për migrantët shqiptarë, që synojnë të kufizojnë kohëzgjatjen e qëndrimit në periudha të përkohshme migracioni. Megjithatë, kalimi i kufirit shqiptar drejt Greqisë fqinje është i mundur edhe pa vizë, që prej vitit 2010. Në vijim të krizës së refugjatëve të vitit 2015, Gjermania i deklaroi Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi si vende të sigurta origjine, në përpjekje për t'i bërë më efikase procedurat e pranimit të aplikuesve të kualifikuar, sidomos nga Siria dhe Iraku dhe për të kufizuar alternativat e migracionit humanitar për migrantët që nuk kualifikoheshin për to nga Ballkani Perëndimor. Në vitin 2016, Gjermania miratoi një ligj të dytë për azilin që lehtësonte kthimin e migrantëve nga Ballkani Perëndimor në vendet e tyre të origjinës, në rast se kërkesat e tyre për azil refuzoheshin. Italia ka vendosur politika kufizuese migracioni për migrantët shqiptarë qysh në fund të viteve '90. Qeveria italiane vendosi kuota imigracioni për Shqiptarët dhe nënshkroi marrëveshje dypalëshe për të luftuar migracionin e paligjshëm nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshje të njëpasnjëshme dypalëshe u nënshkruan në vitin 2008 dhe 2009, për të nxitur migracionin e rregullt për motive punësimi, p.sh., përmes programeve të trajnimit dhe praktikave profesionale dhe për të siguruar mbështetje për komunitetet vendase. Megjithatë, problemet vazhdojnë, për shembull, në rastin e punëdhënësve italianë të cilët nuk i pranojnë diplomat e huaja të infermierëve shqiptarë të trajnuar në Itali.

Që prej viteve '90, migracioni shqiptar në Greqi karakterizohej kryesisht nga lëvizja e përkohshme dhe sezonale për motive punësimi. Megjithatë, si rezultat i kësaj, u rritën edhe shpërnguljet e përhershme. Për të frenuar migracionin e rregullt, në vitin 1991, Greqia miratoi një ligj që lehtësonte dëbimet dhe, një dekadë më vonë, në vitin 2001, lehtësoi marrjen e lejeve të përkohshme të qëndrimit për shtetasit shqiptarë. Më vonë, në vitin 2005, Greqia shtoi stimujt për punonjësit me kualifikim të ulët dhe kualifikim të lartë për të imigruar përkohësisht. Edhe pse ky ishte faktor tërheqës për punëkërkuarit shqiptarë, sistemi i ngarkuar grek i imigracionit e bëri të vështirë zgjatjen apo përsëritjen e aplikimit për shtyrjen e kohëzgjatjes së vizës. Numri i migrantëve të parregullt u ul pas arritjes së marrëveshjes për viza me BE-në në vitin 2010. Përveç kësaj, u lidhën marrëveshje sektoriale për të përcaktuar kuota sezonale, por ato patën efekt shumë të kufizuar në nxitjen e migracionit të rregullt sezonal të punonjësve shqiptarë.

- **Faktorët tërheqës sipas vendit dhe vlerësimi i nevojave për aftësi**

Krah politikave të imigracionit, nevojat faktike të tregut të punës dhe pragu i pagave në vendet e destinacionit faktorizohen në vlerësimet ekonomike të migrantëve të ardhshëm dhe, si të tilla, duhen marrë parasysh për të kuptuar dhe parashikuar prirjet migratore. Megjithatë, siç u theksua më lart, këta faktorë nuk veprojnë të veçuar, por ndërthuren me faktorë jomaterialë, si rrjetet ekzistuese të diasporës, lidhjet familjare, perspektivat e integritetit dhe afërsia gjeografike. Megjithatë, konsideratat ekonomike luajnë rol thelbësor në proceset vendimmarrëse të punonjësve të ardhshëm migrantë. Kjo rubrikë ofron një panoramë të variablave përkatëse të tregut të punës që luajnë rol në vendet kryesore të destinacionit.

Pikësëpari, që nga viti 2012, PBB e përgjithshme për frymë e Shqipërisë luhet midis 30 dhe 40% të mesatares së 27 vendeve të BE-së. Tri vendet kryesore të destinacionit regjistruan nivele shumë më të larta të PBB-së për frymë dhe, përkatësisht, Greqia me 65%, Italia me 95% dhe Gjermania me 119%. Sa i takon Greqinë, e cila ka përjetuar një rënie në PBB-në e krahasuar për frymë, migracioni i jashtëm i shqiptarëve është ulur në mënyrë domethënëse gjatë dekadës së shkuar. Pavarësisht zhvillimit të ngjashëm krahasues të ekonomisë në Itali, prirjet e migracionit të jashtëm drejt këtij vendi mbeten në mënyrë qëndrueshme të larta.

Përpos zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, pritshmëritë e pagave shërbejnë si një faktor i rëndësishëm tërheqës. Ashtu si për PBB-në për frymë, Shqipëria mbetet pas fqinjëve të Ballkanit Perëndimor, pa përmendur shtetet anëtare të BE-së, sa u takon pagave mesatare. Edhe pse pagat në Greqi janë mjaft më të larta se në Shqipëri, ato mbeten krahasimisht të ulëta kundrejt mesatares së 27 vendeve të BE-së, duke qenë se kostoja e llogaritur e punës në orë për vitin 2021 ishte 17 euro. Italia (28 euro) dhe Gjermania (37 euro) kanë rezultate mbi mesataren në këtë statistikë. Ky mund të jetë faktor kontribues për të shpjeguar se pse flukset migratore kanë ndryshuar gradualisht nga Greqia drejt Italisë dhe Gjermanisë gjatë viteve të kaluara.

16. Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, Raporti për vendin 2019, Shqipëria. [Në internet]

Gjendet në: [https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018\\_CN\\_ALB.pdf](https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018_CN_ALB.pdf).

17. Marrëveshja midis Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e lëshimit të vizave, që gjendet në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A22007A1219%2805%29>.

18. [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=GDP\\_per\\_capita,\\_consumption\\_per\\_capita\\_and\\_price\\_level\\_indices](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=GDP_per_capita,_consumption_per_capita_and_price_level_indices).

## Italia

Pas përjetimit të një migracioni masiv jashtë vendit përgjatë shekullit të 20-të, Italia tashmë është bërë një prej destinacioneve kryesore të migracionit për motive punësimi në Evropë dhe numëron një popullatë të madhe migrante. Kjo vjen pjesërisht për shkak të pozitës së saj gjeografike në rajonin e Mesdheut, por edhe për shkak të kërkesës së tregut të punës.

Në periudhën 2018-2030, vlerësohet se në Itali do të hapen 13,750,000 vende pune, të nxitura kryesisht nga kërkesa për zëvendësim. Dekadën e kaluar, punonjësit migrantë iu përgjigjeshin më së shumti nevojave për zëvendësim në profesionet me kualifikim të ulët, që punonjësit vendas nuk mundeshin ose nuk donin t'i pranonin (kryesisht në sektorët e bujqësisë, ndërtimit dhe kujdesit personal). Puna joformale është gjithashtu e përhapur në Itali dhe mbështetet gjerësisht në një numër i madh migrantësh të padokumentuar.

Sidoqoftë, për shkak të prirjeve për rritjen e vazhdueshme të kualifikimeve dhe madhësisë së tregut të punës, ka gjasë të rritet kërkesa për migracion të synuar të punonjësve gjysmë të kualifikuar dhe të kualifikuar. Kjo ndodh veçanërisht për shkak të faktit se tregu italian i punës vuan nga mospërputhja e kualifikimeve, si dhe nga mungesat e konsiderueshme të aftësive, sidomos në rajonet jugore (të shkaktuara pjesërisht nga migracioni i vazhdueshëm dalës i italianëve me kualifikim të lartë në veri të Italisë/në vende të tjera të BE-së). Kualifikimi i ulët ndihet sidomos në pozicionet e punëve të jakave blu, si punonjësit e ndërtimit dhe punonjësit në profesionet e lidhura me të, duke iu hapur shtigje të mundshme migrantëve me formim profesional dhe arsim të lartë. Përveç kësaj, zhvillimet demografike tregojnë se do të ketë kërkesë të vazhdueshme për punën e migrantëve, jo vetëm për të zëvendësuar punonjësit vendas, por edhe për t'iu përgjigjur kërkesës në rritje për pozicione që lidhen me plakjen e popullsisë, si ndihmës në punët e shtëpisë dhe punonjës shëndetësor (infirmierë).

Tregu i punës është i organizuar në nivel sektori, me një sistem të centralizuar marrëveshjeje kolektive në fuqi. Në fakt, kjo u garanton punonjësve me kontrata pune të përhershme siguri dhe kushte të mira pune, edhe pse, nga ana tjetër, kufizon fleksibilitetin e tregut të punës. Ka dallime të konsiderueshme rajonale, me papunësi më të ulët dhe paga më të larta në veri të vendit; për rrjedhojë, përllogaritjet e pagave për Italinë janë vetëm të përgjithshme. Gjeografikisht, jugu i Italisë është tërheqës për migrantët shqiptarë. Një faktor tjetër tërheqës këtu është nevoja për punësim të përkohshëm në sektorin bujqësor. Shifrat e ISTAT-ti për nevojat për punësim në Itali tregojnë se nga viti 2020 deri në vitin 2021, vendet e lira të punës mbizotëroheshin nga sektori i shëndetësisë (223-241,000), shërbimet publike dhe private (145-170,000) dhe sektori i formimit dhe kulturës (152-169,000). Profesionet kryesore që kishin nevojë për punonjës ishin punonjësit e kualifikuar (107,020), personeli i shitjeve & shërbimeve (87,120), menaxherët & dhe profesionet me specializim të lartë (68,050) dhe profesionet e pakualifikuara (43,480).

## Gjermania

Tregu gjerman i punës prodhon vazhdimisht kërkesë të lartë për punonjës të huaj të kualifikuar. Pas mbërritjes së mbi 1 milion azilkërkuesve në vitin 2015 dhe 2016, shumica e të cilëve ishin në moshë pune, politikat gjermane të migracionit për motive punësimi ndryshuan drejt pakësimit të migracionit me kualifikim të ulët jashtë BE-së, duke u përqendruar te tërheqja e punonjësve migrantë të kualifikuar dhe me kualifikime të larta.

Mungesat e fuqisë punëtore në vend janë të konsiderueshme dhe vlerësohet se, gjatë pesë viteve të ardhshme, mund të hapen më shumë se 6 milionë vende të lira pune. Profesionet më të kërkuara në të ardhmen do të kërkojnë të paktën kualifikime në nivel mesatar dhe përfshijnë profesionistë të lidhur me biznesin dhe administrimin, punonjës të kujdesit personal, punonjës në sektorin e shitjeve dhe punonjës të kualifikuar ndërtimi. Arsyeja për këto mungesa përfshin mospërputhjen e kualifikimeve, pagat e ulëta, si dhe kushtet sfiduese të punës në disa prej sektorëve, për shkak të të cilave popullata vendase heziton t'i zërë këto vende pune. Përveç kësaj, ashtu si në vende të tjera në BE, prirjet demografike në Gjermani sugjerojnë se migracioni i synuar për motive punësimi do të jetë i nevojshëm për të plotësuar pozicionet e lira në treg, si për periudhën afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatgjatë.

19. <https://ec.europa.eu/migrant-integration/librarydoc/migration-in-italy-the-current-situation-and-perspectives>.

20. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020SC0511>.

21. [http://www.igier.unibocconi.it/files/PolicyBrief2\\_DEFINITIVA-Monti\\_\(1\).pdf](http://www.igier.unibocconi.it/files/PolicyBrief2_DEFINITIVA-Monti_(1).pdf)

22. Llogaritjet e autorëve bazuar në instrumentin e Parashikimit të Aftësive, CEDEFOP, konsultuar në adresën <https://www.cedefop.europa.eu/en/publications-and-resources/data-visualisations/skills-forecast>.

Punëdhënësit në Gjermani piren ta vënë theksin tek aftësitë gjuhësore. Një anketë nga OECD-DIHK-BMAS, tregoi se për punët me kualifikim të ulët, 50 % e punëdhënësve kërkonin aftësi të mira gjuhësore, ndërkohë që shifra shkonte në 90 % për vendet e punës me kualifikim mesatar. Qasja mbështetet nga qeveria gjermane, e cila ka nxitur programet e integritit dhe financimin për migrantët dhe i konsideron njohjen e gjuhës gjermane si parakusht thelbësor për lëshimin e llojeve të caktuara të vizave. Për rrjedhojë, duhen ndjekur alternativat arsimim-në-punësim, sa i përket përgatitjes gjuhësore dhe trajnime të tjera për të rritur shanset e shqiptarëve për të gjetur punësim në Gjermani. Punësimi informal është i kufizuar dhe një alternative jo e mundshme për punëkërkuarit. Gjermania është federatë me 16 lande (Bundesländer). Në kontekstin e politikave të punës, qeveria federale përcakton kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe drejtimet e politikave. Në ndryshim nga kjo, landet janë përgjegjëse për zbatimin dhe hartimin e politikave të tyre rajonale. Përveç kësaj, disa bashki dhe organizata/dhoma punëdhënësish ndërhyjnë gjithashtu me nismat e tyre. Kjo sjell disa mospërputhje rajonale sa u takon politikave dhe nevojave për punë - p.sh., ish-Gjermania Lindore vuan nga mungesa shumë më të mëdha sesa pjesa perëndimore e vendit.

## Greqia

Në Greqi, sektorët më të rëndësishëm për emigrantët sezonalë shqiptarë të punës janë në rënie që nga viti 2014 dhe u prekën ndjeshëm nga pandemia COVID-19. Përkatësisht, këta janë sektorët e punonjësve të pakualifikuar, të tillë si bujqësia, blegtoria dhe peshkimi. Tendenca të ngjashme të papunësisë vërehen për profesionet e punonjësve fizikë. Për profesionet jomanuale vërehet një tendencë në rritje e punësimin. Kolapsi ekonomik ishte veçanërisht i rëndë për punësimin në sektorin e ndërtimit, duke goditur më fort punonjësit dhe teknikët e pakualifikuar. Po ashtu, punësimi në fushën e punonjësve të zyrave, punonjësve të shërbimit personal, shitësve dhe pastruesve ka rënë. Nga ana tjetër, është evidentuar rritje e punësimin në sektorin e përpunimit, transportit, magazinimit, turizmit, administratës publike, mbrojtjes dhe arsimit.

## Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar po përballet me një mungesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të dy efekteve kryesore. Së pari, pas Brexit-it oferta e punës u ul në mënyrë masive, duke përjashtuar nga tregu i punës veçanërisht punonjësit e BE-së me kualifikime të ulëta. Së dyti, rritja ekonomike pas izolimit për shkak të pandemisë ka çuar në një situatë me kërkesë me rritje të shpejtë, të përkeqësuar nga mungesa e punonjësve të BE-së (përfshirë punonjësit sezonalë) që, më parë, kishin qasje të lirë në tregun e punës në Mbretërinë e Bashkuar. Me rreth 1,1 milionë vende të lira pune vetëm në periudhën korrik-shtator 2021, mungesat e fuqisë punëtore në MB janë të pashmangshme dhe shtrihen në të gjithë sektorët. Bujqësia, përpunimi i ushqimit, transporti, logjistika dhe turizmi janë vetëm disa nga sektorët me mungesa akute të forcës së punës. Aktualisht, qeveria konservatore e Mbretërisë së Bashkuar nuk u përgjigjet thirrjeve për të hapur tregun e punës për migrantë që nuk vijnë nga shtetet e BE-së. Në të njëjtën kohë, trysnitë nga komuniteti i biznesit po rriten dhe ka të ngjarë të çojnë në ndryshime të politikave, sikurse u njoftua nga kryeministria e atëhershme, Liz Truss, në mes të shtatorit të vitit 2022. Disa nga vendet e lira të punës janë krijuar për shkak të pagave dhe kushteve të këqija të punës, duke e shkurajuar popullsinë vendase të zërë vendet e lira të punës. Kohët e fundit, pagat në disa profesione janë rritur ndjeshëm, pasi punëdhënësve iu desh të bëheshin më tërheqës për tregun e punës. Disa drejtues sindikatash kanë shprehur shpresën për përmirësimin e kushteve të punonjësve.

Profesionet e kualifikuara më të kërkuara që mund të jenë tërheqëse për emigrantët shqiptarë përfshijnë punonjësit e kujdesit personal dhe shërbimit personal, si dhe shoferët dhe operatorët e impianteve të lëvizshme. Ndërsa kërkesa në tregun e punës me siguri do të rritet gjatë pesë deri dhjetë viteve të ardhshme, aktualisht, Mbretëria e Bashkuar nuk lëshon viza pune për punë me kualifikim të ulët për shtetasit e shteteve joanëtare në BE, përveç sektorit bujqësor. Vendet e punës me kualifikim të ulët kërkohen kryesisht në sektorin e përgatitjes së ushqimit dhe bujqësisë, minierave, ndërtimit, prodhimit dhe transportit dhe, së fundi, si pastrues dhe ndihmës. Mbizotëron rekrutimi formal. Sipas disa vlerësimeve, sektori informal prodhon deri në 20% të PBB-së së Mbretërisë së Bashkuar, ku profesionet e parregulluara kryesisht ofrohen nga punonjës migrantë. Megjithatë, punët informale janë shumë të pasigurta dhe nuk u ofrojnë punonjësve mundësinë për të qëndruar ligjërisht në MB dhe, për rrjedhojë, nuk janë të këshillueshme si rrugë migracioni për migrantët e rinj.

23. <https://www.oecd.org/els/mig/Finding-their-Way-Germany.pdf>.

24. [https://www.kfw.de/PDF/Download-Center/Konzernthemen/Research/PDF-Dokumente-KfW-ifo-Fachkr%C3%A4ftebarometer/KfW-ifo-Fachkraeftebarometer\\_2021-01\\_EN.pdf](https://www.kfw.de/PDF/Download-Center/Konzernthemen/Research/PDF-Dokumente-KfW-ifo-Fachkr%C3%A4ftebarometer/KfW-ifo-Fachkraeftebarometer_2021-01_EN.pdf).

25. <https://www.ons.gov.uk/employmentandlabourmarket/peopleinwork/employmentandemployeetypes/timeseries/jp9z/unem>.

26. Shih, për shembull: <https://www.theguardian.com/uk-news/2022/sep/24/liz-truss-plans-to-loosen-immigration-rules-to-boost-uk-economy>.

27. Williams C (2014) Out of the shadows: A classification of economies by the size and character of their informal sector. *Work, Employment and Society* 28(5): 735–754.

- Perspektiva dhe aspekte të skenarëve të ardhshëm të punës së migracionit të jashtëm

Rritja e ngadaltë ekonomike në Itali dhe Greqi, e kombinuar me zgjerimin e korridoreve të migracionit të migrantëve me aftësi të larta nga politikëbërësit gjermanë dhe britanikë, mund të favorizojë skenarin ku migrantët e ardhshëm shqiptarë të largohen nga vendet 'tradicionale' të destinacionit, të tilla si Italia dhe Greqia, duke zgjedhur në vend të tyre shtete të tilla si Gjermania dhe Britania e Madhe, të cilat kanë nivele më të larta pagash, kushte më të mira pune dhe jetese dhe perspektiva më të mira të integritit të përgjithshëm. Ky skenar bëhet edhe më i mundshëm për shkak të rënies së kostove të transportit dhe mediave sociale, të cilat zvogëlojnë rëndësinë e afërsisë gjeografike si faktor vendimtar. Megjithatë, analiza e nevojave të tregut të punës në vendet e destinacionit gjithmonë duhet të kontekstualizohet duke marrë parasysh faktorë të tjerë ndërmjetësues që qëndrojnë në thelb të pasigurisë: për shembull, fushëveprimi dhe rreptësia e rregulloreve kyçe të ardhshme të migracionit për motive punësimi (të cilat mund të bëhen më shumë ose më pak kufizuese sesa ato të fundit), rregulloreve të mundshme kufizuese për shkak të një vale tjetër të COVID-19-ës, ose pasojave ekonomike dhe të tregut të punës nga konflikti në Ukrainë.

## 1.6 Migracioni dhe zgjedhjet arsimore


Sikurse është diskutuar më sipër në këtë raport, shumë vende të zhvilluara evropiane kanë hartuar politika për të tërhequr të diplomuar me kualifikim të lartë nga vendet më pak të zhvilluara dhe u kanë ofruar atyre një rrugë drejt migracionit afatgjatë, si një strategji për të rekrutuar një fuqi punëtore shumë të kualifikuar në të ardhmen e afërt (OECD, 2012; OECD & UNDESA, 2013). Nga ana tjetër, një studim i botuar nga Fondacioni "Friedrich Ebert" në Tiranë tregon se shumica e të rinjve shqiptarë aspirojnë të emigrojnë në vende të tjera të BE-së.

Figura-7. Arsyet për të migruar

	Të punësuar (me kohë të plotë/ të pjesshme)	Të papunë	Nxënës, studentë, trajtime të mëtejshme	Të dalë në pension	Me aftësi të kufizuara	Shtëpiake	Persona të tjerë jo aktivë	Gjithsej
Arsye financiare	47.9	38.9	8.1	3.3	24.1	11.6	10.0	35.0
Duke kërkuar standarde më të mira pune dhe jetese	34.7	36.0	28.1	7.7	0.0	31.4	20.3	33.9
Arsye profesionale	3.2	0.9	4.1	0.0	0.0	0.0	3.9	1.8
Arsye studimi	0.8	2.0	43.5	1.5	0.0	0.0	5.2	7.2
Arsye familjare	12.9	20.7	14.7	83.0	20.8	50.7	55.6	20.5
Shëndeti	0.2	0.8	0.5	4.5	55.1	0.6	0.0	0.8
Të tjera, specifikoni (.....)	0.3	0.6	1.0	0.0	0.0	5.7	5.0	0.8

Ndërsa vetëm 7% e të anketuarve (IOM, 2022) pretendojnë se arsimit është arsyeja kryesore për të emigruar (shih Figurën 7, më poshtë), pjesa më e madhe e këtyre migrantëve potencialë, 44% e tyre, janë studentë. Kjo tendencë duket se është e qëndrueshme gjatë tre dekadave të fundit, duke lëvizur nga 7,8% në 12,2% (Grafiku 25).


Grafiku-25. Arsyet kryesore për të migruar



Ka literaturë të shumtë që mbulon ndikimin e planeve të mundshme të migrimit në zgjedhjet arsimore që bëjnë studentët. Disa autorë pretendojnë se perspektiva e emigracionit rrit kërkesën për arsim të lartë në vendin dërgues (Mayr & Peri, 2009; Commander et al., 2004; Stark et al., 1997). Megjithatë, statistikave zyrtare të INSTAT-it tregojnë se numri i studentëve në Shqipëri po bie vazhdimisht me një nivel të qëndrueshëm prej 15%. Nga ana tjetër, disa autorë kanë përdorur të dhëna statistikore për të treguar se migrantët e ardhshëm zgjedhin të studiojnë jashtë vendit si një hap drejt migracionit afatgjatë në një vend pritës (Faini, 2003; Carrington & Detragiache, 1999). Studime të ndryshme tregojnë se studentët shqiptarë kanë frikë se përfundimi i studimeve në Shqipëri mund të cenojë punësimin e tyre jashtë vendit (King & Gadeshi, 2005). Për shembull, Euro Student (2017) thotë se vetëm 11% e studentëve në vendet e Evropës Lindore besojnë se arsimi i ofruar nga IAL-të në vendin e tyre i përgatit ata mirë për tregun ndërkombëtar të punës.

Ky arsytim mund të jetë në përputhje me të dhënat e diskutuara, të cilat tregojnë se shumica e migrantëve të jashtëm nuk e kishin përfunduar arsimin e lartë përpara se të largoheshin nga Shqipëria.

Figura-8. Arsyet kryesore për të emigruar– sipas statusit të punës




## 1.7 Faktorët shtytës dhe tërheqës të korridorit qendër-periferi të migracionit

Shumë vende të zhvilluara kanë investuar qëllimisht për t'u bërë më tërheqëse për një lloj të caktuar migrantësh, që janë punonjës të rinj dhe të kualifikuar nga e gjithë bota. Në një përpjekje për të ndihmuar qeveritë të bëhen tërheqëse, OECD-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare kanë identifikuar një sërë faktorësh tërheqës, të cilët përfshijnë promovimin e disa stimulujve financiarë, të tilla si heqja e pengesave politike dhe ligjore ndaj migracionit. Gjithashtu, ata kanë identifikuar pengesa për lëvizjen e lirë të punës dhe kanë ndërmarrë disa iniciativa për heqjen e tyre (Shabani, 2020). Për më tepër, shtetet kryesore të zhvilluara evropiane kanë rritur fuqinë e tyre të butë, që është tërheqja për shkak të modelit të tyre politik dhe kulturor.

Sikurse është diskutuar edhe gjetkë në këtë raport, kur janë pyetur për arsyen kryesore pse duan të emigrojnë, 69% e të rinjve përmendin standardet më të mira të jetesës. Grafiku 25 (sipër) tregon se kjo tendencë është më e lartë ndërmjet personave që janë tashmë të punësuar. Për rrjedhojë, mund të arrihet në përfundimin se ka një kombinim të faktorëve shtytës dhe tërheqës që luajnë rol për marrjen e vendimit për të emigruar.


Fluksi i migracionit me një drejtim, i diskutuar më sipër, inkurajohet nga dy faktorë kryesorë: së pari, ekziston një dëshirë shumë e ulët për t'u kthyer në vendin e origjinës ndërmjet migrantëve shqiptarë të jashtëm. Figura 9 (më poshtë) tregon se vetëm një në katër të rinj, 24% e tyre, planifikojnë të emigrojnë për më pak se pesë vjet (Kamberi & Cela, 2019). Shumica e tyre duan të emigrojnë për një kohë të gjatë, ose edhe të mos kthehen më fare. Në mënyrë të ngjashme, anketa të tjera tregojnë se vetëm 5 për qind e studentëve shqiptarë jashtë planifikojnë të kthehen në vendin e origjinës pas diplomimit (King & Gedeshi, 2020).

Figura-9. Sa gjatë dëshironi të qëndroni jashtë shteti?



Për më tepër, këta faktorë shtytës veprojnë si një pengesë për migracionin e kthimit, duke dekurajuar shumë punonjës të kualifikuar të kthehen në vendin e tyre, edhe nëse ata do të preferonin ta bënin këtë. Bratsberg (1995) ka konstatuar se situata ekonomike dhe politike e vendit dërgues është një parashikues i mirë i dëshirës për të emigruar, si dhe dëshirës për t'u kthyer.

Figura-10. Cila është arsyeja kryesore pse do të shkonit në një shtet tjetër?




Një tjetër faktor shtytës, që pengon të rinjtë të kthehen në Shqipëri, është fakti se tregu i brendshëm i punës nuk mund të kthejë investimet e tyre financiare për arsimin. Disa studime (Saxenian, 2002) tregojnë se studentët e Evropës Lindore që janë shkolluar jashtë kanë edhe më pak stimuj për t'u kthyer në vendin e tyre pasi tregu i brendshëm i punës nuk mund t'u kthejë investimet financiare të shpenzuara prej tyre për t'u arsimuar. Në të njëjtën mënyrë, studimet empirike (Nedeljkovic, 2014; Borjas, 1992), konstatojnë se kthimi në vendet dërguese përcaktohet nga niveli në të cilin vlerësohen aftësitë e të kthyerve në vendin e tyre. Nëse ata vlerësohen më pak në vendin e tyre sesa në vendin pritës, migrantët më të kualifikuar nuk do të kthehen.

Gjithashtu, nivelet e migracionit të jashtëm lidhen me kapacitetin e vendit për novacion dhe për të konkurruar ndërkombëtarisht përmes kapaciteteve të tij kërkimore dhe zhvillimore (Collier, 2013). Një studim tjetër Shabani (2020) konstatoi se nivelet e larta të migrimit të jashtëm kanë penguar kapacitetin e Shqipërisë për të mbajtur talentin e saj në shkencë dhe, për rrjedhojë, kanë dëmtuar pozicionin e saj global në Indeksin Global të Novacionit, të prodhuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO). Për rrjedhojë, institucionet akademike shqiptare nuk kanë qenë në gjendje të përfitojnë nga grantet konkurruese kërkimore ndërkombëtare, të cilat nga ana e tyre do të kishin ndihmuar vendin të përmirësonte kërkimin dhe të inkurajonte novacionin.

Si pasojë e këtyre përpjekjeve të bashkërenduara të shteteve kryesore të BE-së për të rritur fuqinë e tyre tërheqëse, ka një numër në rritje të personave me arsim të lartë në të gjithë periferinë e Evropës që aspirojnë të jetojnë dhe punojnë në këto vende. Figura 11 (më poshtë) tregon se Shqipëria nuk bën përjashtim, me shumicën e të rinjve që zgjedhin të emigrojnë në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar dhe Itali. Në mënyrë të ngjashme, statistikat e UNESCO-s tregojnë se vendet kryesore të destinacionit për studentët shqiptarë janë Italia, Gjermania dhe Franca (UIS, 2017).




Figura-11. Ku do të preferonit të shkonit? Renditni tri shtete që ju pëlqejnë më shumë.



Për më tepër, pjesëmarrja e këtyre vendeve në marrëveshjet ndërkombëtare që lehtësojnë lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore e ka bërë më të lehtë migrimin e fuqisë punëtore dhe, për pasojë, krijimin e korridoreve të migracionit Lindje-Perëndim (Shabani, 2020). Për ilustrim, figura 12 (më poshtë) tregon se pas anëtarësimit në një proces që lehtëson lëvizjen e lirë të akademikëve, studentëve dhe të diplomuarve (d.m.th. procesi i Bolonjës), këto prirje migracioni janë konsoliduar edhe më tej.

Nga ana tjetër, sikurse diskutohet diku gjetkë në këtë raport, situatat në vendet në zhvillim të periferisë veprojnë si faktorë shtytës për migrantët e jashtëm, me arsyen kryesore të shumicës së të rinjve, 56% të tyre, që zgjedhin të emigrojnë për shkak të standardeve më të mira të jetesës.

Figura-12. Lëvizja e lirë e akademikëve, studentëve dhe të diplomuarve (procesi i Bolonjës)



Shënim: Shtetet grupohen mbështetur në shifrat e tyre mesatare të lëvizshmërisë së studentëve si përqindje e të gjithë studentëve të brendshëm për periudhën 2000 – 2017. Burimi: UIS, 2017.

## 1.8 Ndikimi i imigracionit dhe imigracionit të kthimit në tregun e punës në Shqipëri gjatë COVID-19-ës

Pandemia COVID-19 ishte kriza e tretë ndërkombëtare që preku ekonominë shqiptare gjatë 14 viteve të fundit. Pandemia COVID-19 ka ushtruar ndikim mbi prirjet e migracionit nga dhe drejt Shqipërisë pas kufizimeve të lëvizjes të vendosura nga Shqipëria dhe vendet kryesore të destinacionit, por edhe për shkak të ndikimeve të menjëhershme në tregun shqiptar të punës, i cili pësoi shkurtime në shkallë të gjerë, rritje të nënpunësimit dhe shtim të informalitetit.

Sikurse raportohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë (MEFA), kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë janë të kufizuara në shërbimet publike të dedikuara për administrimin e formave të ndryshme të migracionit, përfshirë migracionin për motive punësimi. Përpara pandemisë, mbi një milionë shqiptarët që jetonin jashtë ndihmuan për uljen e trysnive të tregut të brendshëm të punës. Megjithatë, pas shpërthimit të COVID-19-ës, shumë emigrantë shqiptarë u detyruan të kthehen, pasi humbën vendet e punës ose përgjithmonë ose përkohësisht në vendet përkatëse të destinacionit, ose u përballën me shkurtime pagash. Për shembull, në muajt e verës të vitit 2020, Greqia vendosi kufizime të ashpra udhëtimi për shqiptarët, duke kufizuar numrin e përgjithshëm të shqiptarëve të pranuar në 750 veta në ditë, duke kërkuar teste negative për COVID-19-ën dhe duke vendosur një karantinë për të gjithë shqiptarët e pranuar. Kjo ndikoi rëndë mbi perspektivat e punësimit të mijëra punonjësve migrantë shqiptarë që zakonisht punojnë në sektorët e bujqësisë dhe turizmit në Greqi.

Ndërsa flukset e kthimit të qytetarëve në moshë pune në disa rrethana mund të çojnë në rritje të PBB-së për frymë, nëse mbështeten me sukses nga investimet publike, lëvizjet masive të kthimit të shqiptarëve në një kohë tkurrjeje ekonomike bënë që papunësia të rritet, duke çuar në rritjen e nivelit të papunësisë nga 11,5 % në vitin 2019 në 13,3 % në vitin 2020. Megjithatë, për shkak të përmasave të ekonomisë informale në Shqipëri, ka të ngjarë që ndikimi aktual i COVID-19-ës në tregun shqiptar të punës të jetë dukshëm edhe më i rëndë.

Megjithëse mungesat e fuqisë punëtore vazhduan në sektorë të caktuar të ekonomisë shqiptare gjatë gjithë pandemisë, ato u kufizuan kryesisht te vendet e lira të punës me kualifikim të ulët dhe gjysmë të kualifikuara në sektorët e bujqësisë dhe veshjeve. Megjithatë, migrantët shqiptarë të kthyer kanë mesatarisht nivele më të larta aftësish dhe, për rrjedhojë, prirjen të kenë aspirata për punë me kualifikim më të lartë dhe me pagesë më të lartë pas kthimit. Megjithëse kjo hipotezë nuk është e mbështetur nga të dhëna sasiore, mund të supozohet se përqindja e migrantëve shqiptarë të kthyer që hyjnë në profesione me vende të lira pune ishte shumë e kufizuar. Një ndikim i dytë i tërthortë i COVID-19-ës në tregun shqiptar të punës është se papunësia dhe ulja e pagave midis punonjësve migrantë shqiptarë jashtë vendit ka të ngjarë të kenë kontribuar për uljen e dërgesave të marra nga familjet shqiptare. Burime të ndryshme vlerësojnë se dërgesat përbëjnë 14-23% (Anketa e Pasurisë së Familjeve në Shqipëri, 2019; Banka e Shqipërisë, 2018) të të ardhurave të familjeve. Më e rëndësishmja, pothuajse një e katërta e familjeve shqiptare mbështeten tërësisht te dërgesat si burim i të ardhurave. Kjo do të thotë se humbja e të ardhurave për shkak të të mbeturit pa punë i një anëtari të familjes migrante prish drejtpërdrejt jetën ekonomike të një pjese të konsiderueshme të familjeve shqiptare.

Ndërkohë që efektet e krizës së COVID-19-ës në dërgesa nuk janë vlerësuar ende në mënyrë të besueshme, një raport i fundit i BERZH-it supozon se dërgesat ranë me pothuajse 20% në vitin 2020. Megjithatë, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e dërgesave ende transferohen përmes kanaleve informale, rënia aktuale e transfertave të huaja private mund të jenë dukshëm më e lartë. Duke qenë se norma e lartë e transfertave informale do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e flukseve të dërgesave mbetet “jashtë radarit” të Bankës së Shqipërisë, aktualisht nuk është e mundur të përcaktohet sa i madh është ndikimi i COVID-19-ës në vëllimet e dërgesave në vitin 2020 dhe 2021.

28. Kriza financiare e vitit 2008 detyroi shumë emigrantë shqiptarë të ktheheshin nga vendet e tyre të destinacionit, ku vendet kryesore pritëse Greqia dhe Italia u goditën veçanërisht fort nga kriza. Më shumë se 130.000 shqiptarë u larguan nga këto vende në periudhën 2009 - 2013 dhe u kthyen në Shqipëri. Gjatë krizës së refugjatëve në Evropë të vitit 2015, disa shqiptarë tentuan të aplikojnë për azil në vendet e BE-së. Megjithatë, pasi shumë shqiptarëve iu refuzuan kërkesat për azil nga vendet anëtare të BE-së, ata përjetuan mesatarisht kushte më të këqija jetese pas refuzimit. Vathi Z. & Zajmi I., 2017. Fëmijët dhe Migrimi në Shqipëri: Tendencat më të fundit dhe masat mbrojtëse të disponueshme. USAID, Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim, Terre des Hommes.

29. [https://www.ilo.org/budapest/countries-covered/albania/WCMS\\_461305/lang-en/index.htm](https://www.ilo.org/budapest/countries-covered/albania/WCMS_461305/lang-en/index.htm).

30. <https://www.infomigrants.net/fr/post/26683/coronavirus-albanian-migrant-workers-blocked-at-greek-border>.

31. Raporti i IOM-it, f. 106-107.

32. Gëdeshi, I., 2021. Si ndërveprojnë migracioni, kapitali njerëzor dhe tregu i punës në Shqipëri, S. I.: European Training Foundation.

33. <https://www.ebrd.com/where-we-are/albania/overview.html>

Ndarja e popullsisë në tre kategori moshe bazë është më e ashpër sa i përket menaxhimit të zhvillimit ekonomik dhe social. Prandaj, kërkohet një pasqyrë më e hollësishme për disa grupmosha "funktionale", veçanërisht në segmentet që kërkojnë më shumë vëmendje nga shoqëria, si fëmijët plus adoleshentët dhe të moshuarit. Grafikët e mëposhtëm ilustrjnë zhvillimin analog të numrit të fëmijëve dhe të rinjve të ndarë në grupmosha të veçanta duke iu referuar niveleve dhe fazave të ndryshme të arsimit, përgatitjes për punësim dhe/ose viteve fillestare në tregun e punës dhe jetës së tyre familjare (Fig. 44). Numri i të moshuarve në grupmoshat e mbivendosura duhet gjithashtu të pësojë ndryshime të ngjashme, por me orientim të kundërt (Fig. 45).

Figura-44. Shifrat fillestare dhe të pritshme të të rinjve sipas grupmoshave specifike, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëri, varianti mesatar





Figura-45. Shifrat fillestare dhe të pritshme të të moshuarve sipas grupmoshave specifike, 2020-2050 (deri më 31 dhjetor), Shqipëri, varianti mesatar



Në rastin e kontingjentit të fëmijëve dhe të rinjve në moshën e përgatitjes për punësim dhe nënkategorive të tyre, pritet një ulje unike në masën dhjetëra për qind. Madhësia e të gjithë kontingjentit të fëmijëve dhe adoleshentëve në moshën deri në 23 vjeç duhet të ulet nga 829 mijë kohët e fundit në më pak se 437 mijë persona në vitin 2050, pra me rreth 47 për qind. Në nivel të nëngrupeve individuale, rënia relative pritet në intervalin 44% - 50% në periudhën 2020-2050.

Ndër kategoritë e të moshuarve, qendra e masës do të zhvendoset nga të moshuarit më të rinj tek të moshuarit më të mëdhenj gjatë dekadave të ardhshme. Përqindja e të moshuarve (85 e lart) ndërmjet të moshuarve përfaqëson afërsisht 15% të këtij segmenti të popullsisë në fillim të periudhës së parashikimit sesa në vitin 2020. Pas 30 vjetësh, ajo duhet të rritet në rreth 35%. Një përqindje e ngjashme e të moshuarve të moshës së mesme (75-84 vjeç) duhet të rritet nga 23% në fillim në 29% rreth vitit 2038 dhe më pas të kthehet në 21% në vitin 2050. Pjesa e të moshuarve të rinj (65-74 vjeç) pritet të ulet nga 61% në vitin 2020 në 44% në vitin 2050. Një zhvillim i tillë duhet të vijë si rezultat i dinamikës së pabarabartë të nëngrupeve të të moshuarve. Numri i të moshuarve pritet të rritet pesëfish në raport me vlerën fillestare, të moshuarit e moshës së mesme në 2,2 herë dhe të moshuarve të rinj në 1,5 herë deri në vitin 2050.

Megjithatë, nuk do të jenë vetëm e gjithë popullsia apo të moshuarit që do të plaken. Edhe popullsia në moshë pune ka gjithashtu të ngjarë të plaket. Në 30 vjet, mosha mesatare e saj duhet të rritet nga 41.7 në 46 vjeç. Zhvillimi i nën-popullsisë në moshën para produktivitetit dhe të punës ndoshta nuk do të detyrojë shpenzime shtesë sociale. Megjithatë, kjo nuk zbatohet në asnjë mënyrë mbi ndryshimet e pritshme në skajin tjetër të piramidës së moshës. Rritja e numrit të të moshuarve do të shkaktojë një rritje të ndjeshme të të drejtave për pensione dhe kujdes shëndetësor me fonde të buxheteve publike.

## 2.5 Potenciali i migracionit të brendshëm dhe migracionit të kthimit për të balancuar tendencën neto të migracionit në Shqipëri


Ndërsa ulja e konsiderueshme e emigracionit në kulmin e krizës së COVID-19-ës në vitin 2020 nënkuptonte që migrimi neto u zvogëlua përkohësisht në -16 700 individë, migracioni i jashtëm u rikuperua shumë më shpejt në vitin 2021 sesa imigracioni, duke çuar në një normë të vlerësuar neto të migracionit prej gati 33,000 vetash që u larguan nga Shqipëria në vitin 2021 (shih Figurën 46).

Figura-46. Migracioni neto, numri i migrantëve në vit, 2011-2021



Edhe migracioni vjetor i jashtëm gjatë periudhës 2011-2021 u ngadalësua, ndonëse me një ritëm më të moderuar se flukset e imigracionit (shih Grafikonin 26). Në periudhën 2014-2019 diferenca midis numrit të migrantëve dhe numrit të emigrantëve prodhoi një normë negative migrimi prej -70,000 vetash.

Tabela-26. Numri i imigrantëve ndërkombëtarë dhe migrantëve të jashtëm, sipas vitit, dhe tendencat e rregulluara të normës së rritjes vjetore, 2011-2021



Shumica dërrmuese e imigrantëve në Shqipëri janë migrantë të kthyer, siç është tipike për një vend që përjeton migracion të jashtëm të vazhdueshëm neto. Përqindja e vlerësuar e të kthyerve ndërmjet imigrantëve është 98,2 për qind, sikurse është përcaktuar në Anketën Kombëtare të Migracionit të Familjeve, të botuar në vitin 2020. Disa të kthyer kanë qëndruar jashtë vendit vetëm për një kohë të shkurtër (p.sh. punonjës me kontratë dhe studentë) dhe mund të emigrojnë sërish në periudhën afatmesme. Megjithatë, migrantët e tjerë shqiptarë priren të qëndrojnë jashtë vendit për periudha më të gjata përpara se të kthehen në vendin e tyre (p.sh. migrantë afatgjatë me kontrata të përhershme punësimi, pensionistët). Shumica e emigrantëve të kthyer kthehen nga Greqia, Italia dhe Gjermania, që përfaqësojnë vendet kyçe të destinacionit të ish-grupeve të migrantëve shqiptarë. Duke pasqyruar tendencat e mëparshme të migrimit jashtë, mbi dy të tretat (64%) e të kthyerve janë meshkuj dhe nga mosha 20 deri në 60 vjeç, ku shumica e të kthyerve i përkasin grupmoshës 25-44 vjeç.

Migrimi i kthimit mbetet një variabël që është i vështirë të modelohet sipas parimeve tradicionale të levizshmërisë. Nga njëra anë, stimujt për kthim varen nga politikat shqiptare, të tilla si politika industriale që në një ekonomi të tregut të lirë kontribuon për përcaktimin e shkallës tërheqëse të pagave dhe primet e pagave; mekanizmat dhe skemat e njohjes së aftësive për të kthyerit për të vlerësuar mundësinë e tyre për t'u integruar ose riintegruar në ekonominë shqiptare; stimujt për qarkullimin e trurit.

Nga ana tjetër, migrimi i kthimit ndikohet nga faktorë që janë jashtë kontrollit të politikëbërësve shqiptarë dhe, duke qenë kështu, varen nga rrethanat në vendin e destinacionit. Faktorët kryesorë janë politikat e migracionit (skemat e vizave afatgjata kundrejt atyre afatshkurtra), perspektivat e integrimit të emigrantëve shqiptarë, ndryshimet në diferencat e pagave midis tregut shqiptar të punës dhe tregut të vendeve kryesore të destinacionit.

Një model që ndikon në kontekstin shqiptar dhe atë të pjesës tjetër të botës është jo vetëm teknikisht i vështirë për t'u imagjinuar, por ka shumë të ngjarë të jetë me përdorim të kufizuar. Në fakt, praktikata më të mira të vendeve të origjinës të tilla si India sugjerojnë se politikat për të tërhequr ose dekurajuar kthimet janë më efektive në nivelin e korridorit dypalësh. Sistemi i nxitjes për të inkurajimin e kthimit shpesh promovohet fillimisht ndërmjet vendeve dhe më shpesh edhe për profilet profesionale për të cilat njohja e aftësive është jo vetëm e realizueshme, por edhe fitimprurëse për palët, në rastin e Shqipërisë për vendin e origjinës.

Duke e kthyer vëmendjen tonë te migracioni ndërkombëtar, ne mbështetemi te parashikimet tradicionale të levizshmërisë, si ato të zhvilluara nga Kucera (2022). Flukset e parashikuara të migracionit sugjerojnë që migrimi neto mund të bëhet neutral që në vitin 2031, i pasuar nga një rritje graduale e migracionit neto pozitiv (Grafiku 27).


37. <https://albania.iom.int/resources/national-household-migration-survey-albania-0>.

38. Raport i IOM-it.

Migrimi i kthimit dhe migrimi i brendshëm i të huajve në Shqipëri nuk do të kompensojë uljen e shkaktuar nga migrimi i jashtëm së shpejti. Nëse është e vërtetë që flukset e migracionit zor se varen nga parashikimet tradicionale të lëvizshmërisë, vlerat e parashikuara që balancojnë në mënyrë sasiore tendencat e ardhshme neto të migracionit sipas Kucera-s (2022) nuk ka të ngjarë të pasqyrojnë një ekuilibër të qartë në një treg pune që mbetet shumë i segmentuar, që karakterizohet nga fenomene të papunësisë së njerëzve në moshën e punës, si dhe nga mospërputhjet e aftësive të raportuara nga punëdhënësit vendas dhe të huaj.

Ndërsa shumica e migrantëve ndërkombëtarë, duke qenë migrantë të punës, angazhohen në mënyrë aktive në tregun shqiptar të punës, kjo nuk është e vërtetë për popullsinë shumë më të madhe të migrantëve të kthyer. Në të vërtetë, 50% deri në 60% e migrantëve të kthyer e gjejnë veten të papunë pas kthimit në Shqipëri dhe duke rritur kështu shkallën e papunësisë.

**Grafiku-27. Parashikimet e nivelit të migracionit neto të papërpunuar (deri në vitin 2050)**



Ndërkohë që papunësia midis migrantëve të kthyer zvogëlohet me kalimin e kohës, pasi individët po dalin gradualisht nga moshja e punës ose po emigrojnë sërish, shkalla e papunësisë midis të kthyerve mbetet megjithatë më e lartë se ajo e popullsisë që nuk ka emigruar.

## 2.6 Përfundime

Parashikimi i paraqitur më sipër nuk është rezultat i studimit tonë të dorës së parë mbi zhvillimin e popullsisë së Shqipërisë. Megjithatë, ai përmban një sasi relativisht të vogël të njohurive të akumuluarra specifike për vendin mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit të popullsisë. Për më tepër, njohja e hollësishme dhe sistematike e të gjithë riprodhimit të popullsisë në vend, në përgjithësi, është vetëm në fillesat e saj.

Të dhënat e statistikave demografike të ofruara nga INSTAT-i na mbështetën për të hartuar këtë raport. Analizat e të dhënave nuk kanë zbuluar ndonjë shqetësim kryesor në rregullsitë strukturore dhe zhvillimore.

Rezultatet e analizave të riprodhimit të popullsisë së Shqipërisë bazuar në njohuritë teorike tregojnë si më poshtë:

- Fertiliteti i përgjithshëm shfaq vlera të ulëta që i përkasin zonës së etiketuar në demografi si zona me fertilitetin më të ulët të ulët. Ato janë më tepër luhatëse sesa tregojnë ndonjë tendencë të qartë gjatë viteve të fundit. Kjo situatë reflekton pjesërisht shtyrjen relativisht dinamike të të bërit prindër, duke çuar në të ashtuquajturën plakje të fertilitetit gjatë viteve të fundit. Plakja e fertilitetit ndoshta nuk ka arritur ende kulmin e saj në pragun e parashikimit, por moshja mesatare e nënave në lindje është tashmë relativisht e lartë dhe duhet të ndalet ose të ngadalësohet ndjeshëm së shpejti. Niveli i përgjithshëm i fertilitetit nuk duhet të

39. IOM (raport që pritet të botohet). Forcimi i kuadrit të migracionit për motive punësimi në Shqipëri. Vlerësimi i kornizave të mobilitetit të punës dhe ndikimi i tyre në lëvizshmërinë e migrantëve shqiptarë për motive punësimi.

- ndryshojë ndjeshëm. Të paktën, nuk kemi gjetur ndonjë arsye të rëndësishme për një zhvillim të ngjashëm.
- Intensiteti i vdekshmërisë është ulur gjatë njëzet viteve të fundit deri në shpërthimin e pandemisë COVID-19. Një rritje drastike e vdekshmërisë u vu re në vitin 2020 dhe me të drejtë pritet edhe në vitin 2021. Pandemitë ka të ngjarë të jenë një episod i rastësishëm, por i veçantë në zhvillimet afatgjata të vdekshmërisë, i shprehur në një rënie të theksuar të jetëgjatësisë. Kompensimi për këtë rënie të thellë ndoshta do të jetë një proces afatmesëm që do të zgjasë edhe rreth një dekadë, në varësi të shkallës dhe strukturës së pasojave dytësore të COVID-19-ës në shëndetin e popullatës. Më pas, ulja e vdekshmërisë duhet të vazhdojë në përputhje me tendencën para COVID-19-ës, dhe gjatësia mesatare e jetës së femrave dhe meshkujve duhet të rritet në përputhje me rrethanat. Kjo rritje e jetëgjatësisë në lindje duhet të mbetet e konsiderueshme, por, në të njëjtën kohë, duhet të humbasë ngadalë dinamikën e saj.
- Vëllimet e migrimit përtej kufijve të Shqipërisë me shumë gjasa do të ulen për shkak të rënies së madhësisë së popullsisë dhe plakjes, kryesisht për shkak të gjithnjë e më pak grupeve të reja, të cilët përbëjnë thelbin e migrantëve të mundshëm. Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit, veçanërisht i lidhur me ripërcaktimin e pritshëm të marrëdhënieve të prodhimit territorial të vendeve të zhvilluara evropiane, mund të luajë një rol pozitiv në këtë drejtim. Ndikimi demografik i migracionit, i cili aktualisht është më i rëndësishëm se ndikimi i ndryshimeve natyrore, të paktën në aspektin e zhvillimit të numrit të përgjithshëm të popullsisë, padyshim që do të zbehet. Arsyeja nuk është vetëm zvogëlimi i njëpasnjëshëm i përmendur i vëllimeve të migrimit, por edhe rritja e ndjeshme e deficitit të ndryshimeve natyrore (teprica e vdekjeve në krahasim me lindjet). Në përmbledhje, migrimi ka një mundësi të mbetet në pozicionin e komponentit më të rëndësishëm vetëm gjatë viteve të para të periudhës së parashikimit. Herët a vonë, afërsisht brenda dhjetë viteve, bilanci i ndryshimeve natyrore duhet të tejkalojë numrin e balancës së migracionit dhe të bëhet komponenti kryesor i riprodhimit.
- Dalja e mëtejshme e konsiderueshme e të rinjve në të tretën e parë të periudhës së parashikimit do të dekretojë popullsinë dhe plakjen e popullsisë së Shqipërisë.

Duke marrë parasysh këto gjetje dhe pritshmëri, është e dukshme se ndryshimet më të mundshme në madhësinë dhe strukturën e moshës-gjinisë së popullsisë së Shqipërisë duhet të kenë pasoja të gjera, duke prekur pothuajse çdo aspekt të jetës së shoqërisë. Këto ndryshime padyshim që do të prekin fushat thelbësore të interesit publik të tilla si, për shembull, financat publike, sigurimet dhe asistencën sociale, sistemin shëndetësor publik dhe tregun e punës. Për më tepër, ndikimet e zhvillimit demografik mbi këta sektorë janë të ndërlydhura. Zakonisht, situata në një zonë ushtron ndikim të ndjeshëm në gjendjen e zonave të tjera dhe anasjelltas.

Plakja e shpejtë e popullsisë po ngre çështjen e qëndrueshmërisë së sistemit aktual të pensioneve. Do të jetë një nga çështjet kritike për t'u zgjidhur brenda kontekstit të zhvillimit të supozuar të popullsisë. Pothuajse dyfishimi i përqindjes së të moshuarve në popullatë brenda tre dekadave të ardhshme dhe mbijetesat më të shpeshtë në moshat e mëdha do të çojnë gjithashtu në kërkesë të lartë për shërbime shëndetësore dhe sociale. Këta dy faktorë do të ushtrorjnë presion mbi rritjen e shpenzimeve për shëndetin publik, do të ndryshojnë strukturën e brendshme moshë-seks të pensionistëve, madhësinë e familjeve, si dhe vëllimin dhe strukturën e shpenzimeve të tyre.

Popullsia në moshë produktive që përfaqëson fuqinë punëtore të mundshme, pa dyshim, do të bjerë në mënyrë dinamike dhe do të plakët njëkohësisht gjatë periudhës së parashikimit. Këto ndryshime do të dobësojnë kërkesën për vende pune dhe potencialin e punës së popullsisë, duke ngritur kështu shqetësimin e publikut për zhvillimin e ardhshëm të popullsisë së Shqipërisë.

Për t'i përmbledhur gjetjet kryesore të këtij studimi, mund të thuhet se është thelbësore të fillohet të veprohet në përputhje me rrethanat dhe të studiohet e ardhmja demografike dhe kontekstet e saj në mënyrë sistematike dhe me hollësi më të thella gjatë zhvillimit të politikave. Vetëm një studim kaq i hollësishëm dhe sistematik bën të mundur të identifikohen dhe vlerësohen plotësisht perspektivat e popullsisë, pasojat e mundshme të zhvillimit të popullsisë dhe mundësia e shmangies ose zbutjes së zhvillimeve të pafavorshme. Vetëm masat praktike dhe efikase të politikave të bazuara në politika sektoriale të mbështetura në të dhëna mund të sjellin rezultate të rëndësishme. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të kujtojmë argumentimin në pjesën hyrëse të këtij raporti dhe të kujtojmë se parashikimet e popullsisë dhe rezultatet e modelit të parashikimit duhet të luajnë një rol thelbësor për hartimin, miratimin dhe monitorimin e politikave të tilla.

# PJESA III - REKOMANDIMET E LIDHURA ME POLITIKAT

Kjo pjesë e raportit paraqet një sërë çështjesh që duhet të merren parasysh nga politikëbërësit gjatë cikleve të ardhshme të programimit. Më konkretisht, ato prekin modelin e rritjes, varësinë e tij nga dinamika migratore dhe opsionet e politikave ose për të zvogëluar këto varësi, ose për t'i menaxhuar ato në mënyrë të sigurt dhe të rregullt. Ajo përmban implikime politikash që etiketojnë veçanërisht ministritë përgjegjëse për çështjet e punësimit, punës dhe çështjeve sociale, duke trajtuar pengesat e ofertës dhe kërkesës për punësim, të cilat mund të zvogëlojnë flukset hyrëse migratore të nevojshme për të zëvendësuar flukset e pritshme të migrantëve jashtë Shqipërisë gjatë 15 viteve të ardhshme, duke mbajtur gjërat e tjera konstante.

## **3.1 Alternativat e politikave publike ekzistuese për të trajtuar ndryshimet e parashikuara demografike që sigurojnë ofertë të mjaftueshme të forcës së punës në tregun shqiptar të punës, duke marrë parasysh qasjen e politikave me ndjeshmëri gjinore dhe të drejtat e mbrojtjen e punonjësve (migrantë)**

Shqipëria po përballet me një situatë që karakterizohet nga një ekonomi që jo vetëm rritet, por krijon edhe vende pune. Hyrja në tregun e punës që mbështet si punësimin e brendshëm ashtu edhe emigracionin do të zvogëlohet sa i takon tkurrjes së fuqisë punëtore në krahasim me një dekadë më parë.

Kjo situatë është kaluar nga shumica e vendeve që kanë hyrë në këtë fazë të tranzicionit demografik, një fazë e zhvillimit ekonomik që kërkonte një fuqi punëtore të shtuar dhe më të kualifikuar.

Ndryshe nga vendet e tjera që janë përballur me këtë emergjencë, modeli socio-ekonomik i Shqipërisë ishte dhe është ende i rrënjësuar shumë në emigracionin jashtë vendit dhe përfitimet e tij, të tilla si dërgesat, lehtësimin e presioneve të papunësisë, kthimet qarkulluese të migrantëve me kualifikim të lartë. Nga ana tjetër, punësimi i brendshëm u rrit në dekadën e fundit së bashku me uljen e papunësisë, duke treguar shenja se shqiptarët jo vetëm kërkojnë perspektiva më të mira jashtë vendit, por ata mbështesin me punën e tyre edhe zgjerimin e brendshëm ekonomik.

Një aspekt tjetër që e dallon Shqipërinë është mungesa e konkurrueshmërisë së pagave të saj në kontekstin e afërsisë gjeografike me tregjet e punës të BE-së me paga të larta, mbulimi i mirë i institucioneve të tregut të punës, kërkesa të larta për punonjës migrantë ndërkombëtarë dhe politika në zhvillim që mbështesin efektivisht rekrutimin ndërkombëtar. Në thelb, kjo do të thotë se punëdhënësit shqiptarë tashmë përballen, dhe do të vazhdojnë të përballen në të ardhmen e parashikueshme, me sfida serioze sa i takon tërheqjes së fuqisë punëtore të ulët dhe gjysmë të kualifikuar për të plotësuar mungesat në rritje të fuqisë punëtore.

Cilat janë alternativat e politikave për të trajtuar dhe luftuar këtë mungesë ekuilibri? Së pari, rritja e produktivitetit të ekonomisë në tërësi për të kërkuar më pak punonjës për të njëjtin nivel prodhimi. Së dyti, lidhja e produktivitetit me pagat në mënyrë të tillë që puna të paguhet në nivelet e duhura në Shqipëri duke e bërë tregun e saj të punës tërheqës; kjo masë duhet të çojë në promovimin e migracionit të kthimit dhe të zvogëlojë stimujt për migracionin jashtë, i cili është më shumë përgjegjës për ikjen e trurit. Së treti, përmirësimi i sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të migracionit, duke faktorizuar siç duhet emigracionin dhe kompensimin (potencial) të tij përmes kthimit dhe migracionit të brendshëm, si variable të fuqishme që ndikojnë mbi tregun e punës dhe strukturën e fuqisë punëtore, vendase dhe të huaj, në Shqipëri.

Duke shkuar drejt opsioneve të politikave që japin rezultate gjatë dy dekadave e më tej, është e rëndësishme të përmenden gjithashtu politikat demografike dhe sociale që rrisin fertilitetin.

*Modeli i rritjes ekonomike përcakton përfundimisht vendet e punës që sistemi ekonomik shqiptar do të vërë në dispozicion në të ardhmen. Në situatën e rritjes së ndarjes ndërmjet punonjësve të kërkuar nga ekonomia dhe fuqisë punëtore të disponueshme, politikëbërësit shqiptarë duhet të krijojnë stimuj për t'u larguar nga prodhimi dhe bujqësia*



që kërkojnë punësim intensiv, të cilat lidhen me produktivitetin e ulët dhe, rrjedhimisht, paga më të ulëta dhe kërkesa më të ulëta për aftësi, dhe të shkojnë më shumë të përgjithësi drejt aktiviteteve me produktivitet të lartë.

Politikat industriale që rrisin produktivitetin do të ulen në nivel sektorial. Për sektorin e bujqësisë, *shtyja strategjike duhet të jetë nxitja e mekanizimit me kapital intensiv të aktiviteteve bujqësore. Paralelisht, masat për orientimin e sektorit të shërbimeve nga ekonomia vendase te shërbimet ndërkombëtare mund të jenë një përbërës i një përzierje politikash për të rritur vlerën e shtuar në sektorin e shërbimeve.*

Shtylla e dytë e politikave lidhet me produktivitetin e pagave. Kjo kërkon masa për të zgjeruar mbulimin me legjislacion për mbrojtjen e punësimit nëpërmjet stimuljve për aktivitete ekonomike që kanë më shumë gjasa të përfshijnë marrëveshje formale punësimi. Mekanizmat e fiksimit të pagave në nivel sektorial duhet të kontribuojnë për mbajtjen e punonjësve të kualifikuar dhe në fund për tërheqjen e tyre nga tregu ndërkombëtar i rekrutimit. Politikat e produktivitetit të përmendura në shtyllën e parë dhe të dytë janë parakusht për efektivitetin e reformës së sistemit të migracionit. Së pari, një sistem informacioni për tregun e punës për punën dhe migracionin duhet të informojë politikëbërësit për kualifikimet dhe aftësitë e migrantëve të brendshëm aktualë në tregun shqiptar të punës. Së dyti, diversifikimi i të njëjtit sistemi duhet t'u lejojë këshillave dhe shoqatave sektoriale të planifikojnë dhe rekrutojnë segmente të ndryshme të migrantëve të brendshëm në bazë të njoftimeve për vendet e lira të punës dhe ndoshta testimet e tregut të punës për të shmangur konkurrencën me të papunët vendas. Sistemi mund dhe duhet të plotësohet me marrëveshje dypalëshe pune që përfshijnë aspekte të zhvillimit të aftësive në bazë të informacionit të marrë nga punëdhënësit shqiptarë.

Së fundi, në kuadrin më afatgjatë, politikëbërësit shqiptarë duhet të eksplorojnë opsionet e politikave demografike dhe sociale që ofrojnë stimuj për familjet me fëmijë, ndërkohë që sigurojnë kanale për gratë që të rihyjnë në tregun e punës pas periudhave të fertilitetit. Pika e fundit ruan rezultate pozitive gjinore dhe të punësimit të cilat janë të pranishme në kuadrin afatshkurtër.

### **3.2 Ndikimi i migracionit mbi qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimeve shoqërore në skenarët e propozuar**

Skenarët e mundshëm të popullsisë (Kucera, 2022) të vlerësuar së bashku me njohuritë nga zhvillimi i tregut të punës të paraqitura në këtë studim ofrojnë njohuri për menaxhimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.

Alternativa e parë e vlefshme e politikave vërtitet rreth kompromisit midis zgjatjes së moshës së pensionit, që prek kryesisht punësimin në sektorin publik dhe shkallës në të cilën kjo zgjatje do të ngadalësojë hyrjet e punonjësve të rinj në tregun e punës. Nga njëra anë, mbajtja e punonjësve të moshuar në tregun e punës do të lehtësojë faturën e pensioneve që do të paguhet nga qeveria në çdo vit të caktuar. Nga ana tjetër, pavarësisht shkallës në rënie të grupeve të të rinjve, vonesa për zëvendësimin e punonjësve zakonisht ka ndikime negative mbi produktivitetin.

Politika e migracionit hyn në ekuacion duke mbështetur kontributin e përgjithshëm të punonjësve aktualë në sistemin e sigurimeve shoqërore. Duke qenë se Shqipëria ka hyrë rishtazi në nivelin e vendeve të destinacionit për migracionin për motive punësimi, ky kontribut është ende i papërfillshëm. Në skenarin më optimist, aktualisht vetëm 20 mijë punonjës të huaj janë të angazhuar në ekonominë shqiptare. Ky numër duhet të korrigjohet duke përfshirë personat që nuk mbulohej nga marrëveshja formale e punësimit dhe, si rrjedhim, nuk paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore.

Sikurse theksohet edhe nga Kucera, është e vështirë të bëhen parashikime sasiore për variablin e stokut të migrantëve të brendshëm në Shqipëri, i cili, sipas përkufizimit, nuk varet nga korridori i migracionit dhe ndryshon në bazë të kapacitetit të mundshëm të tregut të punës për të tërhequr migrantë dhe ndryshimet e përcaktuara nga shteti për sistemin e imigracionit (2022). Piku prej 23,900 migrantësh të brendshëm i parashikuar për vitin 2026 nuk është i mjaftueshëm për të luajtur një rol për kompensimin e mungesës së ekuilibrit midis brezave që dalin jashtë, të cilat do të rriten më shumë se përpjesëtimisht krahasuar hyrjet.

Ekzistojnë tri mënyra të tjera që qeveria shqiptare mund dhe duhet t'i përdorë për të mbajtur nën kontroll bilancet e sigurimeve shoqërore. Ato lidhen me rritjen e produktivitetit dhe zgjerimin e sektorëve më me gjasa për të nxitur punësimin formal. E para ka të bëjë me tërheqjen e të kthyerve në moshë pune në tregun kombëtar të punës dhe që ka mundësi të sjellin me vete kontribute përmes marrëveshjeve të transferueshmërisë me vendet

e destinacionit. E dyta lidhet me rritjen e aktiviteteve të reja ekonomike në sektorë ku punëdhënësit janë shumë të mëdhenj për të mos u mbrojtur nga legjislacioni për mbrojtjen e punësimit që vepron jashtë sektorit formal. E treta ka të bëjë me negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja të kontributeve të sigurimeve shoqërore me vendet kyçe të destinacionit, pasi, në vitin 2017, marrëveshje të tilla u kufizuan vetëm në katër shtete që mbulojnë stokun masiv të emigrantëve shqiptarë: Belgjikë, Republika Çeke, Rumania dhe Turqia.

### 3.3 Mësimet që mund të nxirren nga përvoja e shteteve të ngjashme me Shqipërinë sa i takon trajtimin të rrjedhjes së trurit dhe nxitjes së qarkullimit të trurit

Mësimet e nxjerra nga përvoja e vendeve të ngjashme me Shqipërinë, pra vendeve që kanë parë një migracion të vazhdueshëm negativ neto, sugjerojnë se duhen identifikuar shkaqet e rrjedhjes së trurit dhe duhet të hartohen strategjitë e përshtatshme përkatëse, të tilla si skemat e qarkullimit të trurit, në nivele nënsektoriale, madje, edhe në nivel profesionesh.

Një vend destinacioni, i cili mund të duket shumë premtues duke marrë parasysh kritere të tilla si pagat, kushtet e punës dhe kushtet e jetesës, në fund mund të mos jetë korridori i përshtatshëm strategjik, pasi vendet e lira të punës përqendrohen te disa sektorë ose profesione që qeveria e Shqipërisë mund të mos dëshirojë t'i promovojë. *Për shembull, nga këndvështrimi i Shqipërisë, ndalimet profesionale mund të frenojnë migracionin jashtë vendit në destinacione të caktuara ose për profesione specifike që konsiderohen të papërshtatshme ose jo strategjike.* Një shembull i cituar gjerësisht në literaturë është ndalimi i punonjësve të shtëpisë nga Filipinet, i cili synon të pengojë migracionin e jashtëm në një sektor, pra, në sektorin e punëve të shtëpisë, që nuk konsiderohet më strategjik. Situatat emergjente mund të shkaktojnë arsye të tjera për zbatimin e ndalimeve profesionale.

Bota në situatën e COVID-19-ës mund të krijojë skenarë ku vendet e origjinës dëshirojnë të vendosin ndalime specifike të përkohshme. Për shembull, aftësitë për të prodhuar mallra të caktuara, të tilla si ventilatorë për Njësitë e Kujdesit Intensiv, të cilat ishin më parë të disponueshëm në tregun ndërkombëtar, mund të konsiderohen thelbësore për arsye të shëndetit publik kombëtar, duke nxitur kështu qeveritë të krijojnë një ndalim të përkohshëm ose të përhershëm për migrimin e individëve që kanë aftësitë e nevojshme për të prodhuar ventilatorët. Ndalimet profesionale janë përgjithësisht të vështira për t'u zbatuar, veçanërisht në Evropë, ku parimet e lëvizjes së lirë janë të papajtueshme me skemat e vizave të daljes që janë në fuqi me vendet që zbatojnë ndalime të tilla.

Sa u përket skemave të qarkullimit të trurit, stimujt e lëvizshmërisë së Shqipërisë duhet të shoqërohen me politika industriale, në mënyrë të tillë që zhvendosjet e proceseve të prodhimit në Evropën kontinentale të përmbushin aftësitë e fituara nga të kthyerit e mundshëm, që kanë punuar në profesione të kualifikuara prodhuese jashtë vendit. *Kjo kërkon qasje koherente të politikave ku modeli i aftësive të sjella me vete nga të kthyerit të plotësojë politikat për të tërhequr investime të huaja të drejtpërdrejta dhe investime publike, përfshi vendet e gjelbra punës.* Shembulli i Italisë është një rast i tillë. Plani Kombëtar i Rimëkëmbjes dhe Rezistencës është krijuar nga ideja e modernizimit të strukturës së ekonomisë dhe të shoqërisë sipas parimeve të ekonomisë së gjelbër. Për investime publike përdoren të papunët e rikualifikuar, së bashku me të kthyerit e tërhequr nga vendet e punës në ekonominë e gjelbër. Komponenti i fundit i lëvizshmërisë është shtylla kryesore e partneritetit publik-privat të prezantuar nga ENEA Tech (një fondacion i krijuar nga ENI), për të zbatuar transferimet e teknologjisë në sektorë novatorë, duke përdorur stimujt për qarkullimin e trurit. Stimujt e qarkullimit të trurit përfshijnë pagat konkurruese, si dhe heqjen dorë nga tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që duhet të paguhen nga i kthyeri. *Një skemë e ngjashme mund të miratohet nga politikëbërësit shqiptarë, e kombinuar me një fushatë informuese ndërmjet komuniteteve të diasporës në vendet e destinacionit në kufirin teknologjik dhe të ekonomisë së gjelbër.*

40. Van Panhuys, C., Aoul, S. K., & Binette, G. (2017). Migrant access to social protection under Bilateral Labour Agreements a review of 120 countries and nine bilateral arrangements. ILO Working Papers, (994955792602676). [https://www.socialsecurity.be/CMS/en/coming\\_to\\_belgium/convention/FODSZ\\_Convention\\_Albania](https://www.socialsecurity.be/CMS/en/coming_to_belgium/convention/FODSZ_Convention_Albania).

# BIBLIOGRAFIA

- Acosta, P. A., Lartey, E. K., & Mandelman, F. S. (2009). Remittances and the Dutch disease. *Journal of international economics*, 79(1), 102-116.
- Bhaumik SK, Dimova R (2013) Does human capital endowment of foreign direct investment recipient countries really matter? Evidence from cross-country firm level data. *Rev Dev Econ* 17(3):559–570
- Bratsberg, B. (1995). The incidence of non-return among foreign students in the United States. *Economics of Education Review*, 14(4), 373–384. [https://doi.org/10.1016/0272-7757\(95\)00017-E](https://doi.org/10.1016/0272-7757(95)00017-E)
- Borjas, G. J. (1992). Ethnic capital and intergenerational mobility. *The Quarterly journal of economics*, 107(1), 123-150.
- Clemens, M. A., & McKenzie, D. (2018). WHY DON ' T REMITTANCES APPEAR TO AFFECT GROWTH ? *The Economic Journal*, 128. <https://doi.org/10.1111/econj.12463>
- Cervantes, M., & Guellec, D. (2002). The brain drain : Old myths , new realities (No. 230; The OECD Observer).
- Commander, S., Kangasniemi, M., & Winters, A. (2004). The Brain Drain: Curse or Boon? A Survey of the Literature. In R. Baldwin & A. Winters (Eds.), *Challenges to Globalization* (pp. 235–278). University of Chicago Press.
- Carrington, W. J., & Detragiache, E. (1998). How big is the brain drain?. Available at SSRN 882624.
- Collier, P. (2013). *Exodus. How Migration Is Changing Our World*. Oxford University Press
- EU, & OECD. (2016). *Recruiting Immigrant Workers: Europe* (O. Publishing (Ed.)). <https://doi.org/10.1787/9789264257290-en>
- Eurostudent. (2017). Students' assessment of their preparedness for employment on the labour market. In Eurostudent VI. Retrieved from <http://database.eurostudent.eu/>
- Eurostat Database (2020), Immigration by age group, sex and citizenship (migr\_emi1ctz): Retrieved from [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_emi1ctz&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_emi1ctz&lang=en)
- Eurostat. (2022). Mobility in Europe. Retrieved August 1, 2022, from <http://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/tps00064>
- Eurostat. (2021). EU Labour Force Survey, 2018. Retrieved from <https://ec.europa.eu/eurostat/web/microdata/european-union-labour-force-survey>
- EU. (2014). Tuition Fees around Europe. In European Youth Portal. Retrieved from [https://europa.eu/youth/eu/article/53/21134\\_en](https://europa.eu/youth/eu/article/53/21134_en)
- Faini, R. (2003). The brain drain : an unmitigated blessing ? (Issue September).
- IFAD. (2017). Sending Money Home. Retrieved from <https://www.ifad.org/documents/36783902/4a5640d9-e944-4a8c-8007-a1bc461416e6>
- IOM (2020). Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri accessed through [http://www.instat.gov.al/media/7969/zhvillimi\\_i\\_anket%C3%ABs\\_komb%C3%ABtare\\_t%C3%AB\\_migracionit\\_n%C3%AB\\_familje\\_alb.pdf](http://www.instat.gov.al/media/7969/zhvillimi_i_anket%C3%ABs_komb%C3%ABtare_t%C3%AB_migracionit_n%C3%AB_familje_alb.pdf)

IOM (2022). Strengthening Labour Migration Framework in Albania. Assessment of labour Mobility Frameworks and their impact on the mobility of Albanian labour migrants.

INSTAT (2022a), Labour Force Survey. Quarterly indicators of labour market 2012-1 - 2022-2 . Retrieved from [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START\\_\\_TP\\_\\_LFS\\_\\_LFSQ/NewLFSQ014/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START__TP__LFS__LFSQ/NewLFSQ014/)

INSTAT (2022b), Labour Force Survey. Quarterly indicators by prefectures for age 15 and older 2016-1 - 2022-2. Retrieved from [http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START\\_\\_TP\\_\\_LFS\\_\\_LFSQ/NewLFSQ003/](http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/START__TP__LFS__LFSQ/NewLFSQ003/)

INSTAT (2022c). Quarterly Labour Force Survey retrieved from <http://www.instat.gov.al/media/10487/lfs-q2-2022.pdf>

INSTAT (2022d) Migration and migrant integration. Retrieved from <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/migration-and-migrant-integration/>

INSTAT (2022e) Datasets provided to the research team.

Holmes, S., & Krastev, I. (2020). *The Light that Failed*. Simon and Schuster.

Kamberi & Cela (2019). *Youth Study Albania 2018-2019*. FES: Tirana

King, R. & Gedeshi, I. (2020). *The actual and potential migration of students from Albania: a putative brain drain?* Tirana: FES Albania

Kheng, V., Sun, S., & Anwar, S. (2017). Foreign direct investment and human capital in developing countries: a panel data approach. *Economic Change and Restructuring*, 50(4), 341–365. <https://doi.org/10.1007/s10644-016-9191-0>  
Lucas, R. E. (2005). *International migration and economic development: Lessons from low-income countries*. Edward Elgar Publishing.

Mayr, K., & Peri, G. (2009). Brain drain and brain return: theory and application to Eastern-Western Europe. *The BE Journal of Economic Analysis & Policy*, 9(1).

MASR (2021). *Strategjia kombetare e arsimit 2021-2026*. UNICEF:Tirana

Miyamoto, K. (2003). Human capital formation and foreign direct investment in developing countries. Working paper No.211 <http://www.oecd.org/dev/5888700.pdf>

Nedeljkovic, V. (2014). Brain Drain in the European Union : Bridging Europe, 1–11

OECD. (1997). *Education at a Glance*. Retrieved from <http://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/39313286.pdf>

OECD. (2012). *Education at a Glance*. Retrieved from <https://www.oecd.org/education/highlights.pdf>

OECD-UNDESA. (2013). *World migration in figures*. *World Migration in Figures*, October, 1–6. <http://www.oecd.org/els/mig/World-Migration-in-Figures.pdf>

Qendresa Qytetare (2020). *Vleresimi I situates se arsimit te larte nen ndikimin e COVID-19*. Retrieved from <https://citizens-channel.com/2020/04/21/studimi-studentet-mbeten-te-perjashtuar-nga-mesimi-online-dhe-shtyrja-e-qirave-gjate-krizes-se-covid-19/>

Saxenian, A. (2002). Brain Circulation: How High-Skill Immigration Makes Everyone Better Off. *The Brookings Review*, 20(1), 28–31.

Stark, O., Helmenstein, C., & Prskawetz, A. (1997). A brain gain with a brain drain. *Economics letters*, 55(2), 227-234.

Shabani, E. (2020). *Playing to lose in the international arena*. Oxford University

Swing, W. (2018). How migrants who send money home have become a global economic force. *World Economic Forum*. <https://www.weforum.org/agenda/2018/06/migrants-remittance-global-economic-force/>

Teferra, D. (2005). Brain circulation: Unparalleled opportunities, underlying challenges, and outmoded presumptions. *Journal of Studies in International Education*, 9(3), 229–250. <https://doi.org/10.1177/1028315305277619>

Tung, R. L. (2008). Human capital or talent flows: Implications for future directions in research on Asia Pacific. UIS. (2017). Number and rates of international mobile students (inbound and outbound). In *National monitoring*. Retrieved from <http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?queryid=172>

UNESCO Institute of Statistics [UIS]. (2016). Higher Education data. Retrieved June 1, 2016, from <http://uis.unesco.org/en/topic/higher-education>

UNICEF (2020). Ngritja e sistemeve arsimore te qendrueshme pas pandemise COVID-19. Unicef:Tirana retrieved from [https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20\(ALB\)%20.pdf](https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20(ALB)%20.pdf)

WIPO. (2019). *Global Innovation Index 2019*. Retrieved from [https://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/wipo\\_pub\\_gii\\_2019.pdf](https://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/wipo_pub_gii_2019.pdf)

- **Struktura moshë-seks** Përbërja e një popullsie e përcaktuar nga numri i femrave dhe meshkujve për çdo kategori moshe ose si përqindje e popullsisë së përgjithshme (jo meshkujt ose femrat më vete). Struktura moshë-seks e një popullsie është rezultati kumulativ i prirjeve të shkuara në lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion. Të dhënat mbi përbërjen moshë-seks janë thelbësore për përshkrimin dhe analizën e shumë të dhënave të tjera demografike. Shih piramidën e popullsisë.
- **Norma e emigracionit sipas moshës** Shifrat e emigracionit të gratë ose burrat e një grupmoshe të caktuar, pjesëtuar me numrin mesatar të burrave dhe grave përkatësisht në atë grupmoshë.
- **Norma e lindshmërisë sipas moshës** Numri i lindjeve të gratë e një grupmoshë të caktuar, pjesëtuar me numrin mesatar të grave të asaj grupmoshe.
- **Norma e vdekshmërisë sipas moshës** Numri i vdekjeve të burrat ose gratë e një grupmoshe të caktuar, pjesëtuar me numrin mesatar të burrave dhe grave, përkatësisht, të asaj grupmoshe.
- **Rritja e moshës së popullsisë** Një proces në të cilin përqindja e të rriturve dhe të moshuarve të një popullate rritet, ndërkohë që ulet përqindja e fëmijëve dhe adoleshentëve. Zakonisht, ky proces sjell si rezultat rritjen e moshës mesatare të popullsisë. Përgjithësisht, rritja e moshës së popullsisë ndodh kur normat e lindshmërisë pësojnë rënie, ndërkohë që jetëgjatësia mbetet konstante ose rritet te brezat e vjetër.
- **Norma e lindshmërisë (ose norma e lindjeve bruto)** Numri i lindjeve për 1,000 banorë mesatarisht në një vit të dhënë. Në anglisht, termi "lindshmëria" shpesh zëvendësohet me termin "shkalla e lindjeve".
- **Mosha riprodhuese** Periudha e moshës riprodhuese të grave, që, për qëllime statistikore, merret si intervali i moshës midis 15 dhe 49 vjeç.
- **Grupmoshë** Një grup njerëzish që kanë të njëjtën përvojë demografike kohore, të cilët vrojtohen në kohë. Për shembull, grupmosha e lindur në vitin 1900 është personat e lindur atë vit. Ka gjithashtu grupmosha martesë, grupmosha të një klase në shkollë e kështu me radhë.
- **Shkalla e vdekshmërisë (ose shkalla e vdekshmërisë bruto)** Numri i vdekjeve për 1,000 banorë mesatarisht në një vit të dhënë.
- **Tranzicioni demografik** Tranzicioni historik nga një formë e zgjeruar në një formë intensive riprodhimi, ndryshimi i normave të lindshmërisë dhe vdekshmërisë nga nivele të larta në nivele të ulëta në një popullatë. Ulja e vdekshmërisë i paraprin zakonisht uljes së fertilitetit, duke sjellë rritje të shpejtë të popullsisë gjatë periudhës së tranzicionit.
- **Efektiviteti i migracionit** Migracioni neto që rezulton për 1,000 lëvizje migratore.
- **Emigracioni** Procesi kur dikush lë territorin për të marrë qëndrim të përhershëm ose gjysmë të përhershëm në një tjetër.
- **Shkalla e emigracionit** Numri i emigracioneve nga territori për 1,000 banorë mesatarisht në atë zonë.
- **Shkalla e fertilitetit** Procesi i riprodhimit, një prej elementeve përbërëse të ndryshimit natyror dhe riprodhimit të popullsisë
- **Parashikim** Pohimi i zhvillimeve më të mundshme në të ardhmen për një dukuri të dhënë, bazuar në njohjen shkencore.

- **Norma e rritjes (ose norma vjetore e rritjes)** rritja ose ulja e popullsisë së përgjithshme gjatë një viti të dhënë kalendarik, e shprehur si përqindje e popullsisë së përgjithshme në fillim të vitit.
- **Imigracioni** Procesi i lëvizjes nga një territor drejt në tjetri për të marrë qëndrim të përhershëm ose gjysmë të përhershëm.
- **Norma e vdekshmërisë foshnjore** Numri i vdekjeve mes foshnjave nën moshën 1 vjeçe për 1,000 lindje të gjalla gjatë të njëjtit vit.
- **Jetëgjatësia** Numri mesatar i viteve shtesë që një person në një moshë të caktuar ekzakte mund të presë të jetojë, nëse prirjet aktuale të vdekshmërisë do të vazhdonin të tilla për pjesën e mbetur të jetës së këtij personi. Zakonisht, përdoret si “Jetëgjatësia në lindje”.
- **Mosha mesatare** Mosha mesatare e pjesëtarëve të popullatës së dhënë.
- **Mosha mesatare e nënës në lindjen e fëmijës** Mosha mesatare e nënave në lindjen e fëmijës e llogaritur mbi vlerat e normave të fertilitetit sipas moshës gjatë gjithë moshës riprodhuese.
- **Migracioni** Procesi i lëvizjes së njerëzve përtej një kufiri të caktuar administrativ, për t’u vendosur në një vend të ri qëndrimi të përhershëm ose gjysmë të përhershëm, element përbërës i ndryshimit të popullsisë.
- **Modeli i parashikimit** Pohimi për zhvillimin e ardhshëm të dukurive të dhëna sipas kushteve të paracaktuara, që nuk aspiron të japë një panoramë të zhvillimit më të mundshëm në të ardhmen.
- **Vdekshmëria** Procesi i vdekjes së brezave, element përbërës i ndryshimit të popullsisë.
- **Lindshmëria** Rezultati i procesit të riprodhimit, element përbërës i ndryshimit të popullsisë.
- **Ndryshimi natyror** Procesi që vjen si rezultat i ndërveprimit të lindshmërisë dhe vdekshmërisë.
- **Migracioni neto** Rezultati i bilancit migrator, diferenca midis numrit të imigracioneve dhe emigracioneve.
- **Pariteti** Koha e lindjes së një fëmije.
- **Riprodhimi i popullsisë (ose Riprodhimi demografik)** – procesi i zëvendësimit të përhershëm të brezave përmes proceseve të pjesshme të ndryshimit natyror dhe migracionit (lindshmëria, vdekshmëria, imigracioni dhe emigracioni).
- **Bilanci i popullsisë** Rezultati i ndryshimit të popullsisë. Madhësia e popullsisë sipas seksit dhe moshës, minus numrin e vdekjeve dhe emigracioneve sipas seksit dhe moshës, plus numrin përkatës të lindjeve dhe imigracionit.
- **Ndryshimi i popullsisë** Procesi që rrjedh prej lindshmërisë, vdekshmërisë, imigracionit dhe emigracionit.
- **Piramida e popullsisë** Një grafik me dy kolona të vendosura vertikalisht, që paraqet shpërndarjen e popullsisë sipas moshës dhe seksit. Zakonisht, brezat e rinj janë në fund, meshkujt në të majtë dhe femrat në të djathtë të lexuesit.
- **Numri i popullsisë** Numri gjithsej i banorëve në një njësi të dhënë territoriale ose kategori komunitetesh në një territor të caktuar.

- **Popullsia pas produktivitetit (ose popullsia pas moshës produktive)** Banorët e moshës 65 vjeç e lart.
- **Popullsia paraproduktive (ose popullsia përpara moshës produktive)** Fëmijët në popullsi. Pjesa e popullsisë nën moshën 15 vjeçe.
- **Popullsia produktive (ose popullsia në moshë produktive)** Popullsia midis moshës 15 dhe 64 vjeçe.
- **Fertiliteti zëvendësues** Norma e fertilitetit me të cilën çdo grua zëvendësohet nga një vajzë, e cila mbijeton deri në të njëjtën moshë sa moshja e nënës në momentin e lindjes së fëmijës (dhe bëhet sërish nënë, sipas hipotezës së këtij koncepti).
- **Norma e përgjithshme e fertilitetit** Numri mesatar i fëmijëve të lindur të gjallë nga një grua gjatë jetës në të gjitha vitet e riprodhimit, krahasuar me normat e fertilitetit sipas moshës në një vit të dhënë kalendarik apo një periudhë tjetër.







IOM Misioni në Shqipëri  
Rr. Brigada VIII, P. LID, Kati III, Ap. 303, Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 (0) 4 2257836-7 Fax: +355 (0) 4 2257835  
E-mail: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int) Website: <http://albania.iom.int>

